



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I TIRANËS

STUDIMI I TREGUT TË PUNËS

(Problematika e tregut të punës për studentët që diplomohen në Universitetin e Tiranës)

Grupi i punës

Bernard Dosti

Eglantina Kalluci

Anila Paparisto

Valbona Ndrepepaj

Albana Gorishti

Andi Pinari

Erta Spaho

Suela Kristo

Blerina Kërcuku

Eljon Mulgeci

Jonad Bara

Tiranë, Korrik 2022

Përmbajtja

1.	Hyrje	4
2.	Organizimi dhe metodologjia	11
3.	Tendencat e tregut të punësimit në Shqipëri.	14
4.	Raporti aplikime-pranime në UT dhe oferta e tij në tregun e punës.....	20
4.1	Raporti aplikime-pranime në Universitetin e Tiranës.....	20
4.1.1	Fakulteti i Drejtësisë	20
4.1.2	Fakulteti i Ekonomisë	25
4.1.3	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	49
4.1.4	Fakulteti i Histori Filologjisë	49
4.1.5	Fakulteti i Shkencave të Natyrës.....	61
4.1.6	Fakulteti i Shkencave Sociale	67
4.2	Oferta e programeve të studimit nga Universiteti i Tiranës	Error! Bookmark not defined.
5.	Analiza e bazuar tek pyetsori me të diplomuarit në vitet e fundit. Gjetjet kryesore sipas fakulteteve të Universitetit të Tiranës	79
5.1	Fakulteti i Drejtësisë	79
5.1.1.	Shpërndarja e studentëve	80
5.1.2.	Punësimi studentëve.....	84
5.1.3.	Spektori i punësimit	86
5.1.4.	Përshtatja e aftësive me kërkesat e tregut	89
5.1.5.	Promotorët për tregun e punës	91
5.1.6.	Zhvillimi aftësive në përshtatje me specializimin në tregun e punës.....	93
5.2.	Fakulteti i Ekonomisë	95
5.2.1.	Shpërndarja e studentëve	98
5.2.2.	Punësimi studentëve.....	101
5.2.3	Spektori i punësimit	104
5.2.4	Përshtatja e aftësive me kërkesat e tregut	108
5.2.5	Promotorët për tregun e punës	110
5.2.6	Zhvillimi aftësive në përshtatje me specializimin në tregun e punës.....	112
5.3	Fakulteti i Gjuhëve të huaja	114
5.3.1	Shpërndarja e studentëve	116

5.3.2	Punësimi i studentëve.....	119
5.3.3	Spektori punësimi	121
5.3.4	Përshtatja e aftësive me kërkesat e tregut	123
5.3.5	Promotorët për tregun e punës	125
5.3.6	Zhvillimi aftësive në përshtatje me specializimin në tregun e punës.....	126
5.4	Fakulteti i Histori Filologjisë	127
5.4.1	Shpërndarja e studentëve	131
5.4.2	Punësimi i studentëve.....	134
5.4.3	Spektori i punësimi	136
5.4.4.	Përshtatja e aftësive me kërkesat e tregut	139
5.4.5	Promotorët për tregun e punës	140
5.4.6.	Zhvillimi aftësive në përshtatje me specializimin në tregun e punës.....	142
5.5	Fakulteti i Shkencave të Natyrës.....	144
5.5.1	Shpërndarja e studentëve	148
5.5.2	Punësimi studentëve.....	151
5.5.3	Spektori punësimi	153
5.5.4	Përshtatja e aftësive me kërkesat e tregut	157
5.5.5	Promotorët për tregun e punës	159
5.5.6	Zhvillimi aftësive në përshtatje me specializimin në tregun e punës.....	160
5.6	Fakulteti i Shkencave Sociale	163
5.6.1	Shpërndarja e studentëve	167
5.6.2	Punësimi i studentëve.....	170
5.6.3	Spektori i punësimi	172
5.6.4	Përshtatja e aftësive me kërkesat e tregut	175
5.6.5	Promotorët për tregun e punës	177
5.6.6	Zhvillimi i aftësive në përshtatje me specializimin në tregun e punës.....	178
6.	Përfundime	181
7.	Rekomandime	183

1. Hyrje

Studimi periodik i dinamikës së tregut të punës përbën, tashmë, një domosdoshmëri për përcaktimin sa më të drejtë të strategjisë së zhvillimit të programeve të studimit në të gjitha ciklet. Nevoja e kryerjes së shpeshtë të këtij studimi lidhet me dinamikën e ndryshimeve strukturore që përjeton tregu i punës në Shqipëri si reflektim i ndryshimit të strukturës së ekonomisë, i modernizimit të saj, i shtimit të lidhjeve ekonomike ndërkombëtare, i zhvillimit të marrëdhënieve sociale, i ndërkombëtarizimit të marrëdhënieve të punës, etj.

Ky punim përfshin gjurmimin e punësimit të studentëve që kanë përfunduar studimet në programet Master (shkencor dhe profesional) në të gjitha Fakultetet e Universitetit të Tiranës në katër vitet e fundit. Ai synon të analizojë të dhënat e ofertës dhe kërkesës për punësimin e të rinjve që mbarojnë Universitetin e Tiranës. Në të jepet një panoramë e specialiteteve që ofron Universiteti i Tiranës në tregun e punës bazuar në të dhënat e marra nga Fakultetet e Universitetit dhe të numrit të studentëve që mbarojnë programet Master. Këto të dhëna janë ballafaquar me numrin e studentëve-aplikantë që synojnë të ndjekin programet Master që ofron Universiteti. Në punim, janë bërë, gjithashtu, përpjekje për të analizuar raportin aplikime-pranime në programin Bachelor. Në këtë rast është synuar të shihet performanca e Universitetit në sytë e nxënësve aplikantë duke theksuar numrin e lartë të aplikantëve me një notë mesatare më të lartë, krahasuar me studentët e pranuar në Universitetet e tjera publike e private.

Figura 1.1. Sistemi arsimor në Shqipëri




Tabela 1.1. Numri i nxënësve dhe studentëve të regjistruar në arsim në Shqipëri, 2017-2022

Niveli ISCED	Viti shkollor / akademik	2017-18	2018-19	2019-20	2020-21	2021-22
1 - 8	Gjithsej:	691,628	678,867	644,209	626,261	608,952
1	Në fillore	170,861	167,104	162,170	158,528	154,140
2	Në ciklin e lartë të arsimit bazë	148,810	139,426	132,709	127,958	123,998
3	Në arsimin e mesëm:	120,062	116,646	109,533	107,989	103,467
	Gjimnaz dhe Social-Kulturor	99,457	95,359	89,869	88,965	85,188
	Në Profesional	20,605	21,289	19,664	19,024	18,279
5-8	Në arsimin e lartë:	131,833	139,043	130,264	123,797	123,880
5-8	Në Universitetin e Tiranës					

Burimi: Të dhënat administrative nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tabela 1.2 Të Diplomuar sipas niveleve arsimore, 2016-2021

Vite shkollorë/akademik	2016-17	2017-18	2018-19	2019-20	2020-21
Të Diplomuar në arsimin:					
9 vjeçar	36,546	37,795	34,982	33,618	32,179
Të mesëm:	36,436	35,278	34,021	31,662	31,136
vetëm Profesional	4,281	4,189	3,807	4,862	3,831
Arsimin e lartë gjithsej:	35,388	34,331	34,891	32,889	32,690
vetëm Bachelor	20,423	20,108	18,696	17,585	17,650

Burimi i informacionit: Të dhënat administrative nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

<http://instat.gov.al/media/2924/t%C3%AB-diplomuar-sipas-niveleve-arsimore.xlsx>

Në pesëvjeçarin e fundit, numri i nxënësve dhe studentëve paraqiten në rënie për arsye demografike të rënies së peshës specifike të fëmijëve në popullsinë e vendit tonë dhe të tendencave për studime jashtë vendit. Klasifikimi standart ndërkombëtar i arsimit ISCED 2011 është zbatuar për herë të parë në statistikat nga viti akademik 2012-2013. Fushat e studimit aktualisht janë 10, ku Shkencat Sociale dhe Gazetaria mbeten në klasifikimin 3, dhe në ndarjen 4 janë Administrim Biznesi dhe Juridik, të dyja këto fusha që kanë numrin më të madh të studentëve të regjistruar, gati 1/3 janë

të ofruara në programet e Universitetit të Tiranës. Po t'u shtohen edhe fusha e edukimit, humanitare dhe artet, shkencat e natyrës, si dhe punën sociale që është bashkë me mjekësinë, Universiteti i Tiranës mbulon pjesën dërrmuese të fushave të studimeve në arsimin e lartë.

Tabela 1.3. Numri i studentëve të regjistruar në arsimin e lartë sipas fushave të studimit

FUSHAT E STUDIMIT ISCED / VITI	2017-18	2018-19	2019-20	2020-21	2021-22
1. Shkenca arsimit	10,689	10,062	9,062	8,367	8,085
2. Arte dhe shkenca humane	15,441	14,348	12,537	10,972	9,536
3. Shkenca sociale, gazetari dhe informacion	12,259	14,086	11,397	10,277	9,204
4. Biznes, administrim dhe ligj	30,233	33,447	32,732	31,173	32,227
5. Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	6,325	7,060	5,962	4,924	4,553
6. Teknologji e Informacionit dhe komunikimit	8,228	10,016	8,883	8,341	8,458
7. Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	18,730	20,019	20,775	20,537	22,555
8. Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinar	4,564	4,999	4,158	3,458	2,770
9. Shëndet dhe mirëqenie	19,837	20,727	20,199	21,195	22,130
10. Shërbime	3,088	4,279	4,559	4,553	4,362
Gjithsej	131,833	139,043	130,264	123,797	123,880

Burimi: Të dhënat administrative nga Ministria e Arsimit dhe Sportit

Edhe numri i të diplomuarve ndjek numrin e të regjistruarve, me numër me të pakët të diplomuarish në krahasim me të regjistruarit në fushat Humanitare dhe Artet, si dhe Bujqësia. INSTAT tregon se në programet Bachelor në vitin 2016, janë diplomuar 59.2% e studentëve të diplomuar në arsimin e lartë. Pjesa tjetër prej 40.8 % përbëhet kryesisht prej atyre që diplomohen në programet Master që tregon se shumica e studentëve vazhdojnë nivelin Master edhe pse e kanë të vështirë të gjejnë punë me diplomën Bachelor.

Tabela 1.4 Numri i studentëve të diplomuar sipas niveleve arsimore

ISCED	Viti shkollor/akademik	2016-17	2017-18	2018-19	2019-20	2020-21
	Të Diplomuar në arsimin:					

1+2	9 vjeçar	36,546	37,795	34,982	33,618	32,179
3	I mesëm:	36,436	35,278	34,021	31,662	31,136
	<i>vetëm Profesional</i>	4,281	4,189	3,807	4,862	3,831
5-8	I lartë:	35,388	34,331	34,891	32,889	32,690
	<i>vetëm Bachelor</i>	20,423	20,108	18,696	17,585	17,650

Burimi: Të dhënat administrative nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Vëmendja kryesore në punim i është kushtuar punësimit të studentëve që mbarojnë studimet në programet Master të Universitetit të Tiranës. Proçesi i kërkimit dhe i gjetjes së punës nga ana e studentëve të diplomuar rishtas është mjaft i vështirë në kushtet e mundësive që ofron tregu shqiptar i punës. Në vitet e fundit janë bërë përpjekje të mëdha nga ana e institucioneve përkatëse për të rritur shkallën e rregullimit të këtij tregu duke krijuar mundësinë e shkurtimit të kohës së proçesit të gjetjes së punës.

Pesha specifike e nxënësve dhe studentëve në popullsinë ekonomike jo aktive është e konsiderueshme. Ndër popullsinë e femrave të moshës 15-64 vjeç ekonomike jo aktive 29,5 % janë nxënës/studentë ose në trajnim të mëtejshëm. Ndër popullsinë e meshkujve të moshës 15-64 vjeç ekonomike jo aktive 49,3 % janë nxënës/studentë ose në trajnim të mëtejshëm. Sipas AFP 2016, të rinjtë e moshës 15-29 vjeç as në punësim e as duke ndjekur shkollën apo ndonjë formim profesional (NEET) përbëjnë 30,0 % të të rinjve gjithsej¹. Shkalla e punësimit është disi më e lartë për meshkujt sesa për femrat për grupmoshën 15-29 vjeç. Analiza sipas moshës tregon që shkalla e punësimit është më e ulët për grup-moshat më të reja (15-29 vjeç) krahasimisht me ato më të mëdha (30-64 vjeç). Në vitin 2016 shkalla e punësimit për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç ishte 32,4 %, gati gjysma e nivelit të përgjithshëm të punësimit, me një rritje krahasuar me vitin 2015 nga vlera 29,8 %. Analiza e shkallës së punësimit të të rinjve në moshë 15-29 vjeç sipas gjinisë, tregon që ajo ndjek tendencën e treguesit respektiv për moshën 15-64 vjeç, pra është më e lartë për meshkujt krahasimisht me femrat.

Tabela 1.5.: Shkalla e punësimit sipas gjinisë

	Shkalla e punësimit
--	----------------------------

¹ <http://instat.gov.al/media/1914/tregu-i-pun%C3%ABs-2016.pdf>

Grupmosha	2017	2018	2019	2020	2021
Gjithsej					
15-29	33.8	38.5	41.2	41.2	41.5
30-64	68.7	70.9	71.8	70.7	70.6
15-64	57.4	59.5	61.2	60.6	60.9
15+	50.3	52.1	53.4	52.5	52.9
Meshkuj					
15-29	38.5	44.7	46.6	46.9	46.6
30-64	77.9	79.3	79.9	78.9	79.4
15-64	64.3	66.7	68.2	67.8	68.2
15+	57.1	59.0	60.1	59.2	59.5
Femra					
15-29	28.3	32.0	35.7	35.3	36.4
30-64	60.0	62.9	64.0	62.8	62.2
15-64	50.3	52.4	54.4	53.6	53.8
15+	43.5	45.3	46.9	46.1	46.4

Burimi: Anketa e Forcave të Punës 2017-2021

Sa i takon të punësuarve me arsim të lartë, ka pasur një tendencë rënieje deri në 2015, me një rritje te lehtë që duket në 2016 në nivelin e 66.6%. Shkalla e punësimit është dukshëm më e lartë për personat me arsim të lartë dhe ata me arsim të mesëm profesional dhe vetëm pas vitit 2013, pesha specifike e të punësuarve me arsim të lartë rritet duke arritur 66.6 përqind në 2016, krahasuar me 64.5% të atyre me arsim të mesëm profesional. Numri i lartë i nxënësve dhe studentëve që mbarojnë njëkohësisht studimet e komplikon gjetjen e një pune edhe për studentët e Universitetit të Tiranës. Për më tepër që sikurse del në pah nga të dhënat e pyetësorit me studentët e diplomuar, mbi 70 përqind e tyre që vijnë nga rajone të ndryshme të vendit punësohen në Tiranë.

Grupi i punës, për studimin e tregut të punës në nivel institucional, e organizoi punën në katër faza: **Faza e parë:** Njohja dhe përcaktimi i burimeve statistikore që ofrohen nga Universiteti, INSTAT, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Departamenti i Administratës Publike. Njohja me studime të ngjashme të kryera nga institucione të tjera. Hartimi i një pyetësori për tërheqjen e mendimit dhe përvojave të studentëve që kanë mbaruar studimet në programet Master në katër vitet e fundit.

Faza e dytë: Organizimi i shpërndarjes së pyetësorit me synimin e arritjes së një numri sa më të madh studentësh të diplomuar vitet e fundit. Për këtë do të shfrytëzoheshin kontaktet që dispononin Zyrat e karrierës, sekretariatë mësimore, Departamentet e veçanta.

Faza e tretë: Përpunimi tabelar e grafik i të dhënave të pyetësorit. Interpretimi dhe analiza e tyre për secilin Fakultet.

Faza e katërt: Shkrimi i materialit. Evidentimi i përfundimeve dhe rekomandimeve.

Në punim jepet, fillimisht, një analizë e tendencave të përgjithshme në tregun e punës. Dilema e shoqërisë së sotme për të balancuar kërkesën e tregut me nivelin e aftësive dhe kompetencave të forcave të punës, është një nga temat që ka tërhequr vëmendjen për studime shkencore, jo vetëm në vendet e zhvilluara, por së fundmi edhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor si studimi “Universities and the Labour Markets”² që synon të sjellë një analizë komplekse të impakteve sociale të reformave në arsimin e lartë dhe nevojave për ta përshtatur ofertën që sjell arsimi i lartë me kërkesat e tregut të punës në Shqipëri.

Ky studim ka shërbyer si orientues për të gjykuar mbi prirjet e fundit të kërkesë ofertës në tregun e punës për të sapodiplomuarit me arsim të lartë duke e vendosur situatën e Universitetit të Tiranës në këtë kontekst.

Pjesën më të rëndësishme të punimit e përbëjnë gjetjet e pyetësorit të organizuar nga grupi i punës në të cilin janë analizuar një sërë aspektesh që kanë të bëjnë me vështirësitë në gjetjen e një pune, rolin e cilësisë së programeve të Universitetit në lehtësimin e gjetjes së një pune, shpërndarjen gjeografike të punësimit duke vënë në dukje përqëndrimin e punësimit në Tiranë, sektorët ku punësohen më së shumti studentët, përshtatjen e aftësive me kërkesat e tregut të punës, promotorët në gjetjen e një pune dhe ndihmën që duhet të japë Universiteti, roli i praktikave mësimore e profesionale, etj. Interpretimi i të dhënave të pyetësorit është shoqëruar me aparatin e nevojshëm tabelar e grafik për ti bërë më të lexueshme gjetjet që rezultojnë prej tij.

Është me vend të theksohen vështirësitë jo të vogla që Grupi i punës hasi në realizimin e këtij punimi. Të dhënat statistikore që ofrohen nga Institucionet përkatëse shqiptare për punësimin e studentëve janë pothuajse inekzistente. Dhe ato pak të dhëna që ofrohen nuk janë të lidhura drejtpërdrejtë me objektin e punimit tonë. Punime të ngjashme të kryera më parë, ose nga IAL të tjera nuk ka (ose

² https://ec.europa.eu/education/sites/education/files/2016-higher-education-labour-market-balkans_en.pdf

nuk janë botuar). Lidhjet permanente me studentët që kanë mbaruar studimet në Universitetin tonë lenë shumë për të dëshiruar. Kjo e vështirësoi së tepërmi arritjen e një numri sa më të madh studentësh në realizimin e pyetësorit.

2. Organizimi dhe metodologjia

Studimi i tregut po realizohet për herë të parë në Universitetin e Tiranës dhe kjo ishte një sfidë e vështirë për grupin e punës. Ky studim u konceptua në disa plane. Së pari, të vlerësohen sa atraktive janë programet e ofruara nga Universiteti ynë për të rinjtë duke iu referuar prurjeve në vitet e fundit. Në radhë të parë, grumbulluam të dhënat bazë të marra në Fakultetet e Universitetit të Tiranës në lidhje me numrin e aplikimeve, pranimeve, notës mesatare të shkollës së mesme, numri i aplikantëve për programet Master, nota mesatare e pranimeve në programet Master, IAL-të nga vijnë këta studentë, etj. Interpretimi i këtyre të dhënave synon të pasqyrojë se çfarë ofron Universiteti në tregun e punës dhe me çfarë cilësie, pse është universiteti më atraktiv, referuar raportit aplikime-pranime dhe notës mesatare të studentëve të regjistruar. Plani i dytë, i lidhur ngushtë me prurjet në Universitetin e Tiranës, janë programet kryesore të studimit të ofruara nga çdo Fakultet në të dy nivelet, Bachelor dhe Master, Master shkencor dhe Profesional. Kjo do të na orientonte se cilat degë studimi janë më të kerkuara nga studentët aplikantë dhe të regjistruar, dhe cilat prej tyre konsiderohen të suksesshme në lidhje me punësimin e të sapo diplomuarve.

Plani i tretë i analizës janë të diplomuarit sipas Fakulteteve, të cilët kanë qenë në fokusin e analizës për të vlerësuar se sa e balancuar është oferta e Universitetit me kërkesat e tregut të punës dhe vështirësitë e këtij tranzicioni nga shkolla në punë. Nisur nga perspektiva e ciklit të jetës, kalimi nga arsimi në punësim është një tjetër komponent i rëndësishëm që ndikon në produktivitetin shoqëror. Ndërsa pranimet dhe organizimi i procesit mësimor janë të rregulluara me Ligjin për Arsimin e Lartë, standardet e cilësisë, statutet dhe rregulloret e Universitetit dhe të Fakulteteve, lidhja e Universitetit me institucionet publike e private, studimet periodike mbi gjurmueshmerinë e punësimit të diplomuarve kanë mbetur disi në hije nga këndvështrimi i rregullimit me akte të posaçme ligjore, nënligjore e administrative. VKM numër. 873, datë 27.12.2006 ka sanksionuar një marrëdhënie të ngushtë midis institucioneve të arsimit të lartë dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit në funksion të lehtësimit të kalimit nga shkolla në tregun e punës, por që ka mbetur vetëm në letër për gati 10 vjet.

Në kushtet e mungesës së statistikave zyrtare për punësimin e studentëve sipas Universiteteve, u organizua pyetësori me studentët që kanë mbaruar studimet në programet Master në vitet 2018-2022. Synimi ishte evidentimi i problematikës me të cilën përballen studentët në procesin e gjetjes së

punës, sektorët ku ata punësohen, roli i programeve të studimit në suksesin e gjetjes së punës, roli i praktikës mësimore e profesionale, etj.

Pyetësi, si një instrument metodologjik për gjurmimin e statusit të të diplomuarve vitet e fundit, u shpërnda nga adresat zyrtare të fakulteteve, duke përdorur databazën e të dhënave të sekretarive mësimore gjatë regjistrimeve të studentëve dhe të zyrës së orientimit të karrierës së vendosur pranë çdo Fakulteti. Plotësueshmëria është me një pritshmëri 8%. Pyetësi u plotësua nga 638 studentë, por është e vështirë të përcaktohet një shkallë e saktë e përgjigjeve të marra, ngaqë adresat e e-maileve lenë për të dëshiruar. Ky test i parë na dha një mësim të mirë që kontaktet e Universitetit me të diplomuarit ka nevojë të mbahen edhe pas diplomimit të tyre, duke përcjellë informacione të dobishme për të dy palët: studentët e punësuar mund t'i ofrojnë fakulteteve të tyre informacione të dobishme nga institucionet ku janë punësuar, ndërsa fakultetet mund të shtrijnë publicitetin e tyre në një publik më të madh. Kjo lidhet edhe me faktin që deri më sot website-t e fakulteteve ende nuk janë aq atraktive saqë t'i mbajnë studentët të interesuar për informacionet dhe të rejat që ofrojnë sepse ata diplomohen dhe largohen prej tyre. Në tabelën e mëposhtme jepet ndarja sipas Fakulteteve.




Figura 1: Shkalla e përgjigjes sipas Fakulteteve

Pyetësi synon të identifikojë dhe të kontaktojë studentët e diplomuar së fundmi, të studiojë shpërndarjen gjeografike, pritshmëritë dhe përqëndrimin e tyre, tendencat dhe profili i situatës së punësimit të tyre dhe aftësi në tregun e punës. Mënyra e kampionimit është Simple Random Sample (SRS) dhe rezultatet nuk synohen të jepen të disagreguara me rajone dhe sipas fakulteteve. Që në kampionim mbahet parasysh vështirësia për kontaktimin dhe mbajtjen e lidhjeve me Universitetin. Periudha e anketimit u përcaktua dy javë. Studentët u kontaktuan nëpërmjet kontakteve që ekzistojnë dhe pyetësin të hartuar online. Studimi i të dhënave ekzistuese dhe të dhënave të gjeneruara nga Fakultetet nuk japin informacionin që mund ta marrë në këtë rast një pyetësor.

Pyetësi si fillim u hartua në katër seksion. Në pjesën e parë merret informacion mbi moshën, vendlindjen, vendbanimin, diplomimin, fakultetin dhe programin.

Në pjesën në vazhdim mblidhet informacion mbi statusin e punësimit, historikun e punësimit, barrierat e tregut të punës, përputhshmëria dhe vlefshmëria e formimit të njohurive të marra në fakultet në gjetjen e një pune dhe më tej në performancën në punë, propotorët në tregun e punës dhe aftësi të mëtejshme.

Studentët mund të japin opinionin e tyre mbi ndryshimet që mund të behen në kuadrin e periudhës tranzitore nga student në tregun e punës. Të dhënat e mbledhura janë subjekt i ruajtjes së konfidencialitetit dhe të dhënat identifikuese nuk do të publikohen. Ky pyetësor synon gjithashtu të ngrejë një strukturë dhe ta vazhdojë më tej punën e bashkëpunimit për promovimin e studentëve në tregun e punës nëpërmjet praktikave mësimore, qëndrës së karrierës apo kontakteve dhe kërkesave të ardhura por gjithashtu të studiojë më tej edhe për studentët që nuk promovohen nga Fakulteti përshtatjen e tyre në tregun e punës.

Pyetjet janë cilësore, sasiore, të hapura apo me kategori të shkallës së Likertit me një shkallë vlerësimi 1-10. Pyetësi u draftua dhe u qarkullua për të arritur në formën finale. Shkalla e përgjigjes së pritshme rezultoi më e ulët në vitet e para të diplomimit dhe filloi të rritej për studentët e diplomuar në vitet e fundit. Shkalla e përgjigjes është më e lartë për studentët e diplomuar në vitin 2021. Ky projektim i të dhënave është i justifikuar, sepse sa më larg viti i diplomimit aq më i vogël është edhe kontakti me Fakultetin.

Tabela 2.1: Shkalla e përgjigjes sipas vitit të diplomimit

Viti i diplomimit	Përqindja e studenteve të përgjigjur
2018	15.50 %
2019	11.30 %
2020	22.10 %
2021	51.10 %

Pritshmëritë për tregun e punës, kohën e punësimit dhe përshtatjen në tregun e punës ndryshon nga njëri Fakultet në tjetrin, prandaj analiza u krye për çdo fakultet në veçanti.


Fusha të ndryshme diplomimit ndikojnë në gjetjen e punës, sektorin ku punojnë si dhe punësimin aktual. Më tej, në pjesën e pestë, do të interpretohen e analizohen gjetjet e pyetsorit sipas Fakulteteve.

1. Tendencat e tregut të punësimit në Shqipëri.

Një faktor vendimtar i rritjes së produktivitetit të shoqërisë për një zhvillim të qëndrueshëm është forca punëtore e mirëkualifikuar që i përgjigjet kërkesave të tregut dhe standardeve në rritje të zhvillimit të teknologjisë, shkencës dhe konkurrencës globale. Intensifikimi i procesit të integritetit evropian ka shtuar presionin dhe përgjegjësinë e Shqipërisë për të siguruar një fuqi punëtore më konkurruese, si brenda rajonit të Ballkanit, edhe ndaj hapjes me shtetet e Bashkimit Evropian. Pritshmëritë në këtë drejtim kanë të bëjnë më së shumti me zbatimin e politikave efektive të integruara të arsimit dhe të tregut të punës me prioritetet e zhvillimit ekonomik që të adresojnë veçanërisht sfidat e të rinjve për punësim. Ekonomia shqiptare pas vitit 2013 ka njohur një lloj stabilizimi të rritjes së PBB, shoqëruar me rritjen të punësimit, duke pasur një shenjë pozitive vetëm pas vitit 2015.

Figura 3. 1:

. Dinamikat e rritjes së PBB dhe të Punësimit, 1996-2016



Burimi: Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Raporti Vjetor 2016

Në dhjetëvjeçarin e fundit, forcat e punës me arsim të lartë u rritën si rezultat i masivizimit të arsimit të lartë, por punësimi i tyre ka ardhur në zbritje dhe niveli i të papunëve me diplomë universitare është ende i lartë, ndonëse me një zbritje të lehtë nga 19.1% në vitin 2015, në 16.9% në 2016 (INSTAT, AFP 2016). Në vitin 2016, shkalla e papunësisë për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç vazhdon të jetë pothuajse 2 herë më e lartë se shkalla e papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart. Karakteristike është që papunësia e të diplomuarve me arsim të lartë është më e madhe sesa papunësia e të diplomuarve me arsim të mesëm profesional, kur punësimi ishte pothuajse në nivele të krahasueshme.

Tabela 3. 1. Shkalla e papunësisë sipas nivelit arsimor (në përqindje)


Niveli arsimor	2012	2013	2014	2015	2016
Gjithsej (15-64)	13,8	16,4	17,9	17,5	15,6
Deri 8/9 vjeçar	12,3	14,8	15,1	14,0	13,3
E mesme profesionale	10,6	11,8	13,6	14,8	14,9
E mesme e përgjithshme	17,5	23,2	25,2	23,2	18,9
I lartë	16,2	15,0	17,3	19,2	17,1

Burimi: INSTAT

Duke iu referuar edhe të dhënave administrative nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, është e qartë tendenca në rritje e punëkërkuësve të papunë me arsim të lartë në pesë vitet e fundit, nga 6,626 vetë në 2013 gati dyfishohet në 12,179 vetë në 2015 (SHKP, 2015). Megjithatë, numri i të diplomuarve të regjistruar si punëkërkuës përbën vetëm 6% të numrit të përgjithshëm të punëkërkuësve të regjistruar, pasi ata nuk marrin shërbime të specializuara punësimi në rast papunësie.

Struktura e tregut të punës në Shqipëri tregon për dominimin e sektorit privat në punësim, krahasuar me tkurrjen që ka pësuar në këto vite tranzicioni punësimi në sektorin publik. Gjithsesi e rëndësishme është të evidentohet tendenca në rritje e punësimit të të diplomuarve me arsim të lartë ndër vite në administratën publike, veçanërisht pas vendosjen së statusit të nëpunësit civil me ligjin e vitit 2013.

Figura 3. 2: . Dinamika e të punësuarve me arsim të lartë në sektorin publik



Burimi: INSTAT

Departamenti i Administratës Publike për tre vitet e fundit, 2016-2018, ka nxjerre fitues të konkurseve për pranim të përhershëm 621 persona gjithsej, 286 nga të cilët janë nga Universiteti i Tiranës, respektivisht:

- Fakulteti i Drejtësisë 91
- Fakulteti i Ekonomisë 86
- Fakulteti Histori-Filologji 32
- Fakulteti Gjuhë të Huaja 10
- Fakulteti Shkenca të Natyrës 31
- Fakulteti Shkenca Sociale 30
- Instituti i Studimeve Evropiane 2

Në punësimin sipas degëve të ekonomisë dhe nivelit arsimor në periudhën 2012-2014, ka një prirje rritjeje në punësim për personat me arsim të lartë tek degët e ekonomisë si manifaktura, industria minerale dhe energjetike, si dhe shërbimet.


Tabela 3. 2: Dinamikat e punësimit sipas nivelit arsimor në 2012-2014-2016

(Në mijë njerëz)

Sektorët e Ekonomi së	Bujqësia		Manifaktura		Ndërtimi		Minierat & Electriciteti, Furnizimi me Gaz & Ujë		Shërbimet tregu		Shërbime jo tregu	
Vitet	2012	2014	2012	2014	2012	2014	2012	2014	2012	2014	2012	2014
Gjithsej	526	443	81	90	93	66	22	25	246	235	171	174
9-Vjeçar	400	332	38	37	50	35	6	4	75	66	21	15
I Mesëm	117	104	39	46	35	28	14	17	131	117	68	55
I Lartë	10	7	4	7	8	4	2	5	40	52	83	104

Burimi: Përpunuar të dhënat e INSTAT, Anketa e Forcave të Punës, 2012-2014

Është e qartë se nga njëra anë, tregu i punës nuk është në gjendje për të akomoduar rritjen e fuqisë punëtore me arsim të lartë në fusha të caktuara, nga ana tjetër, jo të gjithë të diplomuarit me arsim të lartë kanë aftësitë e nevojshme për të përballuar kërkesat e tregut të punës. Referuar analizës së programeve universitare rezulton zhvillimi i tepërt i degëve të caktuara të studimit në shkencat humane, biznes administrim dhe juridik, ndërkohë që peshën më të madhe në punësim e zë sektori i bujqësisë me rreth 41,3 % dhe sektori i shërbimeve me 40,2 %. Mospërputhja e profesioneve të ofertës dhe kërkesës për punë është një tjetër problem që evidentohet qartë nga të dhënat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit që synon t'u gjejë vendin e punësimit të përshtatshëm punëkërkuesve të papunë.



Burimi: Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)

Në Dhjetor 2020, 92326 të papunë janë regjistruar në zyrat e punësimit , 34.6% më shumë se në të njëjtën periudhë në vitin 2019.

Si rezultat i krizës së shkaktuar nga COVID-19, gjatë çerekut të dytë të vitit 2020, zyrat e punësimit janë përballur me një numër shumë të lartë aplikantësh.

Nga ofertat e punës rezulton se vetëm 23% janë për specialistë me arsim të lartë, nëpunës dhe teknikë, ndërsa 53.5% e totalit të punëkërkuesve të papunë janë në profesione elementare. Një prirje e qartë e viteve të fundit është se gratë e grupmoshës 25-39 kanë përmbysur pozitë e grave në shoqërinë shqiptare ku 27 përqind e tyre kanë përfunduar arsimin e lartë, krahasuar me 19 përqind të burrave (INSTAT, 2017: 50). Kjo shkallë e lartë e arsimit të vajzave e grave nuk është reflektuar edhe në shkallën më të lartë të punësimit të tyre.

Tabela 3. 3: Punësimi sipas grup profesioneve

(% ndaj popullsisë së punësuar të moshës 15 vjeç e lart)						
Grup-profesionet		2012	2013	2014	2015	2016
Gjithsej		1.140.097	1.023.688	1.037.061	1.086.612	1.157.177
Menaxherë, profesionistë dhe teknikë		13,6	16,5	17,7	17,3	17,7
Nëpunës, Punonjës të shitjeve dhe shërbimeve		18,0	17,8	16,3	17,9	17,8
Punonjës të bujqësisë, pyjeve, peshkimit dhe Zejtarë		58,6	56,6	53,5	52,4	50,7
Punonjës të montimit të pajisjeve dhe makinerive		6,0	5,5	6,4	6,5	7,4
Profesione elementare		3,4	3,1	5,6	5,2	6,1
Forcat e armatosura		0,3	0,3	0,4	0,6	0,4

Zhvillimi i politikave për gratë sipërmarrëse mbetet një sfidë e vërtetë për qeverinë. Përfshirja në aktivitetet e ndërmarrjes nënkupton më shumë liri ekonomike dhe fuqizimin e mëtijshëm të grave në shoqëri. Plani i Veprimit për Mbështetjen e Grave Sipërmarrëse 2014-2020 projektuar në bashkëpunim me UN Women në Shqipëri përbëhet nga pesë shtylla: i) mbështetje politike, ii) arsim

dhe trajnim, iii) qasje në financa dhe konkurrencë, iv) rrjetëzim, v) pjesëmarrja e grave në ekonominë rurale.³

Strategjia e Punësimit dhe Aftësive 2014 - 2020 synon t'u përgjigjet prioritetëve të zhvillimit ekonomik me punësimin, duke integruar politikat ekonomike, arsimore dhe sipërmarrëse. Objektivat e Qeverisë për rritjen e punësimit janë përmes hapjes së vendeve të reja të punës, kryesisht, nëpërmjet zhvillimit të atyre degëve të ekonomisë që kanë treguar kërkesa të larta për punësim. Duke iu referuar sektorëve ekonomikë, 40.2 përqind e të punësuarve janë punësuar në bujqësi. Sektori i shërbimeve - ku përfshihen aktivitete të tilla si administrata publike, shërbimet sociale dhe aktivitete dhe shërbime të tjera - luan rolin e dytë më të rëndësishëm në punësimin veçanërisht të grave (20 përqind) pas bujqësisë.

Përmes anketimit të bizneseve të të gjitha llojeve për punonjësit e rinj me arsim të lartë, rezulton nevoja për aftësitë e komunikimit, kreativitet, aftësi kompjuterike, aftësi organizative, aftësi për të punuar në ekip dhe dëshira për të mësuar të reja të profesionit.⁴ Këto gjetje mbështesin gjetjet edhe nga studimi i ILO dhe SHKP "Skills Need Analysis, 2014" në Shqipëri konkludojnë se disa biznese kanë deklaruar që të punësuarve u mungojnë aftësitë e duhura për të kryer punën e caktuar në sektorët "informacionit dhe komunikimit", "aktivitetet financiare dhe të sigurimit", "aktivitetet e pasurive të patundshme" dhe "sferave profesionale, shkencore dhe teknike", pasi ato janë specifike dhe kërkojnë aftësi të lartë profesionale dhe teknike (ILO/SHKP, 2014: 41). Edhe studjuesit e rajonit konstatojnë se të diplomuarit nga institucionet e arsimit të lartë shpesh nuk janë të pajisur me aftësitë që janë të rëndësishme për nevojat e tregut. Prandaj realizimi i studimeve të vazhdueshme për njohuritë dhe aftësitë që kërkon tregu nga të diplomuarit me arsim të lartë do të ndihmonin edhe institucionet e arsimit të lartë në orientimin e programeve studimore.

³ Referuar Urdhërit të Ministrit të Ekonomisë nr. 339, datë 19.06.2014.

⁴ Xhumari, M., & Dibra, S., & Bartlett, W., (2016) From University to Employment: *Higher Education Provision and Labour Market Needs in Albania*, faqe 34.

2. Raporti aplikime-pranime në UT dhe oferta e tij në tregun e punës


4.1 Raporti aplikime-pranime në Universitetin e Tiranës.

4.1.1 Fakulteti i Drejtësisë

Cikli i Parë

Fakulteti i Drejtësisë ofron një program studimi në ciklin e parë, Bachelor në Drejtësi.

Duke iu referuar të dhënave të programit të studimit Bachelor rezulton se për të dy vitet akademike kemi një nivel të lartë të aplikimeve në raport me numrin e të pranuarve.



Për vitin akademik 2019-2020 janë regjistruar 641 studentë, në vitin 2020-2021 645 studentë dhe në vitin akademik 2021-2022 janë regjistruar 660 studentë.

Në grafikun e mësipërm janë paraqitur aplikimet në programin e studimit të ciklit të parë që ofron Fakulteti i Drejtësisë në dy vitet e fundit akademike.

Në grafikun e mësipërm janë projektuar regjistrimet në Fakultetin e Drejtësisë në tre vitet e fundit akademike ku vihet re një trend në rritje për vitin akademik 2021-2022 krahasur me dy vitet më parë që dëshmon kërkesën në rritje për këtë program studimi.

Cikli i Dytë

Fakulteti i Drejtësisë ofron 7 programe studimi në ciklin e dytë, prej të cilave 3 programe janë Master i Shkencave dhe 4 programe janë Master Profesional.

- Master Shkencor Civil
- Master Shkencor Penal
- Master Shkencor Publik
- Master Profesional Civil
- Master Profesional Penal
- Master Profesional Publik
- Master Profesional EU Busines Law

Për vitin e fundit akademik 73% e studentëve janë nga Fakulteti i Drejtësisë, 3% janë nga fakultetet e tjera të UT, 9 % nga Fakultetet publike nga rrethet, 14% nga Fakultetet jopublike, 1% nga Fakultetet e huaja dhe 1 student është nga trojet.

Figura 4.1.1. 1: Regjistruar në Ciklin e Dytë 2019-2020




Figura 4.1.1. 2: Regjistruar në Ciklin e Dytë 2020-2021





Figura 4.1.1. 3: Regjistruar në Ciklin e Dytë 2021-2022



Duke iu referuar të dhënave rezulton se pothuajse të gjithë aplikantët janë përfshirë në studimet master.

Nga të dhënat, rezulton se numri më i madh i studentëve është në master shkencor.

Në lidhje me mesataren e studentëve të pranuar rezulton se për të dyja vitet akademike mesatarja është pothuajse e njëjtë sipas programeve përkatëse. Studentët në Masterin Shkencor Civil në të dyja vitet akademike kanë mesataren më të lartë, ndërsa më të ulët studentët në Masterin Profesional Publik.

Në një plan krahasues janë paraqitur regjistrimet në ciklin e dytë në tre vitet e fundit akademike.




Figura 4.1.1. 4: Pranime në Ciklin e Dytë

4.1.2 Fakulteti i Ekonomisë

Cikli i Parë

Fakulteti i Ekonomisë ofron katër programe studimi në ciklin e parë.

- Bachelor në "Informatika Ekonomike"
- Bachelor në "Financë"
- Bachelor në "Ekonomiks"
- Bachelor në "Administrim Biznesi"

Tabela 4.1.2.1: Aplikime-pranime FE, 2018-2019

Viti Akademik	Raundi I		Raundi II		Gjithsej
2018 - 2019	Aplikant	Regjistruar	Aplikant	Regjistruar	
	20231	1150	5013	107	1280
Informatika	Raundi I		Raundi II+III		Gjithsej
Ekonomike	Aplikant	Regjistruar	Aplikant	Regjistruar	
	3888	224	816	20+6	250
	Raundi I		Raundi II+III		Gjithsej
Financë	Aplikant	Regjistruar	Aplikant	Regjistruar	
	5173	442	991	16+2	460
Ekonomiks	Raundi I		Raundi II+III		Gjithsej
	Aplikant	Regjistruar	Aplikant	Regjistruar	
	3823	61	1131	46+3	110
Administrim	Raundi I		Raundi II+III		Gjithsej
Biznesi	Aplikant	Regjistruar	Aplikant	Regjistruar	
	7347	423	2075	25+12	460

Për Vitin Akademik 2018-2019, numri i aplikantëve për Fakultetin e Ekonomisë ishte 20231 në raundin e parë dhe 5013 në raundin e dytë, ndërkohë që në raundin e parë u regjistruan 1150 studentë dhe në raundin e dytë 107 studentë. Vihet re që pjesa më e madhe e studentëve, në të gjitha degët, janë regjistruar në raundin e parë. Kuotat më të larta të pranimeve janë në programet e studimit për Financë dhe Administrim biznesi (460 studentë).

Në grafikun e mëposhtëm janë projektuar regjistrimet në FE, ku vihet re një trend në rritje për Vitin Akademik 2019-2020 krahasur me një vit më parë që justifikohet me përpjekjet e mëdha sqaruese të bëra nga Fakulteti për të shmangur panikun që përjetuan aplikantët e viteve të shkuara.

Dy programet e studimit me kërkesë më të larta në FE edhe për Vitin akademik 2019-2020 janë Bachelor Financë dhe Administrim Biznesi, për shkak edhe të numrit të lartë të kuotave që kanë këto dy programe, edhe pse për programin e studimit Administrim Biznesi vihet re një ulje e lehtë e kërkesave për aplikim për 2019-2020. Edhe dy degët e tjera, Informatika Ekonomike dhe Ekonomiksi, kanë një numër të lartë aplikimesh krahasuar me kuotat e pranimi. Në përgjithësi, vihet re një rritje në aplikime në të gjithë programet e studimit nga viti 2018-2019 në vitin 2019-2020. Në të dy vitet akademike kërkesa për të qenë student i FE mbetet e lartë për të gjitha degët. Referuar të dhënave për raportin aplikime pranime në Fakultetin Ekonomisë për nivelin Bachelor, vazhdon të evidentohet niveli i lartë i aplikimeve dhe i krahasueshëm edhe me vitin e mëparshëm përsa i përket preferencave për të gjitha degët, me një total aplikimesh prej 21467 studentë për Vitin Akademik 2019-2020.

Tabela 4.1.2.2. Aplikime-pranime 2019-2020, FE

Viti Akademik	Raundi I		Raundi II		Gjithsej
2019 - 2020	Aplikant	Regjistruar	Aplikant	Regjistruar	
	21467	1106	5358	73	1200
Informatika	Raundi I		Raundi II+III		Gjithsej
Ekonomike	Aplikant	Regjistruar	Aplikant	Regjistruar	
	4364	224	926	10+6	240
Financë	Raundi I		Raundi II+III		Gjithsej
	Aplikant	Regjistruar	Aplikant	Regjistruar	
	5699	429	1074	8+3	440
Ekonomiks	Raundi I		Raundi II+III		Gjithsej
	Aplikant	Regjistruar	Aplikant	Regjistruar	
	4373	57	1375	36+6	100
Administrim Biznesi	Raundi I		Raundi II+III		Gjithsej
	Aplikant	Regjistruar	Aplikant	Regjistruar	

7031

396

1983


19+5

420

Referuar tabelës 4.1.2.2, gjithsej studentë të pranuar janë 1200 studentë duke pasur një konkurrencë të lartë me 1 me 18 studentë. Numrin më të lartë të pranimeve gjithashtu mbeten për degët e Administrim Biznesit dhe Financës duke pasur edhe një kërkesë dhe konkurrueshmëri më të lartë krahasuar me dy degët e tjera. Numrin më të lartë të aplikimeve e ka dega e Administrim biznesit me rreth 7030 aplikantë pasuar nga dega e Financës me rreth 5700 aplikantë dhe më pas dega e Ekonomiksit dhe Informatika Ekonomike me rreth 4370 aplikantë. Ajo që vihet re është që për degën e Informatikës Ekonomike numri i pranimeve është më i lartë ndërkohë ka një diferencë, ndonëse të vogël krahasuar me Ekonomiksin disi më të ulët të aplikantëve.


Grafiku i dhënë në figurën 4.1.2.1 ilustron interesin në rritje të aplikimeve për të katër programet e studimit nga Viti Akademik 2018-2019 në atë 2019-2020.

Figura 4.1.2.1. Aplikimet Bachelor FE




Për të pasur një pasqyrim më të qartë në lidhje me kërkesën në secilin prej programeve të studimit kemi paraqitur këtë grafik aplikim-pranim për Vitin Akademik 2018-2019, nga ku vihet re që numri i aplikimeve është shumë më i madh sesa ai i pranimeve, gjë që tregon interesin e lartë që ka për degët e studimit në FE. Në degën e Financës dhe të Administrim Biznesit kuotat për këtë vit akademik janë përkatësisht 460 për secilin prej këtyre dy degëve.

Figura 4.1.2.2. Aplikimet - Pranimet Bachelor FE




Ndërkohë që për Vitin Akademik 2019-2020 siç tregon dhe figura 4.1.2.3 ka një rënie të vogël të numrit të pranimeve për të katër programet e studimit.

Figura 4.1.2.3. Regjistrimet Bachelor FE



Numri i lartë i kërkesave për degët e FE ruan të njëjtin trend si në Vitin Akademik 2018-2019 ashtu edhe për Vitin Akademik 2019-2020, ilustruar nga grafiku i dhënë në figurën 4.1.2.4, e cila tregon që sërish program i studimit Administrim Biznesi ka ruan trendin duke patur numrin më të lartë të aplikimeve.

Figura 4.1.2.2. Aplikimet-Pranimet Bachelor FE 2019-2020



Edhe për 2019-2020 kërkesa mbetet e lartë, edhe për programe studimi të FE të cilat kanë kuota të ulëta pranimi si Ekonomiksi.


Për Vitin Akademik 2020-2021, numri i aplikantëve për Fakultetin e Ekonomisë ishte 21467 në raundin e parë dhe 5358 në raundin e dytë, ndërkohë që në raundin e parë u regjistruan 1106 studentë dhe në raundin e dytë 78 studentë. Sërish vihet re që pjesa më e madhe e studentëve, në të gjitha degët, janë regjistruar në raundin e parë. Kuotat më të larta të pranimeve janë në programet e studimit për Financë dhe Administrim biznesi (440 dhe 420 studentë përkatësisht).

Tabela 4.1.2.3. Aplikime-pranime 2020-2021, FE

Viti Akademik	Raundi I		Raundi II		Gjithsej	Mesatarja
2020 - 2021	Aplikant	Regjistruar	Aplikant	Regjistruar		
	21467	1106	5358	78	1200	9.63
Informatika	Raundi I		Raundi II+III		Gjithsej	Mesatarja
Ekonomike	Aplikant	Regjistruar	Aplikant	Regjistruar		
	4164	230	765	7+3	240	9.72
Financë	Raundi I		Raundi II+III		Gjithsej	Mesatarja
	Aplikant	Regjistruar	Aplikant	Regjistruar		
	5138	415	1172	20+5	440	9.66
Ekonomiks	Raundi I		Raundi II+III		Gjithsej	Mesatarja
	Aplikant	Regjistruar	Aplikant	Regjistruar		
	3826	47	1174	48+5	100	9.7
Administrim	Raundi I		Raundi II+III		Gjithsej	Mesatarja
Biznesi	Aplikant	Regjistruar	Aplikant	Regjistruar		
	6534	357	2050	51+12	420	9.46

Në grafikun e mëposhtëm janë projektuar aplikimet dhe regjistrimet në FE, ku vihet re një trend në ulje të lehtë të aplikimeve për Vitin Akademik 2020-2021.

Figura 4.1.2.5. Aplikimet-Pranimet Bachelor FE 2020-2021




Viti Akademik 2021-2022 ka të njëjtat kuota pranimi ndërkohë që numri total i aplikantëve është 19766 në raundin e parë dhe 5580 në raundin e dytë. Programet e studimit me numër më të lartë aplikimesh vazhdojnë të jenë Financë dhe Administrim Biznesi edhe pse me një ulje rreth 100 aplikime më pak se Viti Akademik 2020-2021.

Tabela 4.1.2.4. Aplikime-pranime 2021-2022, FE

Viti Akademik	Raundi I		Raundi II		Gjithsej	Mesatarja
2021 - 2022	Aplikant	Regjistruar	Aplikant	Regjistruar		
	19766	1064	5580	98	1200	9,58
Informatika Ekonomike	Raundi I		Raundi II+III		Gjithsej	Mesatarja
	Aplikant	Regjistruar	Aplikant	Regjistruar		
	4433	230	895	9+1	240	9.77
Financë	Raundi I		Raundi II+III		Gjithsej	Mesatarja
	Aplikant	Regjistruar	Aplikant	Regjistruar		
	5090	414	1306	19+7	440	9.66
Ekonomiks	Raundi I		Raundi II+III		Gjithsej	Mesatarja
	Aplikant	Regjistruar	Aplikant	Regjistruar		
	3790	53	1202	38+9	100	9.37

Administrim Biznesi	Raundi I		Raundi II+III		Gjithsej	Mesatarja
	Aplikant	Regjistruar	Aplikant	Regjistruar		
	6453	367	2177	32+21	420	9.53

Figura 4.1.2.6. Aplikimet-Pranimet Bachelor FE 2021-2022



Në lidhje me mesataren e studentëve të regjistruar vihen re tre dukuri:

E para, në përgjithësi nota mesatare e studentëve të regjistruar në Fakultetin e Ekonomisë është e lartë në krahasim me fakultetet e tjera të Universitetit të Tiranës.


E dyta, rezulton që nota mesatare e të regjistruarve ruan trendin nga Viti Akademik 2020-2021 në Vitin Akademik 2021-2022, duke pasur luhatje të vogla.

E treta, degët që kanë mesatare më të lartë të të regjistruarve janë Financë dhe Informatika Ekonomike. Ky trend vazhdon që prej shumë vitesh dhe është i lidhur drejtpërdrejt me mundësitë më të mëdha që këto dy degë kanë në tregun e punës. Edhe pas përfundimit të programit Bachelor një pjesë e mirë e studentëve të programeve të tjera kërkojnë të vazhdojnë programin Master në degën e Financës ose Kontabilitetit.

Gjithsesi FE mbetet një ndër Fakultetet që pranon studentët e mirë dhe disa prej tyre e kanë edhe preferencë të parë (nota mesatare 9.6 në Vitin Akademik 2020-2021 dhe 9.5 për 2021-2022). Studentët më të mirë zgjedhin degën e Financës dhe Informatikës Ekonomike dhe kjo është e dukshme për studentët e pranuar në të dy vitet akademike.


Siç tregon edhe grafiku në figurën 4.1.2.7, në katër vitet e fundit akademike në Fakultetin e Ekonomisë ka një numër të lartë aplikimesh, duke treguar në këtë mënyrë interesin konstant për të katër programet e studimit në bachelor të ofruara nga ky fakultet.

Figura 4.1.2.7. Aplikimet Bachelor FE



Grafiku i mëposhtëm jep informacion për secilin program studimi të Fakultetit të Ekonomisë gjatë këtyre katër viteve akademike. Ajo që vihet re është se numri i aplikimeve për secilin program ruan trendin ose duke mbetur në vlera të përafërta ose duke pasur rritje në aplikime. Dy programet e studimit më të konsoliduar janë Financë edhe Informatika Ekonomike, ndërkohë që Ekonomiks është program i studimit me kërkesë më të ulët por me numër aplikimesh të qëndrueshëm ndër vite. Programi i studimit Administrim Biznesi edhe pse ka vazhdimisht numrin më të lartë të aplikimeve vihet re që ka një trend në ulje të kërkesës për aplikim, për këtë arsye duhet që nga ana e fakultetit të punohet më shumë për promovimin e këtij program studimi.

Figura 4.1.2.8. Aplikimet sipas programeve të studimit - Bachelor FE



Duhet pranuar se ekziston dhe një mungesë njohjeje nga ana e aktorëve të tregut të punës, privatë apo publikë, e specifikave të degëve që ofron Fakulteti i Ekonomisë. Kjo shtron si nevojë imediate promovimin e programeve të studimit me specifikat e tyre tek të gjithë aktorët e tregut. Ndoshta këtu mund të përfshihen jo vetëm programet e studimit por edhe lëndë apo çështje specifike që trajtohen në secilin program që mund të jetë me interes në njohuritë e marra për kërkesat e ndryshme që mund të kenë degë të ekonomisë.

Cikli i dytë

Fakulteti i Ekonomisë ofron 19 programe studimi në Ciklin e dytë, prej të cilëve 11 programe janë Master i Shkencave dhe 8 programe janë Master Profesional.

- Master Shkencor Administrim Biznes
- Master Shkencor Administrim Publik
- Master Shkencor Ekonomiks
- Master Shkencor Financë
- Master Shkencor Kontabilitet
- Master Shkencor Manaxhim Turizëm
- Master Shkencor Marketing
- Master Shkencor Menaxhim Risku
- Master Shkencor në Statistika Zyrtare
- Master Shkencor Siguri Informacioni
- Master Shkencor Sisteme Informacioni
- Master Profesional Administrim Biznes

- Master Profesional Administrim Publik
- Master Profesional Financë
- Master Profesional Financë, Kont. Auditim
- Master Profesional Kontabilitet
- Master Profesional Marketing
- Master Profesional Sisteme Informacioni në Ekonomi
- Master Profesional Teknologji Informacioni dhe manaxhimi i proceseve të biznesit

Tabela 4.1.2. 3: Programet e studimit të Ciklit të dytë dhe aplikime-pranime (Viti Akademik 2018- 2019)

Programet e studimit	Aplikant	Regjistruar	Mesatarja e studentëve të pranuar	Studentë nga Fakulteti i Ekonomisë	Studentë nga Rrethet (publike)	Studentë nga Fakultetet jopublike	Studentë nga Fakultete të Huaja	Studentë nga Trojet	Studentë nga Fakultete të tjera, UT
Master Shkencor Administrim Biznes	157	54	7,05	44	5	1	1	-	3
Master Shkencor Administrim Publik	69	37	7,43	17	1	4	1	1	13
Master Shkencor Ekonomiks	51	29	7,44	22	6	-	-	1	-
Master Shkencor Financë	386	113	7,73	110	1	2	-	-	-
Master Shkencor Kontabilitet	291	77	7,71	70	2	5	-	-	-
Master Shkencor Marketing	144	67	6,51	47	9	8	-	-	3
Master Shkencor Menaxhim Risku	133	28	7,63	26	-	2	-	-	-
Master Shkencor Siguri Informacioni	139	56	7,51	55	-	1	-	-	-
Master Shkencor Sisteme Informacioni	139	55	7,87	54	-	-	-	-	1
Master Profesional Administrim Biznes	262	49	6,3	32	14	3	-	-	-
Master Profesional Financë	511	151	6,6	109	27	15	-	-	-
Master Profesional Financë, Kont. Auditim	367	48	6,42	48	-	-	-	-	-
Master Profesional Kontabilitet	344	117	6,63	86	24	7	-	-	-
Master Profesional Marketing	230	70	6,34	42	16	3	-	-	9
Master Profesional Sisteme Informacioni në Ekonomi	145	25	6,36	19	5	-	-	-	1
Master Profesional Teknologji Informacioni dhe manaxhimi i proceseve të biznesit	104	19	6,32	9	9	-	-	-	1

Në tabelën e mësipërme dhe grafikun e mëposhtëm, për Vitin Akademik 2018-2019, vihet re që pjesa dërmuese e studentëve të regjistruar 79.4% kanë mbaruar programin Bachelor në Fakultetin e Ekonomisë, 12% kanë ardhur nga universitete të tjera të rretheve publike, 5.1% nga universitete të tjera jo publike dhe 3.5% nga Fakultete të tjera UT. Vihet re që për Masterin në Administrim Publik ka një përqindje më të lartë të studentëve nga universitete të tjera dhe jo të FE, ndërsa për Masterin Profesional Financë, Kontabilitet Auditim, Masterin Shkencor Siguri Informacioni dhe Masterin Shkencor Sisteme Informacioni, përqindja e studentëve nga Fakulteti i Ekonomisë varion nga 98.2%- 100%.

Figura 4.1.2. 3. Të regjistruar sipas Fakulteteve (2018-2019)




Tabela 4.1.2. 4: Programet e studimit të Ciklit të dytë dhe aplikime-pranime (Viti Akademik 2019- 2020)

Programet e studimit	Aplikant	Regjistruar	Mesatarja e studentëve të pranuar	Studentë nga Fakulteti i Ekonomisë	Studentë nga Rrethet (publike)	Studentë nga Fakultetet jopublike	Studentë nga Fakultete të Huaja	Studentë nga Trojet	Studentë nga Fakultete të tjera, UT
Master Shkencor Administrim Biznes	162	41	7,41	31	8	1	-	-	1
Master Shkencor Administrim Publik	70	42	7,49	11	9	11	-	-	11
Master Shkencor Ekonomiks	51	25	7,59	13	8	4	-	-	-
Master Shkencor Financë	396	102	7,81	98	3	-	1	-	-
Master Shkencor Kontabilitet	323	71	7,97	65	5	-	1	-	-
Master Shkencor Manaxhim Turizëm	24	24	6,65	8	8	5	-	-	3
Master Shkencor Marketing	160	60	6,82	43	9	4	-	-	4
Master Shkencor Menaxhim Risku	143	32	7,99	21	6	3	1	1	-
Master Shkencor në Statistika Zyrtare	51	12	6,59	4	3	1	-	-	4
Master Shkencor Siguri Informacioni	95	41	7,64	32	4	2	-	-	3
Master Shkencor Sisteme Informacioni	120	50	7,73	47	1	1	-	-	1
Master Profesional Administrim Biznes	192	31	6,54	11	16	1	-	-	3
Master Profesional Financë	360	131	6,37	92	34	3	-	-	2
Master Profesional Financë, Kont. Auditim	263	43	6,58	31	6	6	-	-	-
Master Profesional Kontabilitet	250	93	6,81	49	32	12	-	-	-
Master Profesional Marketing	197	41	6,78	13	14	7	-	-	7
Master Profesional Sisteme Informacioni në Ekonomi	90	17	6,5	8	4	3	-	-	2
Master Profesional Teknologji Informacioni dhe manaxhimi i proceseve të biznesit	93	27	6,66	14	4	6	-	-	3

Gjatë vitit akademik 2019-2020 ka një rritje me 12.5 pikë përqindje e numrit të studentëve nga fakultete jashtë FE, por përsëri ngelet dominant numri i atyre nga FE. Degët e Master Profesional Marketing, Master Shkencor Administrim Publik, Master Shkencor Menaxhim Turizëm, dhe Master Shkencor në Statistika Zyrtare, shfaqin edhe përqindjen më të vogël të studentëve nga FE.

Figura 4.1.2. 4:: Të regjistruar sipas fakulteteve në Ciklin e Dytë (2019-2020)




Tabela 4.1.2. 5: Programet e studimit të Ciklit të dytë dhe aplikime-pranime (Viti Akademik 2020- 2021)

Programet e studimit	Aplikant	Regjistruar	Mesatarja e studentëve të pranuar	Studentë nga Fakulteti i Ekonomisë	Studentë nga Rrethet (publike)	Studentë nga Fakultetet jopublike	Studentë nga Fakultete të Huaja	Studentë nga Trojet	Studentë nga Fakultete të tjera, UT
Master Shkencor Administrim Biznes	109	50	7,29	32	5	8	-	1	4
Master Shkencor Administrim Publik	73	34	7,53	10	5	4	-	-	15
Master Shkencor Ekonomiks	71	50	7,1	41	7	2	-	-	-
Master Shkencor Financë	443	102	7,65	102	-	-	-	-	-
Master Shkencor Kontabilitet	375	85	7,75	79	3	2	1	-	-
Master Shkencor Manaxhim Turizëm	19	21	6,99	6	12	1	-	-	2
Master Shkencor Marketing	173	75	6,99	57	2	8	-	2	6
Master Shkencor Menaxhim Risku	144	32	7,57	28	1	2	1	-	-
Master Shkencor në Statistika Zyrtare	68	14	7,19	6	5	2	-	-	1
Master Shkencor Siguri Informacioni	147	50	7,64	45	1	2	1	-	1
Master Shkencor Sisteme Informacioni	163	52	7,78	51	1	-	-	-	-
Master Profesional Administrim Biznes	101	29	6,89	8	12	4	1	-	4
Master Profesional Administrim Publik	62	21	6,69	6	6	2	1	1	5
Master Profesional Financë	286	162	6,49	131	25	6	-	-	-
Master Profesional Financë, Kont. Auditim	237	48	6,83	46	-	2	-	-	-
Master Profesional Kontabilitet	199	99	6,66	82	13	4	-	-	-
Master Profesional Marketing	116	47	6,75	24	9	5	-	-	9
Master Profesional Sisteme Informacioni në Ekonomi	111	39	6,38	24	10	4	-	-	1
Master Profesional Teknologji Informacioni dhe manaxhimi i proceseve të biznesit	73	26	6,35	13	5	3	-	1	4

Në vitin akademik 2020-2021 vihet re rritje e numrit të studentëve nga fakultete brenda FE duke arritur afërsisht nivelin e dy viteve të kaluara dhe duke zvogëluar kryesisht peshën e studentëve që vijnë nga universitetet e tjera publike. Në Masterin Shkencor në Financë, studentët e regjistruar janë 100% nga ata që kanë mbaruar Fakultetin e Ekonomisë. Ndërkohë, Master Shkencor Administrim Publik, vazhdon të shfaqë edhe përqindjen më të vogël të studentëve nga FE.

Figura 4.1.2. 5:: Të regjistruar sipas fakulteteve në Ciklin e Dytë (2020-2021)





Tabela 4.1.2. 6: Programet e studimit të Ciklit të dytë dhe aplikime-pranime (Viti Akademik 2021- 2022)

Programet e studimit	Aplikant	Regjistruar	Mesatarja e studentëve të pranuar	Studentë nga Fakulteti i Ekonomisë	Studentë nga Rrethet (publike)	Studentë nga Fakultetet jopublike	Studentë nga Fakultetet e Huaja	Studentë nga Trojet	Studentë nga Fakultetet tjera, UT
Master Shkencor Administrim Biznes	169	41	7,15	28	3	5	-	-	5
Master Shkencor Administrim Publik	74	29	7,17	14	4	3	-	-	8
Master Shkencor Ekonomiks	71	17	7,55	15	-	1	-	-	1
Master Shkencor Financë	477	121	7,84	121	-	-	-	-	-
Master Shkencor Kontabilitet	382	103	8,5	101	-	2	-	-	-
Master Shkencor Manaxhim Turizëm	32	20	6,75	6	-	4	-	-	10
Master Shkencor Marketing	241	81	6,96	74	2	-	-	-	5
Master Shkencor Menaxhim Risku	167	27	7,42	22	4	1	-	-	-
Master Shkencor në Statistika Zyrtare	51	15	6,22	3	3	2	-	-	7
Master Shkencor Siguri Informacioni	151	58	7,75	52	-	3	1	-	2
Master Shkencor Sisteme Informacioni	172	58	8,11	56	-	-	-	-	2
Master Profesional Administrim Biznes	191	35	6,35	27	2	3	-	-	3
Master Profesional Administrim Publik	80	15	6,37	5	1	2	-	-	7
Master Profesional Financë	413	140	6,47	110	20	7	-	-	3
Master Profesional Financë, Kont. Auditim	309	45	6,9	39	4	1	-	-	1
Master Profesional Kontabilitet	293	71	6,65	52	9	5	-	-	5
Master Profesional Marketing	224	46	6,7	25	2	5	-	-	14
Master Profesional Sisteme Informacioni në Ekonomi	142	28	6,56	16	2	5	-	-	5
Master Profesional Teknologji Informacioni dhe manaxhimi i proceseve të biznesit	95	25	6,57	15	1	2	-	-	7

Në vitin akademik 2021-2022 vazhdon rritja e numrit të studentëve nga fakultete brenda FE duke arritur përqindjen më të lartë të këtyre viteve në 80.1% dhe duke zvogëluar akoma më shumë peshën e studentëve që vijnë nga universitetet e tjera. Rritje ka edhe numri i studentëve brenda UT që kanë zgjedhur si degë të dytë Fakultetin e Ekonomisë. Më të shumtë janë ata që kanë zgjedhur Master Shkencor Administrim Publik, Master Shkencor Manaxhim Turizëm, dhe Master Shkencor në Statistika Zyrtare.

Figura 4.1.2. 6:: Të regjistruar sipas fakulteteve në Ciklin e Dytë (2021-2022)



Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të përmblendhura të dhënat në lidhje me shpërndarjen e aplikimeve-regjistrimeve në 4 vitet e fundit akademike. Ka një luhatje relativisht të vogël të kuotave me një rënie në Vitin Akademik 2019-2020 dhe rritje të tyre vitin tjetër e cila kompenson edhe rënien e vitit të kaluar. Rënia e vitit të fundit e çon nivelin e kuotave shumë afër mesatares së katër viteve. Sa i përket aplikimeve, ato kanë një tendencë në rënie për dy vite sidomos për vitin 2019-2020 dhe vitin e fundit një rritje kompesuese të kësaj rënie. Ajo që vlen të nënvizohet është numri i lartë i të regjistruarve si degë e dytë (nga 31 në 85 studentë) dhe prirja pozitive nga viti në vit. Studentët e regjistruar nga ata që kanë mbaruar programin Bachelor në Fakultetin e Ekonomisë mbetet i lartë


(80.1%) dhe kryesisht i qëndrueshëm (përfshirë bën vetëm Viti Akademik 2019-2020) pasuar nga studentët e Fakulteteve të tjera të UT (8.8%) dhe më pas nga fakulteteve të tjera publike (5.8%) dhe Fakulteteve jopublike (5.2%).

Tabela 4.1.2. 7: Aplikime- pranime në ciklin e dytë të studimeve sipas Fakulteteve

Viti akademik	Aplikantë	Regjistruar	Studentë nga Fakulteti i Ekonomisë	Studentë nga Rrethet publike	Studentë nga Fakultetet jopublike	Studentë nga Fakultetet te Huaja	Studentë nga Trojet	Studentë nga Fakultetet UT
2018-2019	3472	995	790	119	51	2	2	31
2019-2020	3040	883	591	174	70	3	1	44
2020-2021	2970	1036	791	122	61	5	5	52
2021-2022	3734	975	781	57	51	1	0	85
Mesatarisht për 4 vitet	3304	972,25	738,25	118	58,25	2,75	2	53


Grafiku i mëposhtëm na tregon raportin e aplikimeve/regjistrime, në të cilën dallojmë një lloj qëndrueshmërie ndër vite me përjashtim të vitit Akademik 2020-2021 ku numri i të regjistruarve është disi më i madh në raport me aplikimet.

Figura 4.1.2. 7. Aplikime-Regjistrime në Ciklin e Dytë



Për të patur një pamje më të plotë të situatës sipas programeve të studimit, në grafikët e mëposhtëm jepet një analizë më e detajuar për studimet e Ciklit të dytë.


Figura 4.1.2. 6. Aplikime në 4 Ciklet Akademike



Gjatë viteve të marra në studim, numri më i lartë i aplikantëve është në degët Master Profesional në Financë, Master Profesional në Kontabilitet, Master Profesional në Financë, Kontabilitet dhe Auditim. Po kështu, të njëjtën sjellje vëmë re edhe te Master Shkencor në Financë dhe Master shkencor në Kontabilitet me një tendencë në rritje përgjatë viteve. Arsytet e kësaj kërkesë të lartë mbeten ato të shpjeguara edhe më lart.


Numri i masterave profesionale zë 42% të degëve të ciklit të dytë, ndërkohë që numri i aplikantëve për to është edhe më i lartë (rreth 47.7% për të katër vitet e marra në studim). Megjithatë aplikimet e studentëve për masterat shkencorë janë në një përqindje më të lartë dhe me një tendencë në rritje në vitet e fundit. Kjo kërkesë e lartë për të studiuar në programet e Masterave shkencorë, reflektohet edhe tek niveli i lartë i aplikimeve në raport me kuotat e pranimeve, e lidhur ndër të tjera, edhe me kërkesat që ka për punësimin, sidomos sektori publik. Në këtë sektor favorizohen të diplomuarit në Master Shkencor.

Figura 4.1.2. 7:: Regjistrime në 4 Ciklet Akademike



Siç vihet re numri i të regjistruarve në programet master profesional ka një luhatje relativisht më të madhe nga masteri shkencor i cili paraqitet më i qëndrueshëm ndër vite. Kjo për shkak edhe të ndryshimit të kuotave në një pjesë të programeve që janë më të kërkuara nga studentët. Masteri Profesional apo Shkencor në Financë mbetet në nivelet më të larta. Lindur nga nevojat e tregut vihet re një rritje e pranimeve në Masterin Profesional apo Shkencor për degën e Kontabilitetit. Gjithashtu, vihet re që niveli më i ulët është te Masteri në Administrim Publik dhe Masteri Shkencor Turizëm. Realisht për këto degë edhe interesi për të aplikuar ka qenë i ulët. Në ndryshim nga numri i aplikimeve të mëdha te Masteri Profesional në Financë, Kontabilitet dhe Auditim, numri i të regjistruarve është relativisht i vogël dhe me një qëndrueshmëri ndër vite.

Figura 4.1.2. 8: Mesatarja në 4 Ciklet Akademike



Nga krahasimi i mesatareve të studentëve të regjistruar në Ciklin e dytë vihen re dy dukuri:

E para, studentët me mesatare më të lartë janë regjistruar, në të katër vitet akademike, në programet Master Shkencor Kontabilitet, Master Shkencor Sisteme Informacioni, të cilat shfaqin edhe një prirje pozitive vitin e fundit. Rritja e mesatares për studentët e përfshirë në këto degë shpjegohet me kërkesën e zhvendosur nga njëra degë te tjetra. Kjo mesatare ka ardhur në rritje ndjeshëm krahasuar me studentët e regjistruar një vit më parë. Mesatarja e tyre arrin përkatësisht 8.5 dhe 8.1, vitin e fundit. Rritja e konkurrueshmërisë për t'u përfshirë në këto degë ka ardhur në rritje duke sjellë edhe cilësi në nivelin e studentëve të përfshirë në to. Mesatarja më e lartë pasuese shfaqet te Master Shkencor Financë me shumë pak ndryshime ndër vite, dhe Master Shkencor Menaxhim Risku me një tendencë të vogël në rënie 2 vitet e fundit.

E dyta, ndryshimet e mesatareve për secilin program, në të katër vitet akademike në studim janë thuajse të padukshme. Luhatshmëria më e madhe duket te Masteri Shkencor në Statistika Zyrtare, degë relativisht e re krahasuar me të tjerat.

4.1.3 Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Cikli i parë

Kërkesat për të studiuar në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja kanë ardhur në rënie, sidomos me futjen e mesatares së pranimi nga MASR vihet re që nga viti 2018-2019 ku kemi pasur 6387 aplikantë në vitin 2019-2020 kemi thajse një përgjysmim të aplikantëve me gjithsej 3566 syresh, dhe vëmë re një rritje të lehtë në vitet në vijim, pra 2020-2021 dhe 2021-2022 me përkatësisht 4170 aplikantë dhe 3814 aplikantë. Edhe pse fakulteti në vetvete mund të parapëlqehet nga maturantët, mendojmë se ka qenë kriteri i mesatares ai që ka ndikuar në uljen e ndjeshme të numrit të aplikimeve.

Tabela 4.1.3. 1. Raporti aplikime-pranime

Viti akademik 2018-2019		Viti akademik 2019-2020	
Aplikantë	Regjistruar	Aplikantë	Regjistruar
6387	771	3566	503

Viti akademik 2020-2021		Viti akademik 2021-2022	
Aplikantë	Regjistruar	Aplikantë	Regjistruar
4170	582	3814	529

Gjithashtu, nga të dhënat e tabelës së mësipërme dallojmë që kjo rënie në numrin e aplikantëve është shoqëruar edhe me një rënie në numrin e pranimeve. Kështu, në vitin akademik 2018-2019 numri total i studentëve të pranuar ishte 771, ndërsa në vitin akademik 2019-2020 numri i të pranuarve të rinj ka shkuar në 503. Pra, kemi një rënie me rreth 268 studentë të pranuar. Në vitin në vijim, 2020-2021 kemi një rritje të lehtë të të regjistruave, me 79 studentë, krahasuar me një vit më parë. Në vitin 2021-2022 janë regjistruar sërish 53 studentë më pak, pra gjithsej 529.

Ndërkohë për sa i përket shpërndarjes së këtyre studentëve të pranuar sipas degëve, në vitin akademik 2018-2019 numrin më të lartë e zë dega “Gjuhë Angleze” me 244 studentë të pranuar. Numër të konsiderueshëm pranimesh ka edhe në degët e tjera: “Gjuhë Italiane” me 150 të pranuar, “Gjuhë Gjermane” me 121 të pranuar, Dega “Gjuhë Frënge” me 116 të pranuar, etj:

Tabela 4.1.3. 2. Numri i pranimeve sipas degëve (2018-2019)

CIKLI I BACHELOR		Gjithsej Pranuar të rinj	Mesatarja e studentëve të pranuar	
	FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA 2018-2019			
1	DEGA GJUHË ANGLEZE	244	7e pranimi	8.1
2	DEGA GJUHË FRËNGE	116	7	8.3
3	DEGA GJUHË ITALIANE	150	7	7.6
4	DEGA GJUHË GJERMANE	121	7	7.9
5	DEGA GJUHË GREKE	17	7	7.6
6	DEGA GJUHË RUSE	6	7	7.5
7	DEGA GJUHË TURKE	51	7	7.1
8	DEGA GJUHË SPANJOLLE	66	7	7.6
TOTALI		771		

Një tjetër element që bie në sy është cilësia e studentëve të pranuar. Në vitin akademik 2018-2019 për të gjitha degët nota mesatare e studentëve të pranuar është mbi 7, pasi kusht i pranimi ishte mesatarja 7.

Edhe në vitin akademik 2019-2020, me gjithë rritjen e mesatares nga 7 në 7,5 numrin më të lartë të pranimeve e ka dega “Gjuhë Angleze” me 243 studentë të pranuar, gjë që vërteton faktin që Gjuha Angleze vazhdon të mbetet dega më e preferuar për studentet e rinj. Ajo që bie në sy nga krahasimi i tabelave, është se pavarësisht numrit të studentëve të pranuar në këtë degë, nota mesatare e studentëve fitues ka ardhur në rritje nga 8.1 (për vitin akademik 2018-2019) në 8.3 (për vitin akademik 2019-2020). Dega “Gjuhë Gjermane” tregon krahasimisht me një vit më parë qëndrueshmëri si në numrin e pranimeve ashtu edhe në mesatare. Degët e tjera kanë rënie të ndjeshme të numrit të studentëve të regjistruar, ndërsa dega “Gjuhë Ruse” duke filluar nga ky vit nuk ka asnjë student të regjistruar:

Tabela 4.1.3. 3. Numri i pranimeve sipas degëve (2019-2020)

CIKLI I BACHELOR		Gjithsej Pranuar të rinj	Mesatarja e studentëve të pranuar	
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA 2019-2020				
1	DEGA GJUHË ANGLEZE	243	7.5 e pranimi	8.3

2	DEGA GJUHË FRËNGE	45	7.5	7.9
3	DEGA GJUHË ITALIANE	60	7.5	7.7
4	DEGA GJUHË GJERMANE	118	7.5	8
5	DEGA GJUHË GREKE	4	7.5	7.6
6	DEGA GJUHË RUSE	0	7.5	-
7	DEGA GJUHË TURKE	10	7.5	7.6
8	DEGA GJUHË SPANJOLLE	23	7.5	7.9
TOTALI		503		

Degët me të synuara nga studentët më të mirë, d.m.th ata që kanë mesataren më të lartë, janë dega Gjuhë Angleze (mesatarja 8.3), dega Gjuhë Gjermane (mesatarja 8), dhe degët Gjuhë Frënge dhe Gjuhë Spanjolle (mesatarja 7,9).

Sa i përket vitit akademik 2020-2021 dega “Gjuhë Angleze” vijon të plotësojë kuotat së bashku me degën “Gjuhë Gjermane” me përkatësisht 241 dhe 121 studentë të pranuar, gjë që vërteton faktin që këto degë vijojnë të mbeten më të preferuarat për studentët e rinj. Ajo që bie në sy nga krahasimi i tabelave, është se pavarësisht numrit të studentëve të pranuar në këtë degë, nota mesatare e studentëve fitues lëviz në të njëjtat nivele ndërmjet notës 7.5 dhe 8.2.

Tabela 4.1.3. 4. Numri i pranimeve sipas degëve (2020-2021)

CIKLI I I BACHELOR		Gjithsej		
	FAKULTETI I GJUHËVE	Pranuar	Mesatarja e studentëve	
	TË HUAJA 2020-2021	të rinj	të pranuar	
1	DEGA GJUHË ANGLEZE	241	7 e pranimi	8.2
2	DEGA GJUHË FRËNGE	54	7	7.8
3	DEGA GJUHË ITALIANE	92	7	7.7
4	DEGA GJUHË GJERMANE	121	7	7.9
5	DEGA GJUHË GREKE	6	7	7.5
6	DEGA GJUHË RUSE	0	7	-
7	DEGA GJUHË TURKE	33	7	7.5
8	DEGA GJUHË SPANJOLLE	35	7	7.6
TOTALI		582		

Degët me të synuara nga studentët më të mirë, d.m.th ata që kanë mesataren më të lartë, janë dega Gjuhë Angleze (mesatarja 8.3), dega Gjuhë Gjermane (mesatarja 8), dhe degët Gjuhë Frënge dhe Gjuhë Spanjolle (mesatarja 7,9).

Për vitin akademik 2021-2022 vëmë re një rënie të lehtë të numrit të regjistrimeve, e cila nuk prek dy degët tashmë kryesore të FGJH-së, degën e “Gjuhës Angleze” dhe atë të “Gjuhës Gjermane” të cilat vijonë të kenë përkatësisht 240 dhe 120 studentë të regjistruar, duke plotësuar kështu kuotat e vëna nga MAS. Degët e tjera kanë numër thuajse të njëjtë regjistrimesh ose dëshmojnë një tendencë në ulje të numrit të regjistrimeve.

Tabela 4.1.3. 5. Numri i pranimeve sipas degëve (2021-2022)

CIKLI I I BACHELOR		Gjithsej	
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA 2021-2022		Pranuar të rinj	Mesatarja e studentëve të pranuar
1 DEGA GJUHË ANGLEZE		240	7 e pranimi 7.9
2 DEGA GJUHË FRËNGE		36	7 7.6
3 DEGA GJUHË ITALIANE		92	7 7.5
4 DEGA GJUHË GJERMANE		120	7 7.8
5 DEGA GJUHË GREKE		3	7 7.6
6 DEGA GJUHË RUSE		0	7 -
7 DEGA GJUHË TURKE		16	7 7.5
8 DEGA GJUHË SPANJOLLE		22	7 7.8
TOTALI		529	

Cikli i dytë

Për sa i përket ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave, numri i aplikantëve në vitin akademik 2018-2019 ka qenë relativisht i lartë pothuajse në të gjitha programet e studimit. Në programin e studimit “Mësuesi” janë pranuar në total 337 studentë nga 383 aplikantë; Në programin “Gjuhë dhe komunikim ndërkulturor dhe turistik” janë pranuar 41 nga 91 aplikantë; Në programin “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” janë pranuar 77 nga 124 aplikantë. Programi më i preferuar për studentët është “Mësuesi në Gjuhë Angleze”, çka vërtetohet nga numri më i lartë i kërkesave për këtë program (185 aplikantë). Ndërkohë mesatarja e përgjithshme e studentëve që pranohen në programin mësuesi është disi më e lartë se ajo e studentëve të pranuar në programe të tjera (rreth 7.22).

Siç shihet nga tabela 4.1.3.6, pjesa dërrmuese e studentëve që janë pranuar në programet e studimit Master i Shkencave për vitin akademik 2018-2019 vijnë nga Universiteti i Tiranës. Gjithësesi, i konsidrueshëm është edhe numri i studentëve që vijnë nga universitetet e tjera publike: “Mësuesi” 51 studentë; “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” 7 studentë; dhe “Gjuhë dhe komunikim ndërkulturor dhe turistik” 6 studentë. Ndërkohë që numri i studentëve që vijnë nga universitetet jopublike është shumë i vogël, me vetëm 10 studentë në total nga të gjitha programet e studimit:

Tabela 4.1.3. 6. Master i shkencave në FGJH (viti akademik 2018-2019)

Program i studimit	Aplikantë	Regjistruar	Mesatarja e studentëve të pranuar	Studentë nga UT	Studentë nga universitete publike	Studentë nga universitete jopublike
Mësuesi						
Gjuhë Angleze	185	145	7.25	110	25	10
Gjuhë Italiane	56	55	6.92	53	2	
Gjuhë Frënge	54	54	6.9	48	6	
Gjuhë Gjermane	59	54	7.12	36	18	
Gjuhë Turke	17	17	7.2	17		
Gjuhë Greke	12	12	7.93	12		
Gjuhë dhe komunikim ndërkulturor dhe turistik	91	41	7.1	35	6	
Përkthim teknik - letrar dhe interpretim	124	77	7.08	70	7	

Në vitin akademik 2019-2020, numri i përgjithshëm i aplikantëve dhe të regjistruarve për ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave vazhdon të jetë pothuaj në të njëjtat nivele si në vitin 2018-2019. Kështu në programin e studimit “Mësuesi”, kemi një numër thuajse të njëjtë aplikantësh, 380 studentë dhe të regjistruarish 339 studentë. Ndërkohë që vihet re një rënie e lehtë e kërkesave për programin “Gjuhë dhe komunikim ndërkulturor dhe turistik” me 48 aplikantë nga 91 të një viti më parë. Në programin “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” kemi thuajse të njëjtin numër

aplikantësh 128, krahasimisht me 124 të një viti më parë, por një rritje të të regjistruarve me 27 studnetë.

Tabela 4.1.3.7 Master i shkencave në FGJH (viti akademik 2019-2020)

Program i studimit	Aplikantë	Regjistruar	Mesatarja e studentëve pranuar	Studentë nga UT	Studentë nga universitete publike	Studentë nga universitete jopublike
Mësuesi						
Gjuhë Angleze	168	139	7.45	96	36	7
Gjuhë Italiane	38	37	6.9	35	2	
Gjuhë Frënge	89	81	6.92	71	10	
Gjuhë Gjermane	49	47	7.1	40	7	
Gjuhë Turke	23	23	7	23		
Gjuhë Greke	13	12	8	12		
Gjuhë dhe komunikim ndërkulturor dhe turistik	48	23	6.9	13	10	
Përkthim teknik -letrar dhe interpretim	128	104	7.5	88	16	

Vëmë re se në vitet në vijim kemi thajse të njëjtin trend. Aplikimet për programin e studimit “Mësuesi” kanë një rënie të lehtë aplikantësh dhe diçka më pak studentë të regjistruar. Krahasimisht me një vit më parë kemi 23 aplikantë më pak dhe 13 të regjistruar më pak. Kjo rënie ama është në proporcion të zhdrejtë me rritjen në programin “Mësuesi e Gjuhës Angleze” ku vihen re 28 aplikantë dhe 32 të regjistruar më shumë se një vit më parë. Ndryshime vëmë re në aplikimet dhe regjistrimet në programet e studimit “Gjuhë dhe komunikim ndërkulturor dhe turistik”, ku për vitin 2020-2021 kemi gjithashtu një rritje të lehtë pranimesh: janë pranuar 34 studentë (nga 23 studentë një vit më parë); ndërsa në programin “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” vëmë re rënie: janë pranuar 71 studentë (nga 104 studentë të një viti më parë). Si përfundim, programi më i preferuar për studentët vazhdon të mbetet “Mësuesi në Gjuhë Angleze” me 196 aplikantë dhe 171 pranime.

Tabela 4.1.3.8 Master i shkencave në FGJH (viti akademik 2020-2021)

Program studimit	i	Aplikantë	Regjistruar	Mesatarja e studentëvetë pranuar	Studentë nga UT	Studentë nga universitete publike	Studentë nga universitete jopublike
Mësuesi							
Gjuhë Angleze		196	171	7.38	157	12	2
Gjuhë Italiane		45	44	6.8	43	1	
Gjuhë Frënge		52	50	7	41	9	
Gjuhë Gjermane		40	38	7.2	35	3	
Gjuhë Turke		12	11	7.85	12		
Gjuhë Greke		12	12	8.02	12		
Gjuhë dhe komunikim ndërkulturor dhe turistik		56	34	7	29	1	4
Përkthim teknik -letrar dhe interpretim		98	71	7.32	65	5	1

Për vitin akademik 2021-2022 vëmë re në përgjithësi një rënie të aplikimeve, të cilat në këtë vit arrijnë pikën më të ultë të tyre duke filluar nga viti akademik 2018-2019 dhe duke kapur nivelin e 347 aplikantëve dhe të 291 të regjistruarve për programin “Mësuesi”, i cili është programi që ka pësuar luhatjet më të mëdha në këtë vit akademik. Programet e tjera ndjekin pak a shumë të njëjtin trend dhe dëshmojnë luhatje të lehta. Sidoqoftë në vitin akademik 2021-2022 janë regjistruar në të trija programet së bashku 383 studentë, numër ky më i ulët se në vitet më parë.

Tabela 4.1.3.9 Master i shkencave në FGJH (viti akademik 2021-2022)

Program studimit	i	Aplikantë	Regjistruar	Mesatarja e studentëvetë pranuar	Studentë nga UT	Studentë nga universitete publike	Studentë nga universitete jopublike
Mësuesi							
Gjuhë Angleze		188	138	7.4	130	8	1
Gjuhë Italiane		42	40	6.91	38	2	
Gjuhë Frënge		38	37	7	35	2	

Gjuhë Gjermane	61	58	7.2	39	19	
Gjuhë Turke	12	12	7.03	12		
Gjuhë Greke	6	6	8	6		
Gjuhë dhe komunikim ndërkulturor dhe turistik	81	31	7.05	24	7	
Përkthim teknik -letrar dhe interpretim	103	61	7.8	53	8	3

Nëse i referohemi të dhënave të tabelave të mësipërme, shohim se për vitin akademik 2018-2019 kemi 64 studentë nga universitetet e tjera publike; 2019-2020 ky numër rritet me 17 studentë dhe shkon në 81, për vitin 2020-2021 numri bie ndjeshëm me 50 studentë, pra regjistrohen vetëm 31 studentë nga universitetet e tjera publike dhe për vitin 2021-2022 shohim një rritje të lehtë me 46 studentë. Gjithsesi, duhet theksuar se përsëri pjesa më e madhe e studentëve që pranohen në programet e studimit Master i Shkencave vijnë nga Universiteti i Tiranës.

Nga ana tjetër masteri profesional në “Përkthim me profil përkthyes” ofrohet vetëm në gjuhën angleze dhe regjistron një numër më të vogël aplikantësh, përkatësisht 17 aplikime dhe 8 pranime për vitin akademik 2018-2019; 32 aplikime dhe 24 pranime për vitin akademik 2019-2020; 15 aplikime dhe 11 pranime për vitin akademik 2020-2021 dhe 43 aplikime dhe 23 pranime për vitin akademik 2021-2022, dhe pranimesh (17 studentë). Shumica e studentëve dhe në këtë rast vijnë nga Universiteti i Tiranës. Pavarësisht numrit të paktë të studentëve, vlen të theksohet fakti që mesatarja e përgjithshme e tyre është rreth 7:

Tabela 4.1.3.10: Master profesional në FGJH (viti akademik 2018-2019)

Programi i studimit	Aplikantë	Regjistruar	Mesatarja e studentëve të pranuar	Studente nga Trojet	Studentë nga universitete publike	Studentë nga universitete jopublike

Master Profesional në"Përkthim me profil përkthyes"						
Gjuhë Agleze	17	8	7.12		6	2

Tabela 4.1.3.11: Master profesional në FGJH (viti akademik 2019-2020)

Programi i studimit	Aplikantë	Regjistruar	Mesatarja e studentëvetë pranuar	Studente ngaTrojet	Studentë nga universitete publike	Studentë nga universitete jopublike
Master Profesional në"Përkthim me profil përkthyes"						
Gjuhë Agleze	32	24			13	11

Tabela 4.1.3.12: Master profesional në FGJH (viti akademik 2020-2021)

Programi i studimit	Aplikantë	Regjistruar	Mesatarja e studentëvetë pranuar	Studente ngaTrojet	Studentë nga universitete publike	Studentë nga universitete jopublike
Master Profesional në"Përkthim me profil përkthyes"						
Gjuhë Agleze	15	11	7.3		7	4

Tabela 4.1.3.13: Master profesional në FGJH (viti akademik 2021-2022)

Programi i studimit	Aplikantë	Regjistruar	Mesatarja e studentëvetë pranuar	Studente ngaTrojet	Studentë nga universitete publike	Studentë nga universitete jopublike

Master Profesional në "Përkthim me profil përkthyes"						
Gjuhë Agleze	43	23	6.93		21	2

Në përgjithësi vihet re një trend në rënie për vitin akademik 2020-2021 në Masterin Profesional dhe për vitin akademik 2021-2022 për Masterin Shkencor si në numrin e të interesuarve (aplikantëve), ashtu edhe në numrin e të regjistruarve.

*Informacioni i gjendur në tabela është marrë nga sekretaritetë përkatëse të FGJH-së më 23.06.2022.

4.1.4 Fakulteti i Histori Filologjisë

Cikli i Parë

Fakulteti i Histori Filologjisë ofron këto programe studimi në Ciklin e Parë:

- Bachelor Arkeologji
- Bachelor Histori
- Bachelor Gazetari
- Bachelor Gjeografi
- Bachelor Gjuhë-Letërsi

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur aplikimet për secilin program studimi në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë. Në përgjithësi vihet re një ulje e kërkesës për secilin program studimi dhe sidomos në dy programet e studimit Bachelor Histori dhe Bachelor Gjeografi.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm janë paraqitur regjistrimet në tre vitet e fundit akademike dhe vihet re një trendi zbritës sidomos në programet Bachelor Histori dhe Bachelor Gjeografi. Programi i studimit Bachelor Gazetari mbetet më i kërkuari ndër programet e ciklit të parë të ofruara nga FHF.

Programi studimit	Pranuar studentë të rinj V.A 2018-2019	Pranuar studentë të rinj V.A 2019-2020	Pranuar studentë të rinj V.A 2020-2021
Bachelor në Histori	180	94	47
Bachelor në Gjeografi	180	148	99

Bachelor në Arkeologji	100	80	67
Bachelor në Gazetari	122	100	100
Bachelor në Gjuhë-Letërsi	182	164	157
Total	764	586	470




Figura 4.1.4. 1: Regjistrime FHF

Cikli i dytë.

Fakulteti i Histrisë dhe Filologjisë ofron 15 programe studimi në ciklin e dytë, prej të cilëve 9 programe studimi janë Master i Shkencave dhe 6 programe studimi janë Master Profesional, një raport më i balancuar krahasuar me fakultete të tjera të UT.

Msc në Gjuhësi e sotme
Msc në Gjuhësi historike
Msc në Studime letrare
Msc në Histori
Msc në Marrëdhënie Ndërkombëtare
Msc në Arkeologji
Msc në Trashëgimi Kulturore
Msc në Gjeografi
Msc në Gazetari Komunikim
MP, Mësuesi në Gjeografi

MP, Mësuesi në Gjuhë-Letërsi
MP, Mësuesi në Histori
MP, Guidë Turistike
MP në Redaktori
MP në Arkivistikë

Në grafikët e mëposhtëm janë paraqitur Regjistrime në FHF, si dhe numri i studentëve të regjistruar në programet e studimit të FHF, të cilët kanë kryer një program të ciklit të parë në fakultete të tjera, por brenda UT.

Dy programet në të cilët kemi më shumë regjistrime nga fakultete jashtë FHF janë Msc Gazetari dhe MP Mësuesi në Gjeografi.




Figura 4.1.4. 2: Pranime në programet e ciklit të dytë në tre vitet e fundit akademike

Në grafikun e mësipërm vihet re një ulje e numrit të të regjistruarve pothuajse në të gjithë programet e ciklit të dytë që ofrohen nga FHF, me përjashtim të dy programeve, Mater Profesional ne Gjeografi në Mësuesi dhe Mater Profesional ne Histori në Mësuesi.

4.1.5 Fakulteti i Shkencave të Natyrës

Cikli i parë

Fakulteti i Shkencave të Natyrës ofron dhjetë programe studimi në cilkin e parë.

- Bachelor në "Biologji"
- Bachelor në "Bioteknologji"
- Bachelor në "Fizikë"
- Bachelor në "Informatikë"
- Bachelor në "Inxhinieri Matematike dhe Informatike"
- Bachelor në "Kimi dhe Teknologji Ushqimore"
- Bachelor në "Kimi Industriale e Mjedisore"
- Bachelor në "Kimi"
- Bachelor në "Matematikë"
- Bachelor në "Teknologji Informacioni dhe komunikimi"

Në grafikun e mëposhtëm janë projektuar regjistrimet në FSHN në degët e mësuesisë, ku vihet re një trend në rënie nga viti në vit për këto programe studimi. Zvogëlimi i regjistrimeve në këto programe studimi vjen si rezultat i rritjes nga viti në vit i mesatares prag hyrëse në këto programe studimi si dhe i kohëzgjatjes së lartë (minimalisht 7 vjet) që i duhet një maturanti të bëhet mësues. Në nivele më të mira nga kë programe qëndron Bachelor Biologji.





Figura 4.1.5. 1: Pranime FSHN

Për të pasur një pasqyrë më të qartë në lidhje me kërkesën në secilin prej programeve të studimit kemi paraqitur këtë grafik, ku pesë programet më të kërkuara janë Bachelor Informatikë, Bachelor Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, Bachelor Inxhinieri Matematike dhe Informatike dhe Bachelor Bioteknologji.



Cikli i Dytë

Fakulteti i Shkencave të Natyrës ofron 21 programe studimi në ciklin e dytë, prej të cilave 17 programe janë Master i Shkencave dhe 4 programe janë Master Profesional.

- Master i Shkencave në "Biologji Mjedisore"
- Master i Shkencave në "Biologji Molekulare"
- Master i Shkencave në "Biologji", me profil "Mësues biologjie për arsimin e mesëm dhe të lartë"
- Master i Shkencave në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale"
- Master i Shkencave në "Fizikë"
- Master i Shkencave në "Fizikë", me profil "Mësues Fizike për arsimin e mesëm dhe të lartë"
- Master i Shkencave në "Informatikë"
- Mater i Shkencave në "Teknologji Informacioni"
- Master i Shkencave në "Inxhinieri Matematike dhe Informatike"
- Master i Shkencave në "Inxhinieria e Proceseve Kimike"
- Master i Shkencave në "Kimi Industriale dhe Mjedisore"
- Master i Shkencave në "Kimi"

- Master i Shkencave në "Kimi", me profil "Mësues Kimie për arsimin e mesëm dhe të lartë"
- Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"
- Master i Shkencave në "Informatikë", me profil "Mësues Informatike për arsimin e mesëm dhe të lartë"
- Master Profesional në "Bioteknologji Mjedisore"
- Master Profesional në "Informatikë Biznesi"
- Master Profesional në "Teknologji Informacioni"
- Master Profesional në "Inxhinieri Matematike dhe Informatike"

Në grafikët e mëposhtëm janë paraqitur për secilin program studimi, ‘*Të regjistruarit*,’ dhe ‘*Të regjistruar jashtë UT*’. Vihet re që rreth 95% e studentëve të regjistruar janë nga FSHN dhe vetëm 5% janë nga universitetë të tjera (kryesisht UAMD). Kjo shpërndarje nuk reflekton aspak atë që është parashikuar në Kartën e Bolonjës, e cila parashikonte mobilitete nga cikli i parë në ciklin e dytë. Një arsye tjetër e cila pengon këtë mobilitet është se në FSHN janë pesë programe studimi mësuesie dhe “Mësuesia” tashmë futet në profesionet e rregulluara dhe nëse diploma bachelor nuk është e të njëjtit profil me atë të masterit, diplomantët nuk mund të futen në provimin e shtetit.




Figura 4.1.5. 2: Të regjistruar në Ciklin e Dytë në vitin 2017-2022



Statistikat rreth mesatareve të pranimeve në programet e studimit që të çojnë në mësuesi

Në tabelën e mëposhtme gjenden mesataret për dy target grupe:


- Mesataret e studentëve që janë pranuar në programet Bachelor në vitin 2017-2018 dhe po ky grup me çfarë mesatare është pranuar në master në vitin 2020-2019.
- Mesataret e studentëve që janë pranuar në programet Bachelor në vitin 2018-2019 dhe po ky grup me çfarë mesatare është pranuar në master në vitin 2021-2022.

MESATARET E PRANIMIT NE CIKLIN E PARE DHE TE DYTE NE DEGET E MESUESISE				
	Bachelor_2017-2018	MSC AML_2020-2021	Bachelor_2018-2019	MSC AML_2021-2022
Biologji	8.518	5.97	8.578	6.467
Fizikë	7.729	5.91	7.89	5.611
Kimi	7.965	6.23	8.036	5.87
Matematikë	8.714	6.16	8.436	6.417
Infomatikë	9.819	6	8.981	6.406


Në grafikët e mëposhtëm është vizualizuar statistika e mësipërme për secilin target grup.



Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur regjistrimet në programet e cilit të dytë Master i Shkencave, të cilët nuk kanë drejtim “mësuesisë” dhe vihet re që vit mbas viti ka dinamika të ndryshme, të cilat reflektojnë se nevojitet një studimi më i detajuar për të kuptuar këto luhatje kaq të mëdha.



Fakulteti i Shkencave të Natyrës ofron edhe katër programe studimi në Master Profesional dhe në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur grafikisht regjistrimet në këto programe studimi. Vihet re një trend zbritës dhe kjo për arsye se tregu i punës nuk është i orientuar drejt drejtimi, pasi njoftimet e punësimit kërkojnë kryesisht studentë të diplomuar në Master i Shkencave.



Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të përmblledhura të dhënat në lidhje me shpërndarjen e regjistrimeve në dy vitet e fundit akademike. Ajo që vlen të nënvizohet është numri i lartë i të regjistruarve si degë e dytë, dhe kryesisht këto janë në programet e studimit “Arsim i Mesëm i Lartë (AML)” në Matematikë, Kimi, Bilogji, Fizikë dhe Informatikë. Ky numër i madh regjistrimesh si degë e dytë vjen nga fakti se studentët që diplomohen në programet e studimit Master i Shkencave Matematikë, Kimi, Bilogji, Fizikë dhe Informatikë nuk mund të punësohen si mësues.

Tabela 4.1.5. 1: Të regjistruar sipas Fakulteteve

Viti akademik	Të regjistruar	Degë e dytë	Troje	Aplikime(total)	Aplikime(Jashtë UT)
2019-2020	870	19	0	1720	90
2020-2021	576	15	6	1828	89

4.1.6 Fakulteti i Shkencave Sociale

Cikli i Parë

Fakulteti i Shkencave Sociale ofron gjashtë programe studimi në ciklin e parë, Bachelor. Referuar të dhënave për raportin aplikime pranime në Fakultetin e Shkencave Sociale për nivelin Bachelor, vazhdon të evidentohet niveli i lartë i aplikimeve dhe preferencave për të gjitha degët. Evidentohen degët më të preferuara vazhdojnë të jenë Puna Sociale, Psikologjia dhe Shkencat Politike me mbi 5000 aplikantë, kështu që për 100 kuota të ofruara respektivisht në këto degë, ka një raport 50 aplikantë për një kuotë. Pas tyre vjen “Administrim dhe Politika Sociale”, dega e dytë e departamentit të Punës dhe Politikës Sociale që ka rreth 4000 aplikantë, e ndjekur nga Sociologjia me rreth 3000 aplikantë dhe Filozofia me rreth 1000 aplikantë.




Figura 4.1.6. 1. Aplikime Bachelor Fakulteti i Shkencave Sociale, në 4 vitet e fundit

Nga figurat e mësipërme del qartë se vetëm dy degë kanë rritje në totalin e aplikimeve, dega e Psikologjisë dhe e Sociologjisë, ndërsa dega e Filozofisë ka një ulje relativisht më të lartë krahasuar me degët e tjera të studimeve në shkencat sociale. Duhet venë në dukje se Filozofia në klasifikimin ISCED 2011 nuk i takon kategorisë së shkencave sociale, por fushës së Arteve dhe Humaniteteve, prandaj ndoshta duhet të krahasohet me grupin e degëve të shkencave humanitare.




Figura 4.1.6. 2. Regjistrime Bachelor Fakulteti i Shkencave Sociale në katër vitet e fundit

Psikologjia vazhdon me ritme të ndjeshme rritjeje e ndjekur nga Puna Sociale, ndërkohë që Filozofia vazhdon me tendencë rënieje të numrit të regjistrimeve.

Nota e lartë mesatare e aplikantëve pasqyrohet në notën mesatare të arritur për të gjithë të regjistruarit në shkencat sociale që është mbi 8 në katër vitet e fundit akademike, me përjashtim të programi Bachelor Filozofi.




Figura 4.1.6. 3. Nota Mesatare e të Regjistruarve në Bachelor

Pra, në Fakultetin e Shkencave Sociale duket se të gjitha degët vazhdojnë të jenë të kërkuara nga studentë me mesatare mbi 8. Nga numri i të regjistruarve rezulton se dega më e preferuar në vitin akademik 2021-2022 është Shkenca Politike, me notën mesatare 8.5, e ndjekur nga Administrim në Politikë Sociale, me mesatare 8.44 dhe Puna Sociale me mesatare 8.4. Sa i takon notës mesatare, studentët e Psikologjisë rezultojnë me mesatare 8.2 e pasuar nga Sociologjia me mesatare 8. Sa i takon shpërndarjes gjeografike të studentëve të regjistruar, ata nga Tirana zenë 20 përqind të gjithë studentëve të regjistruar në të dy vitet e fundit akademike, të pasuar nga studentët nga Fieri, Kukësi, ndërsa bashkitë e tjera kanë oshilacione nga viti në vit. Bashki si Kamza dhe Laçi nuk kanë studentë në të dy vitet, ndërsa Devolli, Kolonja, Përmeti e Peqini kanë shumë pak studentë. Fakti që shumica e studentëve të diplomuar qëndrojnë në Tiranë sipas anketimit, tregon për nxitjen e studentëve nga Tirana të aplikojnë në shkencat sociale.

Cikli i Dytë

Referuar të dhënave për aplikimet dhe pranimet në Fakultetin e Shkencave Sociale për nivelin Master, në katër vitet e fundit akademike, situata paraqitet disi ndryshe nga Bachelori, pasi raporti

aplikime pranime është mesatarisht 2:1. Interesante është një lidhje e ngushtë mes dy niveleve të studimit brenda Fakultetit të Shkencave Sociale, ku studentët e diplomuar në Bachelor në vitin akademik vazhdojnë me studimet Master. Në nivelin Master, pothuajse në të gjitha programet, gati 60% e të regjistruarve vijnë nga brenda Fakultetit, me përjashtime të rralla si programet e psikologjisë, ku ka 8 studentë që vijnë nga trojet në Masterat Shkencorë “Psikologji Klinike” dhe 1 në “Psikologji Organizacionale”, sikurse edhe 2 në Masterat Profesionalë. Këto programe kanë tërhequr studentët me mesatare të lartë, mbi 8. Studentët nga universitetet publike, veçanërisht nga ato jashtë Tiranës, zenë vendin e dytë veçanërisht tek Masterat Profesionalë, me rreth 10% të të gjithë studentëve të regjistruar, ndërsa numri i të regjistruarve nga universitetet private është i papërfillshëm, vetëm 6%.

Tabela 4.6.2 Informacion në lidhje me aplikimet dhe pranimet në ciklin e dytë për vitin 2018-2019

Fushat e Studimit	Aplikant e	Regjist ruar	Mesatar ja e studente ve te pranuar	Regjistr uar nga universit ete publike jo në Tiranë	Regjist ruar nga univers itete jopubli ke	Regji strua r nga unive rsitet e te Huaja	Regj istru ar nga FSH S	Regji strua r nga UT, fakult ete te tjera
Master Shkencor								
Psikologji klinike	74	39	9.2	1	6	3	29	0
Psikologji shkollore	52	29	8.1	2	6	0	21	0
Psikologji organizacionale	23	10	7.5	1	2	0	7	0
Mësues i shkencave sociale për arsimin e mesëm të lartë	55	36	7.6	6	3	0	27	0
Punë sociale me tre drejtime	69	34	7.2	14	4	0	15	1
Përkatësi gjinore dhe zhvillim	Mbyllur							
Administrim i shërbimeve sociale	147	48	7.94	0	1	0	47	0

Sherbimet sociale ne drejtesinë penale	108	28	7.38	1	0	0	26	0
Çështje te fëmijëve dhe të familjes	85	17	6.8	3	0	0	14	0
Komunikim për ndryshim social e të sjelljes	57	23	6.67	0	6	0	15	3
Teori politike	Ky master nuk eshte hapur.							
Qeverisej dhe Integrim	Ky master nuk eshte hapur.							
Studime rajonale politike	37	35	7.5	0	3	0	32	0
Filozofi sociale	15	10	6.1	0	2	0	8	0
Etika në institucione dhe lidrshp	45	33	6	0	1	0	30	2
Sociologji e zhvillime shoqërore	27	17	7.9	1	0	0	16	0
Politika dhe drejtim arsimin	15	11	8.5	8	1	0	1	1




Figura 4.1.6. 4. Aplikime-Regjistrime 2018-2019, Programet Master, Fakulteti i Shkencave Sociale

Nga numri i aplikimeve dhe regjistrimeve për vitin akademik 2018-2019 vihet re se Masterat profesionale janë po aq të kërkuar sa edhe masterat shkencore. Është evidente dominimi i numrit të aplikimeve dhe regjistrimeve në masterat si shkencore dhe profesionale të ofruara nga departamenti i Punës dhe Politikës Sociale, ndonëse vendin e parë në regjistrime e ze Masteri Profesional “Administrimi i institucioneve sociale në sistemin e drejtësisë”, një Diplomë e Integruar e Departamentit të Sociologjisë në bashkëpunim me Departamentin e së Drejtës Penale në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Duhet theksuar se në këtë rast janë bërë lëshime në notën mesatare e cila është nën 7, më e ulëta nga të gjitha programet e tjera Bachelor dhe Master.

Tabela 4.1.6.3. Numri aplikime-regjistrime dhe nota mesatare Master profesional, 2018-2019

Master Profesional								
Fushat e Studimit	Aplikant e	Regjist ruar	Mesatar ja e studente ve te pranuar	Regjistr uar nga universit ete publike jo në Tiranë	Regjistr uar nga universit ete jopublik e	Regjist ruar nga univers itete te Huaja	Regjist ruar nga FSHS	Regjistr uar nga UT, fakultete te tjera
Analizë e politikës sociale	53	22	6.6	14	4	0	4	0
Punë sociale e avancuar	125	69	6.72	17	1	0	48	3
Pedagogji e specializuar sociale	55	49	6.8	28	2	2	8	9
Psikologji Ligjore	46	42	8.9	6	9	0	27	0
Orientim profesional	26	23	7.8	7	5	0	9	2
Këshillim psikologjik	53	39	7.3	7	14	6	12	0
Qeverisje dhe politika publike	48	27	7.2	2	3	0	18	4

Administrimi i institucioneve sociale në sistemin e drejtësisë	105	62	7.2	19	4	0	32	7
Filozofi praktike dhe humane	20	13	6.2	0	0	0	13	0
Zgjidhje e Konfliktëve me ndërmjetësim	13	10	6.4	6	1	1	0	2

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur aplikime-pranimet në vitin akademik 2018-2019 për programet e studimit Master Profesional.




Figura 4.1.6. 5. Aplikime-Regjistrime 2018-2019, Programet Master Profesional Fakulteti i Shkencave Sociale

Programet e Masterave kanë pësuar një tkurrje vitet e fundit akademike, duke u reduktuar nga 15 në 13 programe studimi. Konkretisht nuk ka aplikime për Masterin Shkencor “Teoritë Politike” dhe “Politika dhe Drejtim Arsimit”. Masterat profesionale po ashtu janë reduktuar nga vitit 2016-2017 në atë 2017-2018, nga 8 në 7 programe studimi. Konkretisht nuk ka aplikime për masterin “Filozofi praktike dhe humane”. Nga të dhënat për vitin akademik 2017-2018 vihet re një rënie e regjistrimeve në raport me aplikimet, si dhe në vlerë absolute krahasuar me vitin e mëparshëm, si për Masterat Shkencore edhe për Masterat profesionale. Çfarë ka rëndësi të theksohet është rritja e numrit të

aplikimeve dhe regjistrimeve në Masterat Shkencore, ku numrin më të lartë të aplikimeve vazhdon ta ketë Masteri Shkencor “Administrimi i Shërbimeve Sociale”, ndonëse ka më pak se 30% të regjistruar, nga të cilët 90% janë nga Fakulteti i Shkencave Sociale. Vendin e dytë të aplikimeve e ze Masteri Shkencor “Psikologji shkollore”, por regjistrimet nuk zenë as 20% të aplikimeve, ku studentët e regjistruar janë kryesisht të diplomuar nga Fakulteti i Shkencave Sociale. Mbetet evidente dominimi i numrit të aplikimeve dhe regjistrimeve në masterat si shkencore dhe profesionale të ofruara nga departamenti i Punës dhe Politikës Sociale, ndonëse vendin e parë në regjistrime e ze Masteri Profesional “Administrimi i institucioneve sociale në sistemin e drejtësisë”, ku nota mesatare vazhdon të jetë nën 7, me 13 studentë më pak në vitin akademik 2017-2018. Masteri tjetër shkencor i Sociologjisë ka një rritje të ndjeshme në vitin akademik 2017-2018, sikurse edhe Masteri i Shkencor i Shkencave Politike “Studime Rajonale” tek i cili mesa duket janë përfshirë të gjithë studentët e diplomuar në Bachelorin e shkencave politike, përderisa Masteri i dytë shkencor “Teorit e Politike” nuk u hap. Po e njëjta logjikë vlen edhe për Masterin shkencor “Etika në institucione dhe lidhësi” të Filozofisë.

Master Shkencor								
Fushat e Studimit	Aplikante	Regjistruar	Mesatarja e studenteve të pranuar	Regjistruar nga universitetet e publike jo në Tiranë	Regjistruar nga universitetet jopublike	Regjistruar nga universitetet e Huaja	Regjistruar nga FSHS	Regjistruar nga UT, fakultete të tjera
Psikologji klinike	69	36	9	0	1	5	30	0
Psikologji shkollore	49	25	8	7	0	0	18	0
Psikologji organizacionale	24	17	7.4	2	2	0	13	0
Mësues i shkencave sociale për arsimin e mesëm të lartë	55	48	7.5	8	0	1	39	0
Punë sociale me tre drejtime	38	20	7.5	8	0	0	12	0

Përkatësi gjinore dhe zhvillim	Mbyllur							
Administrim i shërbimeve sociale	114	43	7.75	2	0	0	39	2
Shërbimet sociale në drejtesinë penale	67	28	7.48	1	1	0	26	0
Çështje të fëmijëve dhe të familjes	54	18	7.82	2	0	0	16	0
Komunikim për ndryshim social e të sjelljes	29	13	7.59	1	0	0	12	0
Teori politike	Ky master nuk është hapur.							
Qeverisje dhe Integrim	Ky master nuk është hapur.							
Studime rajonale politike	39	31	7.1	3	6	0	18	4
Filozofi sociale	19	14	8	3	1	0	9	1
Etika në institucione dhe lidhësi	46	31	7.09	4	2	0	22	3
Sociologji e zhvillime shoqërore	15	10	7.5	4	0	0	6	0
Politika dhe drejtim arsimin	15	10	8.7	7	0	0	0	3




Figura 4.1.6. 6: Statistika për pranimet në Master i Shkencave në 4 vitet e fundit akademike




Figura 4.1.6. 2: Statistika për aplikimet në Master Profesional në 4 vitet e fundit akademike




Figura 4.1.6. 7: Statistika për regjistrimet në Master I Shkencave në 4 vitet e fundit akademike





Figura 4.1.6. 8: Statistika për regjistrimet në Master Profesional në 4 vitet e fundit akademike

Në grafikun e mëposhtëm gjeni mesataret e pranimit në programet e ciklit të dytë Master i Shkencave në Fakultetin e Shkencave Sociale.



5. Analiza e bazuar tek pyetsori me të diplomuarit në vitet e fundit. Gjetjet kryesore sipas fakulteteve të Universitetit të Tiranës

5.1 Fakulteti i Drejtësisë

Historiku

Fakulteti i Drejtësisë është themeluar në vitin 1954, me emrin “Instituti i Lartë Juridik”. Pas krijimit të Universitetit Shtetëror të Tiranës, Instituti i Lartë Juridik u përfshi në këtë Universitet, si një nga të shtatë fakultetet, me emrin “Fakulteti i Drejtësisë”.

Në vitin 1965, u riorganizua dhe u quajt “Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike”, ku u përfshinë dega e shkencave politike dhe ajo e drejtësisë. Këto degë përgatitnin, përkatësisht, specialistë të profilit politik për organet qendrore e lokale të pushtetit dhe juristë për organet e drejtësisë dhe të administratës shtetërore.

Në vitin 1967, pranë këtij Fakulteti u çel edhe dega e gazetarisë, e cila përgatiste gazetarë për organet e shtypit dhe të Radio-Televizionit Shqiptar.

Në vitin 1991, dega e drejtësisë u nda nga ajo e filozofisë, e cila kishte zëvendësuar degën e shkencave politike. U krijuan kështu dy fakultete të veçanta, ndërsa dega e gazetarisë u transferua në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë.

Aktualisht Fakulteti quhet “Fakulteti i Drejtësisë”.

Deri në vitet ’70, kohëzgjatja e studimeve ishte katërvjeçare, ndërsa, më pas, ajo u reduktua në tre vjet studime, të ndjekura nga një vit praktikë mësimore pranë organeve të drejtësisë.

Në vitet ’80, në këtë Fakultet u rikthye afati i studimeve katërvjeçare.

Pas viteve ’90, Fakulteti i Drejtësisë pësoi ndryshime të shumta.

Përfshirja e nocioneve dhe e praktikave të reja të shtetit të së drejtës diktonte detyrimisht edhe reformimin e Fakultetit në aspektet akademike, shkencore, edukative dhe të kapaciteteve fizike.

Duke filluar nga viti 1991, planet dhe programet mësimore u ndryshuan dhe u hartuan sipas modeleve perëndimore, gjithashtu Fakulteti është riorganizuar dhe ristrukturuar në formë dhe përmbajtje sipas kërkesave të kohës,

Aktualisht, Fakulteti operon në bazë të programeve të reja mësimore, në përputhje me programet e shkollave perëndimore, bazuar në deklaratën e Bolonjës dhe të përshtatura ndaj kushteve konkrete të vendit tone, duke ofruar programe studimi në të tre ciklet: Bachelor, Master dhe Doktoraturë.

Fakulteti ka bashkëpunimi me një sërë institucionesh për kryerjen e praktikave mësimore të studentëve apo për punësimin e tyre.

Gjithashtu ofron facilitetet e duhura për përgatitjen e formimin e studentëve.

Organizimi

Departamentet

- Departamenti i të Drejtës Civile
- Departamenti i të Drejtës Penale
- Departamenti i të Drejtës Publike

Fakulteti është organizuar në një strukturë hierarkike, e ndarë në tre nivele kryesore: Dekani, zv. Dekanët dhe Drejtuesit e Departamenteve.

Fakulteti ofron programet Bachelor, Master shkencor dhe profesional si dhe Doktoraturë.

Master Shkencor

- Në fushën Civile
- Në fushën Penale
- Në fushën Publike

Master Profesional

- Në fushën Civile
- Në fushën Penale
- Në fushën Publike
- EU Business Law

Programet që ofron FD në Doktoraturë:

- Në fushën Civile
- Në fushën Penale
- Në fushën Publike

5.1.1. Shpërndarja e studentëve

Përqindjen më të lartë të të intervistuarve e përbëjnë studentët me origjinë nga Tirana dhe Fieri. Qarqet e tjera kanë një përqindje më të ulët të të intervistuarve. Gjithsesi mbas përfundimit të studimeve një përqindje e konsiderueshme vazhdojnë qëndrimin në Tiranë, ndërsa një përqindje domethënëse kthehet në qarkun origjinës.




Figura 5.1.1.1. Qarku lindjes

Tabela 5.1.1.1. Qarku ku jetojnë

Nga të dhënat e studentëve të intervistuar, ata që kanë përfunduar studimet 4 vitet e fundit, rreth 77.5 % e studentëve që kanë përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, qëndrojnë në Tiranë. Kjo për faktin e mundësive që krijon Tirana për punësim.

Rreth 4.9 % e studentëve janë larguar jashtë vendit. Një pjesë e tyre janë kthyer në qarkun nga kanë ardhur , për shëmbull në Elbasan (5.9%) apo në Fier (4.9 %). Ndërkohë 4.9 % kanë ikur jashtë vendit. Qarqet e tjera zënë një përqindje më të ulët.

Tabela 5.1.1.2. Shpërndarja gjeografike e studentëve sipas qarkut origjinë

Qarku ku jetojnë	Përqindja
Berat	0
Dibër	1.3
Durrës	5.1
Elbasan	3.8
Fier	2.5
Gjirokastrë	0
Korçë	2.5
Kukës	0
Lezhë	3.8
Shkodër	0
Tiranë	77.2
Vlorë	0

Jashte Vendit	1.3
NA	2.5

Qarku Origjinë	% e të qëndruarve në Tiranë (ndaj popullsisë së rrethit)	Të larguarit jasht vendit	Të qëndruarit në Tiranë sipas qarqeve
Berat	80.00%	0.0%	5.1%
Dibër	100.00%	0.0%	5.1%
Durrës	50.00%	0.0%	1.3%
Elbasan	14.29%	0.0%	1.3%
Fier	61.54%	0.0%	10.1%
Gjirokastrë	90.91%	20.0%	12.7%
Korcë	80.00%	0.0%	5.1%
Kukës	90.00%	0.0%	11.4%
Lezhë	33.33%	0.0%	1.3%
Shkodër	80.00%	0.0%	5.1%
Tiranë	89.66%	60.0%	32.9%
Vlorë	100.00%	0.0%	6.3%
Jasht vendit	66.67%	20.0%	2.5%

Studentët e Fakultetit të Drejtësisë gjejnë mundësi punësimi më shumë duke qëndruar në Tiranë. Studentët nga qarku i Gjirokastrës, Kukësit e Fierit zenë përqindjen më të lartë të qëndrimit në Tiranë, ndërsa ata të qarkut të Lezhës, Durrësit e Elbasanit përqindjen më të ulët.

Tabela 5.1.1.3. Studentët sipas fushës së studimit

Programi studimit	% e studentëve të intervistuar	Numri studentëve të diplomuar
CIKLI I DYTE I STUDIMEVE		
Civil, Penal, Publik	100	
Gjithsej	100.0	

Të gjithë studentët e intervistuar kanë përfunduar Ciklin e Dytë të studimeve, Master.

5.1.2. Punësimi studentëve

Aftësitë që përfitojnë studentët në Fakultetin e Drejtësisë ju jep mundësinë që një një pjesë e tyre të fillojnë studimet që gjatë periudhës që janë akoma studentë (26%), një përqindje e konsiderueshme (30%) kanë filluar punë gjatë studimeve dhe vazhdojnë edhe pas.




Figura 5.1.2.1. Koha e punësimit të studentëve

Rreth 25% janë punësuar mbas studimeve dhe rreth 81% kanë pasur një punë .

Tabela 5.1.2.1 Punësimi

	A keni punuar ndonjëherë?	A jeni i punësuar aktualisht?
Jo	13.9	35.5
Po	83.5	63.3
NA	2.5	1.3
Total	99.9	100.1

Rezulton se 22,5 % e studentëve nuk kanë punuar ndonjëherë ndërsa 77.5 % kanë punuar. Ndërkohë në lidhje me gjendjen aktuale 20.6 % nuk janë të punësuar, ndërsa 59.8 % janë të punësuar.

Tabela 5.1.2.2. Punësimi sipas viteve

VITI I DIPLOMIT	A KENI PUNUAR NDONJEHERE?				A JENI NE PUNE AKTUALISHT?			
	NA	Jo	Po	Total	NA	Jo	Po	Total
2018	0.00 %	4.76%	95.24%	100.00%	0.00 %	14.29 %	85.71 %	100.00 %
2019	6.67 %	13.33%	80.00%	100.00%	0.00 %	13.33 %	86.67 %	100.00 %
2020	0.00 %	18.18%	81.82%	100.00%	0.00 %	59.09 %	40.91 %	100.00 %
2021	4.76 %	19.05%	76.19%	100.00%	4.76 %	47.62 %	47.62 %	100.00 %

Përqindja e të punësuarve është më e lartë ndër ata që e kanë përfunduar shkollën në vitet e mëparshme dhe bie disi ndër vite. Kjo tregon që aktualisht studentët janë përshtatur mirë në tregun e punës. Tendencat e tregut tregojnë që ata që përfundojnë Fakultetin e Drejtësisë kanë treg pune dhe fitojnë aftësi të tilla të përshtatshme ndaj kërkesave të tregut, duke marrë parasysh edhe fushën e punësimit të tyre.

Janë një sërë arsyesh që i shtojnë studentët të gjejnë një punë. Gjithsesi ka dhe një sërë arsyesh që studentët mos përfshihen në tregun e punës lidhur kjo me gjetjen e një pune të përshtatshme, gjetjen e orarit të përshtatshëm

Tabela 5.1.2.3. Arsyet e mos përfshirjes në tregun e punës

Fokusuar tek studimet e mëtejshme.

Nuk jam përzgjedhur fituese në asnjë vend pune për shkak të moseksperiencës

Nuk jam pranuar me arsyen se nuk kam patur eksperience.

Nuk ka vend pune.

Nuk kam gjetur asnjë pune që i përafrohet profilit për të cilën kanë studiuar .

Nuk kam gjetur mundësi punësimi në asnjë institucion ku kanë kërkuar punë.

Nuk kam gjetur një punë me orar të përshtatshëm për statusin tim të studentit.

Nuk kam mundur të gjej raportin e duhur të vlerës së diplomës sime, me rëndësinë që i jepej nga cdo institucion/shoqëri.

Nuk kam pasur mundësi

Ishte i punësuar gjatë ndjekjes së studimeve dhe është i punësuar tek e njëjta punë .

5.1.3. Sektori i punësimit

Në studimin e vitit 2014-2018 në sektorin shtetëror rezultonte se punësohej pjesa dërmuese e studentëve që përfundojnë studimet në Fakultetin e Drejtësisë dhe kjo përqindje ishte më e lartë krahasuar me sektorët e tjerë, 40%. Ndërsa në studimin e radhës që i takon viteve 2018-2022 vihet re një tjetër situatë, ku 44% janë të punësuar në sektorin privat dhe 35% në sektorin shtetëror.



Figura 5.1.3.1 Sektori punësimit

Gjithashtu vihet re që të punësuarit në sektorin shtetëror janë më të pakët në vitet e fundit, duke lënë të kuptohet që ka një tendencë në rritje drejt sektorit privat, 44% si dhe një rritje e të vetëpunësuarve me 8%.




Figura 5.1.3.2. Të punësuar sipas sektorëve dhe vitit të diplomimit

Të punësuarit janë përgjithësisht me kohë të plotë 75% dhe vetëm 13% janë të punësuar me kohë të pjesshme. Ajo që vihet re nga të dhënat është që gjatë vitit të parë studentët arrijnë të futen në tregun e punës por me kalimin e viteve fitojnë qëndrueshmëri në tregun e punës, kjo duke analizuar statusin e punësimit dhe përqindjen e të punësuarve në vite.

Një fenomen që vihet re nga të intervistuarit është fakti që pavarësisht prirjeve për tu përgjigjur nëse e kanë patur të vështirë gjetjen e punës apo jo, pjesa më e madhe e tyre mendojnë se studimet kanë ndihmuar në gjetjen e punës është pothuajse konstante, pavarësisht faktit të vështirësisë së gjetjes së punës.




Figura 5.1.3.3. Statusi punësimit për studentët e diplomuar në FD.

Në tabelën e mëposhtme kemi paraqitur pozicionet e punës ku janë punësuar të diplomuarit Fakultetit të Drejtësisë. Përqindjen më të lartë e zë pozicioni si 'jurist' 34,8 %, specialist 9%, pjesa tjetër në angazhime të tjera.

Tabela 5.1.3.1. Profesionit në punë të angazhuara më parë.

	Fakulteti I Drejtësisë	Përqindja
Jurist	27	34.18
Specialist	7	8.86
Asistent	7	8.86
Arketar	0	0
Avokat	7	8.86
Tjeter	14	17.72
NA	17	21.52

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur në paln krahasues sektori i punësimit në atë aktual dhe në punësimin e mëparshëm.




Figura 5.1.3.4. Sektori punësimit në punë të mëparshme

Punësimi i mëparshëm ka qenë në kuadër të vëtpunësimi, ndërsa ai aktuali në sektorin shtetëror dhe atë privat.




Figura 5.1.3.5. Koha e punësimit

Vihet re tendenca drejt punësimit më kohë të plotë, si aktualisht ashtu edhe ai i mëparshmi.

5.1.4. Përshtatja e aftësive me kërkesat e tregut

Të diplomuarit në Fakultetin e Drejtësisë kryesisht punësohen si juristë. Kjo tregon që studentët përfshihen në tregun e punës por gjithashtu angazhohen në fushën për të cilën janë diplomuar.

Punësimi sipas profesioneve

Duke marrë në konsideratë diplomat që përfundojnë të diplomuarit në Fakultetin e Drejtësisë, vëmë re që përgjithësisht edhe profesionet e gjetura përshtaten me diplomat e tyre. Ata punësohen në sektorin shtetëror si juristë(në pozicione të ndyshmë pune) apo në sektorin privat, ushtrojnë profesionet e lira (avokat, noter, përmbaues, ndërmjetës si të vetpunësuar), në sistemin Gjyqësor dhe atë të Prokurorisë.

Duke marrë një shkallë nga 1 në 10, vlerësuar sipas vlerësimit me nota, ku 1- nuk u ka ndihmuar dhe 10- ju ka ndihmuar shumë, studentët janë shprehur që diploma ju ka vlejtur për gjetjen e një pune. Kjo vihet re nga një vlerësim në vite rreth shkallës 8-10. Ky nivel ka qenë më i lartë në vitin 2021 . Duke marrë parasysh të njëjtin klasifikim në nivelin nga 1 në 10 mbi formimin e marrë në

universitetet në performancën e punës, studentët gjithashtu shprehen me një nivel mesatar mbi 8 . Ky nivel qëndron mbi nivelin e gjetjes së punës për studentët e diplomuar në të gjitha vitet, ndërkohë për vitet e mëparshme qëndron nën mundësinë për gjetjen e punës por diferenca është e vogël.




Figura 5.1.4.1. Diploma për gjetjen e një pune dhe performancës

Mendohet që nota mesatare, dega apo njohjet influencojnë në gjetjen e një pune dhe ecurinë dhe përshtatjen e mëtejshme në tregun e punës.

A mendoni se ju ka ndihmuar formimi juaj në studimet universitare *në gjetjen e një pune*? Vlerëso me notë nga 1 - 10 *

A mendoni se ju ka ndihmuar formimi juaj në universitet *në performancën e punës*? Vlerëso me notë nga 1 - 10 *

Përveçse shkallës mesatare, po të shohim klasifikimin në nivele, vihet re një rritje e përqindjeve drejt niveleve të larta të vlerësimit për faktin se si formimi dhe njohuritë universitare ndikojnë në performancën e punës.




Figura 5.1.4.2.: Ndikimi i formimit në universitet në performancën në punë

Në lidhje me këtë fakt, rreth 80% e të intervistuarve i janë përgjigjur në nivele të larta se formimi përgjatë fakultetit ka ndikuar në performancën në punë.

5.1.5. Promotorët për tregun e punës

Mënyrat dhe format e gjetjes së një pune janë të ndryshme. Ndodh që ashtu sikurse janë shprehur një sërë studentësh, aplikimet në internet, kërkimet që kanë bërë individualisht në internet janë bërë shkak për gjetjen e një pune. Gjithsesi janë edhe burime të tjera që zënë ndoshta një peshë më të madhe për momentin për përfshirjen në tregun e punës.

Shokët, miqtë apo të njohurit zënë peshën kryesore në gjetjen e një pune (27%). Disa shprehen që kanë qenë familjarët (20%), dhe më pak zyrat e karrierës 1%, pushtetarët 1%, forma të tjera (21%). Për një pamje më të plotë referohuni grafikut të mëposhtëm.




Figura 5.1.5.1. Influencuesit në gjetjen e punës

Disa nga studentët fillojnë edhe integrohen në tregun e punës mbas përfundimit të Bachelorit por ndodh që studenti kalon një periudhë tranzicioni në përshtatjen e aftësive të tij dhe kërkesave të tregut të punës. Duke analizuar pyetjen subjektive mbi vështirësinë apo lehtësimin e këtij kalimi duhen marrë parasysh një sërë reformash.

Pyetjes subjektive mbi “Çfarë mendoni se duhet të ndryshojë në Universitetin e Tiranës për të lehtësuar tranzicionin nga shkolla në punë?” I janë përgjigjur 82.5% përqind e studentëve.

Ndër komentet e tyre vihen re sugjerimi për të ndryshuar kurrikulat, për ta bërë më praktike. Gjithashtu ata shprehen që do ishte me vlerë afrimi me firmat private për t’u krijuar më shumë mundësira për punësim.

Një ndër problemet e studentëve në përshtatjen me tregun e punës është edhe aplikimi praktik i teorisë, njohurive dhe vlerave të fituara në universitet. Gjithsesi përveçse përfshirjes së praktikës mësimore janë një sërë hapash që vetë studentët sugjerojnë që fakulteti duhet të ndërmarrë. Rreth 40% e studentëve kanë dhënë sugjerimet rreth përmirësimeve të mundshme që duhet të bëjë universiteti dhe specifikisht fakulteti. Nisur nga kjo, një përqindje e konsiderueshme e studentëve shprehen se do ishte më me vlerë trajtimi më praktik i temave teorike, angazhimi në një kohë më të zgjatur të praktikës dhe aplikimi në fakultet më shumë njohuri të softwareve statistikore.

5.1.6. Zhvillimi aftësive në përshtatje me specializimin në tregun e punës

Sikurse vihet re edhe më lart studentët që kanë përfunduar studimet në vitin 2014 janë disi më të stabilizuar në tregun e punës duke punuar me kohë të plotë dhe duke pasur një përqindje më të lartë të punësimit të tyre.

Përveçse aftësive të fituara në shkollë, një pjesë e aftësive perfeksionohen nëpërmjet praktikave paraprake apo dhe trajnime të ndryshme që kryhen në tregun e punës.

*A keni kryer praktikë profesionale në programin e studimit që keni ndjekur? Vlerëso me një notë nga 1 - 10**

*Gjatë periudhës së punësimit, a keni kryer trajnime në funksion të pozicionit të punës që keni patur?**




Figura 5.1.6.1. Kryerja e trajnimeve në funksion të pozicionit të punës

Nga të intervistuarit rezulton se 53% kanë kryer trajnime në vendin e punës, ndërsa 42% jo.



Figura 5.1.6.2 Kryerja e praktikës mësimore

Rreth 44% e studentëve nuk kanë kryer praktikë mësimore. Gjithsesi një përqindje e konsiderueshme (rreth 25%) e kanë kryer praktikën dhe e shohin si shumë të vlefshme.

Kryerja e praktikës mësimore është një proces që i njeh studentët me tregun e punës dhe i përgatit ata mbi mundësitë dhe aftësitë e punësimit.

5.2. Fakulteti i Ekonomisë

Historiku

Fakulteti i Ekonomisë është formuar në vitin 1952, me emrin Instituti i Lartë i Ekonomisë. Që prej vitit 1957, me krijimin e Universitetit të Tiranës, ai u përfshi në atë Universitet me emrin Fakulteti i Ekonomisë. Në atë kohë Fakulteti i Ekonomisë ofronte diploma vetëm në dy degë: degën e Ekonomisë dhe degën e Kontabilitetit.

Gjatë viteve që pasuan Fakulteti i Ekonomisë u zgjerua dhe në vitin 1990 ai ofronte diploma në gjashtë degë: Ekonomist për Industrinë, Ekonomist për Financë, Ekonomi Politike, Ekonomist për Tregtinë, Ekonomist për Statistikë dhe Merceologji. Deri në vitin akademik 1990- 1991 programet mësimore të Fakultetit të Ekonomisë kanë qenë ndërtuar mbi bazën e parimeve të ekonomisë të centralizuar dhe kanë qenë të orientuar drejt përvojës së universiteteve lindore.

Gjatë periudhës 1991-2006, e cila përputhet me periudhën e transformimit drejt ekonomisë së tregut, Fakulteti i Ekonomisë është riorganizuar dhe ristrukturuar rrënjësisht në formë dhe përmbajtje. Ai është institucioni më i vjetër, i cili ofron diploma në fushën e ekonomisë, biznesit, marketingut, turizmit, etj.

Fakulteti synon që t'u japë studentëve një sistem bazë njohurish formuese në fushën e menaxhimit, marketingut, financë-kontabilitetit, në fushën e bazave të të dhënave, programimit, multimedias, etj, për formimin e specialistëve të aftë për të punuar në fushat përkatëse në subjekte të sektorit privat, të sektorit shtetëror, të sektorit jofitimprurës dhe për realizimin e studimeve të avancuara në këto fusha. Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon studime në fusha të tilla si ato të menaxhimit, të marketingut, të financës, të kontabilitetit, të informatikës dhe të statistikës, të mikro dhe makroekonomisë, të legjislacionit tregtar, statistikë, ekonometri, matematikë e zbatuar në ekonomi, mikroekonomi dhe makroekonomi, etj.

Aktualisht, Fakulteti operon në bazë të programeve të reja mësimore, në përputhje me programet e shkollave perëndimore, bazuar në Deklaratën e Bolonjës dhe të përshtatura ndaj kushteve konkrete të vendit tone, duke ofruar programe studimi në të tre ciklet: Bachelor, Master dhe Doktoraturë.

Fakulteti i Ekonomisë ka në përbërjen e tij 6 departamente: Departamenti i Financës, Departamenti i Kontabilitetit, Departamenti i Menaxhimit, Departamenti i Marketingut, Departamenti i Ekonomiksit dhe Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar⁵.

Fakulteti ka një partneritet me një sërë institucionesh për kryerjen e praktikave mësimore të studentëve apo për punësimin e tyre, si me Kontrollin e Lartë të Shtetit, Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Institutin e Statistikave, Agjensinë e Mbikqyrjes Financiare, Dhomat e Tregtisë, etj.

Në Fakultet funksionon Zyra e Karrierës e cila synon të mbështesë dhe të inkurajojë studentët dhe Alumnin në zhvillimin e potencialit të tyre për një përjasje më të mirë në tregun e punës duke rritur kështu numrin e të punësuarve në fushën e tyre të studimit. Ky mision vendoset në jetë së pari duke pasuruar eksperiencën studentore, në vijim me punë për t'i përgatitur studentët për kalimin në tregun e punës dhe më pas duke mundësuar ndërmjetësimin me këtë treg! Kjo zyrë organ Panairin e përvitshëm të Punës pranë Fakultetit të Ekonomisë

Fakulteti ka Bibliotekën e vet me një fond të konsiderueshëm librash dhe me një sallë të madhe studimi.

Organizimi

Departamentet

- Departamenti i Ekonomiksit
- Departamenti i Financës
- Departamenti i Kontabilitetit
- Departamenti i Marketingut
- Departamenti i Menaxhimit
- Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar

Fakulteti është organizuar në një strukturë hierarkike, e ndarë në tre nivele kryesore: Dekani, zv. Dekanët dhe Drejtuesit e Departamenteve.

⁵ Feut.edu.al

Fakulteti ofron programet Bachelor, Master shkencor dhe profesional⁶ si dhe Doktoraturë⁷.

Bachelor

- Administrim Biznesi
- Ekonomiks
- Financë kontabilitet
- Informatikë Ekonomike

Master Shkencor

- Administrim Publik
- Ekonomiks
- Financë
- Kërkime Operacionale në Menaxhim
- Kontabilitet dhe Auditim
- Marketing
- Siguria e Informacionit
- Sisteme Informacioni në Ekonomi

Master Profesional

- Administrim Biznesi
- Administrim Publik
- Financë
- Financë, Kontabilitet dhe Auditim
- Kontabilitet dhe Auditim (kohë e plotë)
- Kontabilitet dhe Auditim (kohë e pjesshme)
- Marketing
- Menaxhim
- Turizmi
- Sisteme Informacioni në Ekonomi
- Studime Ekonomike Evropiane
- Teknologji Informacioni dhe Menaxhimi i proceseve të Biznesit
- Menaxhim Shëndetësor

Programet që ofrohen në Doktoraturë:

⁶ Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".

⁷ Ligjit 80/2015 "Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH", i përfundojnë ato sipas kriterëve dhe modaliteteve të legjislacionit të kohës që janë pranuar.

- Doktoratë në Ekonomiks
- Doktoratë në Financë
- Doktoratë në Kontabilitet
- Doktoratë në Marketing
- Doktoratë në Menaxhim
- Doktoratë në Statistikë
- Doktoratë në Sisteme Informacioni në Ekonomi

5.2.1. Shpërndarja e studentëve

Përqindjen më të lartë të të intervistuarve e përbëjnë studentët me origjinë nga Fieri dhe Tirana. Qarqet e tjera kanë një përqindje më të ulët të të intervistuarve. Gjithsesi mbas përfundimit të studimeve një përqindje domethënëse kthehet në qarkun origjinë. Një përqindje e konsiderueshme vazhdojnë qëndrimin në Tiranë.




Figura 5.2.1.1. Qarku lindjes

Janë të njohura ndryshimet strukturore që ka pësuar Tirana. Popullsia ka ardhur në rritje dhe është pozicionuar si në minibashki ashtu edhe në zonat suburbane, në rrethinat e qytetit të Tiranës (Dumani, et al, 2018). Kjo rritje ka ardhur, në pjesën më të madhe, nga lëvizja migratore, ku një rol jo të vogël luan dhe pozicionimi i studentëve në Tiranë pas përfundimit të studimeve.

Tabela 5.2.1.1. Qarku ku jetojnë

Qarku ku jetojnë	Përqindja
Berat	0
Dibër	0
Durrës	1.6
Elbasan	0
Fier	3.1
Gjirokastër	0
Korçë	0
Kukës	1.6
Lezhë	1.6
Shkodër	0
Tiranë	79.7
Vlorë	0
Jashte Vendit	1.6
NA	10.9

Nga të dhënat e studentëve të intervistuar, ata që kanë përfunduar studimet 4 vitet e fundit, rreth 80% e studentëve që kanë përfunduar studimet në Fakultetin e Ekonomisë, qëndrojnë në Tiranë. Kjo për faktin e mundësive që krijon Tirana për punësim.

Rreth 5% e studentëve janë larguar jashtë vendit. Një pjesë e tyre janë kthyer në qarkun nga kanë ardhur , përshëmbull në Fier (4.5%) apo në Durrës (2.7%). Qarqet e tjera zënë një përqindje rreth 1 apo dhe më të ulët. Studentët e Fakultetit të Ekonomisë gjejnë mundësi punësimi më shumë duke qëndruar në Tiranë.

Një pjesë e studentëve punësohen gjatë studimeve (24%), një përqindje e tyre kanë qënë të punësuar gjatë studimeve dhe vazhdojnë të jenë akoma (36%). Rreth 1/3 e studentëve punësohen mbasi mbarojnë studimet.

Tabela 5.2.1.3 Studentët sipas fushës së studimit

Programi i Studimit	% e studenteve te intervistuar
Administrim Biznes	15.625
Administrim Biznesi me profile: a. Menaxhim; b. Menaxhim i burimeve njerëzore	3.125
Administrim Publik	3.125
Ekonomiks	6.25
Financë	25
Financë Kontabilitet dhe Auditim	4.6875
Informatikë Biznesi	15.625
Kontabilitet	3.125
Kontabilitet dhe Auditim	1.5625
Marketing	3.125
Menaxhim Turizëm	1.5625
Siguria e Informacionit	3.125
Sisteme Informacioni në Ekonomi	12.5
Teknologji Informacioni dhe komunikimi	1.5625

Përqindjen më të lartë të të intervistuarve e përbëjnë ata që kanë mbaruar Ciklin e Dytë të studimeve dhe kryesisht janë të diplomuar ne Administrim Biznes, Informatikë Biznesi dhe Sisteme Informacioni në Ekonomi.

5.2.2. Punësimi studentëve

Aftësitë që përfitojnë studentët në Fakultetin e Ekonomisë ju jep mundësinë që një pjesë e tyre të fillojnë studimet që gjatë periudhës që janë akoma studentë (33%), një përqindje e konsiderueshme (37%) kanë filluar punë gjatë studimeve dhe vazhdojnë dhe pas.




Figura 5.2.2.1. Koha e punësimit të studentëve

Një përqindje e konsiderueshme janë aktualisht të punësuar dhe rreth 84% kanë pasur një punë ose e kanë aktualisht.

Tabela 5.2.2.1. Punësimi

	A keni punuar ndonjëherë?	A jeni i punësuar aktualisht?
Jo	14.1	23.5
Po	84.4	76.6
NA	1.6	0
Total	100	100

Tabela 5.2.2.2. Punësimi sipas viteve

VITI I DIPLOMIT	A KENI PUNUAR NDONJEHERE?				A JENI NE PUNE AKTUALISHT?			
	NA	Jo	Po	Total	NA	Jo	Po	Total
2018	0.00 %	0.00%	100.00 %	100.00 %	0.00 %	14.29 %	85.71 %	100.00 %
2019	0.00 %	0.00%	100.00 %	100.00 %	0.00 %	12.50 %	87.50 %	100.00 %
2020	0.00 %	10.53 %	89.47%	100.00 %	0.00 %	10.53 %	89.47 %	100.00 %
2021	3.33 %	23.33 %	73.33%	100.00 %	0.00 %	36.67 %	63.33 %	100.00 %

Përqindja e të punësuarve është më e lartë ndër ata që e kanë përfunduar shkollën në vitet e mëparshme dhe bie disi ndër vite. Kjo tregon që aktualisht studentët janë përshtatur mirë në tregun e punës. Tendencat e tregut tregojnë që ata që përfundojnë Fakultetin e Ekonomisë kanë treg pune dhe përshtatja e studentëve që përfundojnë një degë nga FE fitojnë aftësi të tilla të përshtatshme ndaj kërkesave të tregut, duke marrë parasysh edhe fushën e punësimit të tyre.

Tabela 5.2.2.3. Punësimi sipas programit të studimit të ciklit të dytë

Programi i studimit	A keni punuar ndonjehere?		
	NA	Jo	Po
Administrim Biznes	0.00%	20.00 %	80.00%
Administrim Biznesi me profile: a. Menaxhim; b. Menaxhim i burimeve njerëzore	0.00%	0.00%	100.00 %

Administrim Publik	0.00%	0.00%	100.00 %
Ekonomiks	0.00%	25.00 %	75.00%
Financë	0.00%	25.00 %	75.00%
Financë Kontabilitet dhe Auditim	0.00%	33.33 %	66.67%
Informatikë Biznesi	0.00%	10.00 %	90.00%
Kontabilitet	50.00 %	0.00%	50.00%
Kontabilitet dhe Auditim	0.00%	0.00%	100.00 %
Marketing	0.00%	0.00%	100.00 %
Menaxhim Turizëm	0.00%	0.00%	100.00 %
Siguria e Informacionit	0.00%	0.00%	100.00 %
Sisteme Informacioni në Ekonomi	0.00%	0.00%	100.00 %
Teknologji Informacioni dhe komunikimi	0.00%	0.00%	100.00 %

Tendencat e tregut të punës dhe koha e gjetjes së punës ndryshon për programe të ndryshme të studimit (Tabela 7). Vihet re që degë të veçanta kanë përqindjen më të lartë të punësimit. Janë një sërë arsyesh që i shtyjnë studentët të gjejnë një punë. Gjithsesi mos përfshirja në tregun e punës mund të vijë për një sërë arsyesh që ndonjëherë mund të jenë edhe tranzitore.

Ekzistojnë një sërë arsyesh që studentët mos përfshihen në tregun e punës. Ato lidhen me gjetjen e një pune të përshtatshme, gjetjen e orarit të përshtatshëm, etj.

Tabela 5.2.2.4 Arsyet e mos përfshirjes në tregun e punës

Arsyet e mos gjetjes së punës

- I Jam përkushtuar shkollës
- Jo e kënaqur me ofertat
- Ngarkesa e studimeve për të marrë rezultate të larta
- Nuk i kane pranuar aplikimet e bera
- S'kam gjetur pune ne profesion/jo në profesion/ punen e përshtatshme
- Nuk kam pasur mundësi për shkak të ndjekjes së studimeve dhe në cdo vend ku aplikojë kërkesa e vetme ishte eksperiencia e punes dhe/ose fakti qe isha në shkollë dhe nuk e kisha përfunduar ate.
- Orare jo te pershtatshme/jo kohë për studimet/studimet me kohë të plotë
- Per t'u angazhuar maksimalisht në shkollë
- Përkushtim i plotë i programit studimor, prioritet

5.2.3 Sektori i punësimit

Pjesa dërmuese e studentëve që përfundojnë Fakultetin e Ekonomisë punësohen në sektorin privat. Përqindje është ndjeshëm më e lartë krahasuar me sektorët e tjerë në të gjithë vitet e diplomimit (Figura 5).




Figura 5.2.3.1. Sektori punësimit

Gjithashtu vihet re që të punësuarit në sektorin shtetëror janë më të pakët në vitet e fundit, duke lënë të kuptohet që ka një tendencë në rritje drejt sektorit privatë.




Figura 5.2.3.2. Të punësuar sipas sektorëve dhe vitit të diplomimit




Figura 3.2.3.3. Sektorët e punësimit sipas vitit

Të punësuarit janë përgjithësisht me kohë të plotë. Ajo që vihet re nga të dhënat është që gjatë vitit të parë studentët arrijnë të futen në tregun e punës por me kalimin e viteve fitojnë qëndrueshmëri në tregun e punës, kjo duke analizuar statusin e punësimit dhe përqindjen e të punësuarve në vite.

Një dukuri që vihet re nga të përgjigjet është fakti se pavarësisht prirjeve për tu përgjigjur nëse e kanë patur të vështirë gjetjen e punës apo jo, përpjesa e atyre që mendojnë se studimet kanë ndihmuar në gjetjen e punës është pothuajse konstante, pavarësisht faktit të vështirësisë së gjetjes së punës.




Figura 5.2.3.5. Statusi punësimit për studentët e diplomuar në FE

Studentët në punësimet e tyre të mëparshme nuk kanë qënë direkt të përfshirë në fushën e tyre të studimit. Kjo duke qënë se një pjesë e tyre mund të kenë filluar punësimin paralelisht me shkollimin. Për këtë arsye edhe përqindja e studentëve që kanë qënë të përfshirë në punësime që kërkojnë aftësi (komunikuese, gjuhë të huaj, etj) ka qënë më e lartë (Tabela 7).

Tabela 5.2.3.1. Profesioni në punë të angazhuara më parë.

Pune te meparshme	Përqindja
Arketar	3.13
Audit	3.13
Ekonomist	6.25
Financier	3.13
IT Support	1.56
Kontabilist	0

Menaxher	4.69
Operator	3.13
Pedagog të jashtëm/Asist pedagog	0
Shites	4.69
Specialist	15.63
Call center	0
Tjeter	31.25
NA	23.44

Krahasuar më situatën në punësimin aktual studentët kanë qënë të angazhuar më së shumti në bizneset familjare dhe më pas përqindja e të punësuarve në shtet apo privat është rritur ndjeshëm (Figura 6 dhe 3).




Figura 5.2.3.6. Sektori punësimit në punë të mëparshme

Në punët e mëparshme studentët kanë pasur një punë më së shumti me kohë të pjeshme. Aktualisht përqindja e të punësuarve me kohë ta plotë ka ardhur në rritje.




Figura 5.2.3.7. Koha e punësimit

5.2.4 Përshtatja e aftësive me kërkesat e tregut

Punësimi shpesh gjendet si treg i diplomave dhe aftësive që ndonjëherë konvergjojnë dhe ndonjëherë divergjojnë. Holmes (2001) nënvizon që punësimi duhet parë si koncept i identitetit, personal i influencuar nga niveli i arsimimit.

Të diplomuarit në Fakultetin e Ekonomisë kryesisht punësohen si Ekonomistë, Kontabilistë, Financierë, IT, apo menaxherë. Kjo tregon që studentët përfshihen në tregun e punës por gjithashtu angazhohen në fushën për të cilën janë diplomuar.

Tabela 5.2.4.1. Punësimi sipas profesioneve

Profesion	Përqindja
Analist/kredie, biznesi, etj	2.52
Auditues	3.96
BNJ	1.98
Ekonomist	15.14
Financier	16.22
IT/Ëeb developer/	5.95
Menaxher	4.50
Specialist/Banke, risku, etj	7.75

Kontabilist	6.31
Teller	2.70
Jo të punësuar	7.93
NA	3.60
Other	21.44
Gjithsej	100.00

Duke marrë në konsideratë diplomat në Fakultetin e Ekonomisë, vëmë re që përgjithësisht edhe profesionet e gjetura përshtaten me diplomat e tyre. Sikurse ka dhe të tjerë që punësohen në pozicione të spikatura si përgjegjës, shef sektori apo dhe pedagog/profesor por dhe në punë të tilla si operatorë në call center apo pozicione të paspecifikuara qartë (Specialist).

Duke marrë një shkallë nga 1 në 10, vlerësuar sipas vlerësimit me nota, ku 1- nuk u ka ndihmuar dhe 10- ju ka ndihmuar shumë, studentët janë shprehur që diploma ju ka vlejtur për gjetjen e një pune. Kjo vihet re nga një vlerësim në vite rreth shkallës 7. Ky nivel ka qënë më i lartë në vitin 2015 dhe vjen disi në ulje me vitet. Duke marrë parasysh të njëjtin klasifikim në nivelin nga 1 në 10 mbi formimin e marrë në universitet në performancën e punës, studentët gjithashtu shprehen me një nivel mesatar mbi 6 të të gjithë studentëve të diplomuar në vite. Ky nivel qëndron mbi nivelin e gjetjes së punës për studentët e diplomuar në vitin 2017, ndërkohë për vitet e mëparshme qëndron nën mundësinë për gjetjen e punës por diferenca është e vogël.




Figura 5.2.4.1. Diploma për gjetjen e një pune dhe performancës

Mendohet që nota mesatare, dega apo njohjet influencojnë në gjetjen e një pune dhe ecurinë dhe përshtatjen e mëtejshme në tregun e punës.

A mendoni se ju ka ndihmuar formimi juaj në studimet universitare *në gjetjen e një pune*? Vlerëso me notë nga 1 - 10 *

A mendoni se ju ka ndihmuar formimi juaj në universitet *në performancën e punës*? Vlerëso me notë nga 1 - 10 *

Përveçse shkallës mesatare, po të shohim klasifikimin në nivele, vihet re një rritje e përqindjeve drejt niveleve të larta të vlerësimit për faktin se si formimi dhe njohuritë universitare ndikojnë në performancën e punës.




Figura 5.2.4.2. Ndikimi i formimit në universitet në performancën në punë

5.2.5 Promotorët për tregun e punës

Mënyrat dhe format e gjetjes së një pune janë të ndryshme. Ndodh që ashtu sikurse janë shprehur një sërë studentësh, aplikimet në internet, kërkimet që kanë bërë individualisht në internet janë bërë shkak për gjetjen e një pune. Gjithsesi janë edhe burime të tjera që zënë ndoshta një peshë më të madhe për momentin për përfshirjen në tregun e punës.

Shokët, miqtë apo të njohurit zënë peshën kryesore në gjetjen e një pune (19%). Disa shprehen që kanë qenë familjarët (16%) dhe më pak janë vetë aplikimet, njerëzit me pushtet, zyra e karrierës apo dhe aplikimet në zyrën e punës.




Figura 5.2.5.1. Influencuesit në gjetjen e punës

Disa nga studentët fillojnë edhe integrohen në tregun e punës mbas përfundimit të Bachelorit por ndodh që studenti kalon një periudhë tranzicioni në përshtatjen e aftësive të tij dhe kërkesave të tregut të punës. Duke analizuar pyetjen subjektive mbi vështirësinë apo lehtësimin e këtij kalimi duhen marrë parasysh një sërë reformash.

Pyetjes subjektive mbi “Çfarë mendoni se duhet të ndryshojë në Universitetin e Tiranës për të lehtësuar tranzicionin nga shkolla në punë?” I janë përgjigjur 82.5% përqind e studentëve.

Ndër komentet e tyre vihen re sugjerimi për të ndryshuar kurrikulat, për ta bërë më praktike. Gjithashtu ata shprehen që do ishte me vlerë afrimi me firmat private për t’u krijuar më shumë mundësira për punësim.

Një ndër problemet e studentëve në përshtatjen me tregun e punës është edhe aplikimi praktik i teorisë, njohurive dhe vlerave të fituara në universitet. Gjithsesi përveçse përfshirjes së praktikës mësimore janë një sërë hapash që vetë studentët sugjerojnë që fakulteti duhet të ndërmarrë. Rreth 40% e studentëve kanë dhënë sugjerimet rreth përmirësimeve të mundshme që duhet të bëjë universiteti dhe specifikuat fakulteti. Nisur nga kjo, një përqindje e konsiderueshme e studentëve

shprehen se do ishte më me vlerë trajtimi më praktik i temave teorike, angazhimi në një kohë më të zgjatur të praktikës dhe aplikimi në fakultet më shumë njohuri të softëareve statistikore.

5.2.6 Zhvillimi aftësive në përshtatje me specializimin në tregun e punës

Sikurse vihet re edhe më lart studentët që kanë përfunduar studimet më herët janë disi më të stabilizuar në tregun e punës duke punuar me kohë të plotë dhe duke pasur një përqindje më të lartë të punësimit të tyre.

Përveçse aftësive të fituara në shkollë, një pjesë e aftësive perfeksionohen nëpërmjet praktikave paraprahe apo dhe trajnime të ndryshme që kryhen në tregun e punës.

*A keni kryer praktikë profesionale në programin e studimit që keni ndjekur? Vlerëso me një notë nga 1 - 10 **

*Gjatë periudhës së punësimit, a keni kryer trajnime në funksion të pozicionit të punës që keni patur? **




Figura 5.2.6.1. Kryerja e trajnimeve në funksion të pozicionit të punës

Vendi i punës ofron trajnime dhe kualifikime për stafin. Ndër të intervistuarit, më shumë se gjysma e tyre kanë kryer trajnime në vendin e punës.



igura5.2.6.2. Kryerja e praktikës mësimore

Rreth 12% e studentëve nuk kanë kryer praktikë mësimore. Gjithsesi një përqindje e konsiderueshme (rreth 20%) e kanë kryer praktikën dhe e shohin si shumë të vlefshme.

Kryerja e praktikës mësimore është një proces që i njeh studentët me tregun e punës dhe i përgatit ata mbi mundësitë dhe aftësitë e punësimit.

5.3 Fakulteti i Gjuhëve të huaja

Historiku

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i ka fillimet e veta në vitin 1947, viti i themelimit të Katedrës së Gjuhës Ruse. Katedra e Gjuhës Ruse ka funksionuar në kuadrin e një Instituti 2-vjeçar, i cili në vitin 1951 u shndërrua në Institut të Lartë Pedagogjik. Me krijimin e Universitetit të Tiranës më 1957, Katedra e Gjuhës Ruse kalon si degë në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë.

Në vitin 1960, u themelua Departamenti i Gjuhës Angleze (ish-katedra e Gjuhës Angleze). Fillimisht programi mësimor synonte kryesisht përgatitjen e mesuesve të ardhshëm të gjuhës angleze dhe gjuhës e letërsisë shqipe për shkollat e mesme dhe tetëvjeçare. Pesë vjet më vonë, në vitin 1965, u krijua Departamenti i Gjuhës Frënge.

Departamenti i Gjuhës Italiane u krijua në vitin 1984 me synimin për të përgatitur mësuesit e ardhshëm të gjuhës italiane si dhe për të përhapur dhe njohur kulturën dhe botëkuptimin italian⁸.

Në shtator të vitit 1991, krijohet Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. Ky fakultet në përbërjen e tij kishte Katedrën e Gjuhës Ruse, Katedrën e Gjuhës Angleze, Katedrën e Gjuhës Frënge dhe Katedrën e Gjuhës Italiane. Në vitin 1992 fakultetit i shtohet Katedra e Gjuhës Gjermane. Në vitin 1995 krijohet Departamenti i Gjuhëve Sllavo- Ballkanike, i cili në përbërjen e tij përfshiu Degën e Gjuhës Rusë, Degën e Gjuhës Turke (1996) dhe degën e Gjuhës Greke(1998). Në vitin 2008, fakultetit i shtohet edhe departamenti i Gjuhës Spanjolle.⁹

Organizimi

Departamentet

- Departamenti i Gjuhës Angleze
- Departamenti i Gjuhës Italiane
- Departamenti i Gjuhës Frënge
- Departamenti i Gjuhës Spanjolle

⁸ fgjh.edu.al

⁹ unitir.edu.al

- Departamenti i Gjuhës Gjermane
- Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike

Fakulteti është organizuar në një strukturë hierarkike, e ndarë në tre nivele kryesore: Dekani, zv. Dekanët dhe Drejtuesit e Departamenteve.

Fakulteti ofron programet Bachelor, Master shkencor, dhe Doktoraturë¹⁰.

Cikli i parë i studimeve përfshin programet e mëposhtme:

Gjuhë Angleze me profile; gjuhë angleze, përkthim dhe interpretim, studime britanike dhe amerikane

Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim

Gjuhë Gjermane me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim gjermanishtfolës, përkthim dhe interpretim

Gjuhë Italiane me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë , letërsi dhe qytetërim italiane, përkthim dhe interpretim

Gjuhë Turke me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk, përkthim dhe interpretim

Gjuhë Ruse me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim rus, përkthim dhe interpretim

Gjuhë Greke me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek, përkthim dhe interpretim¹¹

Gjuhë Spanjolle me profil: Gjuhë, letërsi dhe qytetërim hispanik¹²

Cikli i dytë i studimeve përfshin programet e studimit “Master i shkencave” referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Programet e studimit “Master i shkencave” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen në

¹⁰ fgjh.edu.al

¹¹ MASH Nr.7897 Prot.dt14.2.2005.

¹² VKM Nr. 831, datë 04.06.2008.

programe që realizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike.

Studimet e ciklit të dytë “Master i shkencave” përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i shkencave” në fushën e arsimimit të kryer¹³.

Në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Cikli i Dytë i studimeve përfshin programet e mëposhtme:

1. Përkthim profili: Përkthyes¹⁴
2. Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor e Turistik¹⁵
3. Përkthim Teknik - Letrar dhe Interpretim¹⁶
4. Mësuesi e Gjuhës Angleze për arsimin e mesëm të lartë
5. Mësuesi e Gjuhës Frënge për arsimin e mesëm të lartë
6. Mësuesi e Gjuhës Gjermane për arsimin e mesëm të lartë
7. Mësuesi e Gjuhës Italiane për arsimin e mesëm të lartë¹⁷

5.3.1 Shpërndarja e studentëve

Të dhënat e mbledhuara nga pyetësi me ish-studentët që kanë përfunduar studimet në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja gjatë katër viteve të fundit tregojnë se studentët me origjinë nga qarku i Tiranës përbëjnë përqindjen më të lartë të të intervistuarve, me 32.4%. Qarqet e tjera kanë një shkallë më të ulët përgjigjesh, ku veçojmë Qarkun e Dibrës 12.4 %, Qarku i Elbasanit 9.5%, Qarku i Lezhës 8.6%, dhe i Fierit 7.6%.

¹³ fgjh.edu.al

¹⁴ UMAS Nr. 371, datë 18.09.2014.

¹⁵ VKM Nr. 1225, datë 03.09.2008.

¹⁶ VKM Nr. 1225, datë 03.09.2009.

¹⁷ VKM Nr.1397,dt.17.10.2008.




Figura 5.3.1.1. Qarku i lindjes

Gjithsesi, siç ilustron edhe në tabelën e mëposhtme, mbas përfundimit të studimeve në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja një përqindje domethënëse kthehet në qarkun e origjinës, ndërsa pjesa më e madhe e të diplomuarve vazhdojnë qëndrimin në Tiranë.

Tabela 5.3.1.1. Qarku ku jetojnë

Qarku ku jetojnë	Përqindja
Berat	2.9
Dibër	1
Durrës	4.9
Elbasan	2.9
Fier	5.9
Gjirokastrë	0
Korçë	1
Kukës	4.9
Lezhë	3.9

Shkodër	0
Tiranë	68.6
Vlorë	1
Jashte Vendit	2
NA	1

Nga numri total i studentëve që iu përgjigjën pyetësorit, 69% prej tyre vazhdojnë të jetojnë në Tiranë pas përfundimit të studimeve, rreth 2% e studentëve janë larguar jashtë vendit, dhe një pjesë e tyre janë kthyer në qarkun nga kanë ardhur.

Përsa i përket përqindjes së studentëve në raport me programin e studimit që ata kanë përfunduar, kemi këtë nivel shpërndarjeje:

Tabela 5.3.1.3. Studentët sipas fushës së studimit

Programi I studimit	% e studenteve te intervistuar
Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor e Turistik	10.784
Guidë Turistike	0.9804
Marrëdhënie Ndërkombëtare	0.9804
Mësuesi e Gjuhës Angleze për arsimin e mesëm të lartë	21.569
Mësuesi e Gjuhës Frënge për arsimin e mesëm të lartë	28.431
Mësuesi e Gjuhës Gjermane për arsimin e mesëm të lartë	7.8431
Mësuesi e Gjuhës Italiane për arsimin e mesëm të lartë	11.765
Mësuesi në Gjuhë-Letërsi për arsimin e mesëm	0.9804
Përkthim profili: Përkthyes	5.8824
Përkthim Teknik - Letrar dhe Interpretim	9.8039

Siç shihet nga tabela e mësipërme, përqindja më e lartë e të intervistuarve është në Ciklin e Dytë të studimeve.

5.3.2 Punësimi i studentëve

Rreth 20% e të diplomuarve në katër vitet të fundit nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja pohojnë se kanë filluar punë gjatë studimeve, gjë që tregon se studentët e këtij fakulteti marrin aftësi funksionale e praktike, dhe se ata janë të gatshëm ti përdorin ato aftësi edhe para diplomimit. Ndërkohë, 59% e të diplomuarve që iu përgjigjën pyetësorit kanë filluar punë kur ishin ende studentë dhe vazhdojnë të jenë akoma në punë, dhe 13% kanë filluar punë pas përfundimit të studimeve. Këto të dhëna vërtetojnë edhe njëherë faktin se studentët e këtij fakulteti fitojnë aftësi të dobshme që i bëjnë atë tërheqës për tregun e punës si para, ashtu edhe pas përfundimit të studimeve.




Figura 5.3.2.1. Koha e punësimit të studentëve

Me fjalë të tjerë, rreth 63% e të intervistuarve janë aktualisht të punësuar, dhe rreth 89% kanë pasur një punë ose e kanë aktualisht. Vetëm 10% pohojnë se nuk kanë punuar ndonjëherë.

Tabela 5.3.2.1. Punësimi

	A keni punuar ndonjëherë?	A jeni i punësuar aktualisht?
--	----------------------------------	--------------------------------------

Jo	10.8	35.3
Po	89.2	62.8
NA	0	2
Total	100	100.1

Përsa i përket punësimit të studentëve në raport me vitin e diplomimit, kemi këtë nivel shpërndarjeje:

Tabela 5.3.2.2. Punësimi sipas viteve

VITI I DIPLOMIT	A KENI PUNUAR NDONJEHERE				A JENI NE PUNE AKTUALISHT?			
	NA	Jo	Po	Total	NA	Jo	Po	Total
2018	0.00 %	8.33%	91.67%	100.00 %	8.33 %	50.00 %	41.67 %	100.00 %
2019	0.00 %	0.00%	100.00 %	100.00 %	0.00 %	25.00 %	75.00 %	100.00 %
2020	0.00 %	9.09%	90.91%	100.00 %	0.00 %	18.18 %	81.82 %	100.00 %
2021	0.00 %	13.33 %	86.67%	100.00 %	1.67 %	40.00 %	58.33 %	100.00 %

Shpërndarja e punësimit të të diplomuarve ndër vite është pothuajse e njëtrajtshme, me një përqindje lehtësisht më të lartë punësimi për ish-studentët e diplomuar në tre vitet e fundit. Përqindja e lartë e punësimit dhe qëndrueshmëria e këtyre treguesve ndër vite tregon që programet e studimit janë të konsoliduara dhe se orjentimi i studentëve drejt tregut të punës është bërë me efikasitet.

Siç theksuam më lart, 10% e të diplomuarve pohuan se nuk kishin punuar ndonjëherë. Në përgjigje të pyetësorit, ish-studentët rendisin një sërë arsyesh për mos përfshihen e tyre në tregun e punës:

Tabela 5.3.2.3. Arsyet e mos përfshirjes në tregun e punës

Arsyet e mos gjetjes së punës

- Nuk ka vende të lira
- Për tu fokusuar studimeve

-
- Sepse nuk me jane krijuar mundesite per pune ne profil
 - Sepse po kryej praktiken profesionale
-

5.3.3 Sektori punësimit

Sipas të dhënave të grumbulluara gjatë anketimit me ish-studentët që kanë përfunduar studimet Master në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në katër vitet e fundit, rezulton se pjesa më e madhe e të diplomuarve punësohen në sektorin privat (62%), dhe një pjesë e kunsiderueshme punësohen në sektorin shtetëror (17%):




Figura 5.3.3.1. Sektori punësimit

E parë ndër vite, vihet re një rritje sa i përket raportit të punësimit në sektorin privat (62%) përkundrejt atij shtetëror (17%). Gjithësesi, në vitet fundit punëdhënësi më i madh i të diplomuarve në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja ka qenë sektori privat:




Figura 5.3.3.2. Të punësuar sipas sektorëve dhe vitit të diplomimit

Pjesa më e madhe e të punësuarve (56%) deklarojnë se punojnë me kohë të plotë, ndërsa 26% prej tyre janë të punësuar me kohë të pjesshme.




Figura 5.3.3.3. Statusi punësimit për studentët e diplomuar ne FGJH

5.3.4 Përshtatja e aftësive me kërkesat e tregut


Përqindja e punësimit e shpërndarë sipas profesioneve na jep të dhëna interesante që tregojnë se punësimi i ish-studentëve është në përputhje me fushën e tyre të studimit. Rreth 2% e të diplomuarve punojnë si mësues, rreth 9% prej tyre punojnë në Operator Call Center, , dhe 3% punojnë si përkthyes.

Tabela 5.3.4.1. Punësimi sipas profesioneve

Punësimi sipas profesioneve	Përqindja
Mësues	21.36
Përkthyes	2.91
Asistent	1.94
Operator	8.74
Menaxher	1.94
Tjetër	42.72
NA	20.39

Pyetjes “A mendoni se ju ka ndihmuar formimi juaj në universitet në performancën në punë? (vlerëso 1-10)”, pjesa më e madhe e studentëve i janë përgjigjur me vlerësim të lartë mbi 8 pikë (14% - 8 pikë; 9% - 9 pikë; 24% - 10 pikë). Gjithsesi, një përqindje e konsiderueshme e ish-studentëve (16%) kanë përzgjedhur vlerësimin mesatar me 5 pikë:

Figura 5.3.4.1. Ndikimi i formimit në universitet në performancën në punë



Në lidhje me pyetjen se sa iu ka vlejtur diploma në gjetjen e një pune, përsëri duke marrë parasysh të njëjtin klasifikim në nivelin nga 1 në 10 pikë (1- nuk i ka ndihmuar dhe 10- i ka ndihmuar shumë), studentët janë shprehur që diploma u ka vlejtur për gjetjen e një pune. Kjo vihet re nga një vlerësim në vite mbi 6 pikë, me një tendencë të lehtë në rritje gjatë viteve të fundit:




Figura 5.3.4.2. Diploma për gjetjen e një pune

5.3.5 Promotorët për tregun e punës

Ish-studentët rendisin një sërë faktorësh të tjerë që i kanë ndihmuar ata në gjetjen e një pune si, miqtë/shokët (44%), familjarët (10%) zyra e punës (4%), qendra e karrierës (1%). Të shumtë kanë qenë edhe ata që janë shprehur se kanë gjetur punë pa mbështetjen e askujt, por duke aplikuar vetë, nëpërmjet internetit, etj. (31%):




Figura 5.3.5.1 Influencuesit në gjetjen e punës

Me shumë vlerë janë edhe komentet që kanë dhënë vetë ish-studentët në lidhje me pyetjen e hapur “Çfarë mendoni se duhet të ndryshojë në Universitetin e Tiranës për të lehtësuar tranzicionin nga shkolla në punë?”. Ndër to mund të veçojmë: “Studentet duhet të dalin të përgatitur realisht për tregun e punës. Duhet me shumë ore praktike sesa teorike.”; “Studim të tregut të punës dhe një qasje serioze ndaj arsimit në përgjithësi duke qenë hallka kryesore e çdo fushe të jetës.”; “të krijoje me shumë kontakte dhe të informoje studentet për tregun dhe institucionet gjithashtu.”; “Me shumë fokus në forcimin e aftësive për jetën dhe përgatitjen e studentëve për tregun e punës. Drejtimi/lehtësimi i procesit të ofrimit të trajnimit.”; “Gjatë studimeve të bëhen trajnime, praktika në zyrë o institucione perkatese sipas specifikave që ka programi i studimit.”; “komunikim mes studentëve që diplomohen dhe sa më shumë info. për orientim në gjetjen e punës.”; “Sugjeroj që strukturat e UT-se të punojnë me shumë për punësimin e të diplomuarve dhe të marrin masa për ta konkretizuar këtë në praktike.”; “Komunikimi mes UT dhe disa kompanive që kërkojnë të punësojnë studentë të fushave të ndryshme.”; “Te vazhdojnë të ndjekin ecimin e nxënësve të tyre pas universitetit. Ti ndihmojnë me sa kanë mundësi.”.

5.3.6 Zhvillimi aftësive në përshtatje me specializimin në tregun e punës

Rreth 20% e ish-studentëve që i janë përgjigjur pyetësorit pohojnë se nuk e kanë kryer praktikën profesionale gjatë studimeve në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, ndërsa 80% prej tyre e kanë kryer praktikën profesionale, por japin vlerësime të ndryshme në lidhje me efikasitetin e saj. Kështu, pjesa më e madhe e ish-studentëve (36%) mendojnë se praktika profesionale u ka vlejtur shumë dhe e kanë vlerësuar atë me 10 pikë. Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm i ish-studentëve japin vlerësime mbi 5 pikë (8% - 5 pikë; 5% - 7 pikë; 10% - 8 pikë; 6% - 9 pikë):



Figura 5.3.6.1. Kryerja e praktikës mësimore

Përveç praktikës profesionale, shumë prej ish-studentëve pohojnë se kanë marrë trajnim më specifik edhe gjatë periudhës së punësimit në funksion të pozicionit të punës që kanë. Siç vihet re edhe në grafikun e mëposhtëm, rreth 61% e të intervistuarve janë shprehur se kanë kryer trajnime gjatë periudhës së punësimit, ndërsa 34% prej tyre thonë se nuk kanë kryer trajnime të tilla:




Figura 5.3.6.2. Kryerja e trajnimeve në funksion të pozicionit të punës

5.4 Fakulteti i Histori Filologjisë

Historiku

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë është krijuar në vitin 1951, si pjesë e Insitutit të Lartë Pedagogjik, që ka qene institucioni i parë në Shqipëri për përgatitjen e mësuesve me arsim të lartë për shkencat shoqerore dhe natyrore. Me krijimin e Universitetit Shtetëror të Tiranës, në vitin 1957, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë u bë një nga shtatë fakultetet e tij. Fillimisht, ai përbëhej nga degët e historisë, gjuhë – letërsisë, më vonë këtu u shtua dhe dega e gazetarisë dhe i gjuhës ruse. Që atëherë, ai ka pësuar zgjerime dhe riorganizime të shumta. Kështu, në vitin akademik 1960-1961 iu shtua dega e gjuhës angleze dhe më 1966 ajo e gjuhës frënge.

Më 1972 degët e gjuhëve të huaja u shkëputën nga ky fakultet, për të formuar Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, ndërsa dy vjet më vonë të dy fakultetet u bashkuan në një të vetëm, për t’u rindarë sërish më 1992. Pranë këtij fakulteti ka ekzistuar edhe departamenti i pavarur ndërdisiplinar i psikologjisë dhe i pedagogjisë, i cili u bë bazë e mëvonshme e Fakultetit të Shkencave Sociale.

Në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë kanë dhënë mësim personalitetet dhe shkencetarët më të njohur shqiptarë në fushën e shkencave albanologjike: si E. Çabej, A. Buda, M. Domi, Sh. Demiraj, S. Luarasi, N. Bulka, V. Kokona, I . Kadare, Z. Sako, Q. Haxhihasani, S. Prifti, A. Kostallari, J. Xoxa etj. Profesorati i këtij fakulteti ka dhënë një ndihmesë të dukshme edhe për ngritjen dhe

funksionimin e fakulteteve të Universiteteve të tjera të Shqipërisë, duke përfshirë dhe Universitetin e Prishtinës.

Duke filluar nga viti shkollor 1969-1970, pranë degëve gjuhë shqipe – letërsi dhe histori janë krijuar herë pas here, në varësi nga nevojat, edhe profile të veçanta për gjuhë të tjera të huaja, si për gjuhën latine, greke e vjetër, italiane, bullgare, rumune, sërbo-kroate, çeke, poloneze, hungareze, gjermane e spanjolle.

Nisur nga nevojat e një përgatitjeje me të plote të mesuesve dhe të specialisteve, edhe struktura dhe profili i degeve ka ardhur duke u ndryshuar. Kështu, në vitin 1982 u arrit ndarja e deges histori-gjeografi në dy degë të veçanta: Histori me elemente të gjeografisë dhe Gjeografi me elemente të historisë. Rezultatet pozitive të kësaj ndarjeje të pjesshme, ngritja e nivelit të kualifikimit të profesoratis dhe, sidomos mundësitë e krijuara pas vitit 1990, e bëne të domosdoshëm thellimin e mëtejshëm të specializimit të këtyre degëve.

Kualifikimi pasuniversitar ka nisur qysh në vitin 1981, kur pranë këtij fakulteti u hapën disa kurse pasuniversitare njëvjeçare: fillimisht ai i psikologjisë dhe i pedagogjisë, një vit më vonë kursi i gjuhës shqipe, në vitin 1984 kursi i historisë, me 1985 kursi i kritikës letrare dhe me 1987 kursi pasuniversitar i psikologjisë dhe i pedagogjisë, pa shkeputje nga puna. Në vitin 1991 këto kurse u mbyllën, për t'u hapur përsëri më 1996, kësaj here si shkolla pasuniversitare (fillimisht me korrespondencë), dmth. si shkallë e parë e një sistemi të plotë dyshkallësh të kualifikimit pasuniversitar, që u ndërtua sipas departamenteve përkatëse: Shkolla Pasuniversitare e Departamentit të Gjuhësisë, shkolla pasuniversitare e Departamentit të Letërsisë, Shkolla Pasuniversitare e Departamentit të Historisë, shkolla pasuniversitare e Departamentit të Gjeografisë.

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë ka qenë dhe është një ndër institucionet e rëndësishme shkencore të AL të vendit, me një veprimtari të gjerë, ku përfshihet organizimi i konferencave shkencore dhe pjesëmarrja në tubime shkencore kombëtare, rajonale e ndërkombëtare, botimet e monografive, punimeve shkencore e të teksteve mësimore për shkollën e lartë, të mesme dhe 8-vjeçare (sot 9-vjeçare). Njëherazi, ai mbetet institucioni më i rëndësishëm i vendit për përgatitjen dhe kualifikimin e studiuesve.

Sipas profileve përkatëse të shkencave albanologjike, këtu njihet e drejta e mbrojtjes së tezave të doktoratës prej kandidatësh vendas e të huaj.

Edhe përmbajtja e procesit mësimor ka pësuar ndryshime të shumta, në përputhje me shkallën e zhvillimit të shoqërisë shqiptare, me nevojat e saj dhe me kërkesat e shtruuara para shkollës së lartë. Kështu, në fillim të gjitha degët kishin si detyrë kryesore përgatitjen e mësuesve për shkollën e mesme, megjithëse, në të vërtetë, mësuesit e diplomuar prej këtij Fakulteti kanë punuar edhe në ciklin e lartë të shkollës 8-vjeçare. Krahas kësaj, këto degë kanë siguruar edhe kontigjentin për institucionet kërkimore-shkencore dhe për institucionet e tjera kulturore të vendit, si ATSH-ja, Radioja e Televizioni, institutet e Akademisë së Shkencave dhe me vone universitetet në rrethe, shtëpitë botuese etj, për të plotësuar kërkesat e këtyre institucioneve për kuadro.

Këto specializime e profilizime janë shoqëruar edhe me një punë të madhe për hartimin e planeve të reja mësimore, të programeve të lëndëve të shumta që janë shtuar në këto plane, si dhe për rishikimin e programeve të lëndëve ekzistuese, me qëllim që në to të pasqyrohen arritjet e shkencës botërore. Nga ana tjetër, për vetë profilin që ka ky fakultet, pas viteve '90 u bë një riorganizim i përgjithshëm i programeve, të cilat kishin qenë tejet të politizuara. Ato u reformuan totalisht si në formë dhe në përmbajtje.

Një ndihmesë të çmuar ka dhënë Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë për përgatitjen e studenteve të huaj si përkthyes, gjuhëtarë, historianë, studiues të letërsisë shqiptare etj. Veçanërisht e madhe ka qenë puna e bërë nga dega e gjuhës dhe e letërsisë shqipe, pranë së cilës kanë studiuar dhe janë diplomuar 282 studentë të huaj, nga 25 vende të ndryshme të botës, kryesisht nga vendet e sh-socialiste, nga Azia, Afrika dhe Amerika Latine. Veç këtyre, pranë katedrës së gjuhës shqipe kanë ndjekur kurse përgatitore njëvjeçare të gjuhës mjaft studentë nga vende të ndryshme. Kjo traditë vijoi deri në vitin 1982, kur, si rrjedhim i politikës së vetizimit të ndjekur nga qeveria e kohës, këto kurse u mbyllën, Tani po bëhen përpjekje të shumta për ta ringjallur këtë traditë të bukur. Kështu, nga viti 1991 e këndej pranë Departamentit të Gjuhësisë kanë ardhur, kryesisht në kuadrin e konventave kulturore, specialistë dhe studentë të huaj, një pjesë e të cilëve, pas përfundimit të kursit përgatitor njëvjeçar, po studiojnë për gjuhë shqipe dhe letërsi, ose mbrojnë teza dhe diploma të ndryshme të albanologjisë. Pranë këtij departamenti kanë kryer kualifikime pasuniversitare docentë kineze, docentë rumunë, grekë, zvicerianë etj e pritët të vijnë dhe të tjerë.

Prej vitit shkollor 1994-1995 kanë rifilluar të funksionojnë edhe kurset e verës të gjuhës dhe të kulturës shqiptare, në të cilat marrin pjesë studentë nga vende të ndryshme të botës.

Në vitin 2012 është krijuar në këtë fakultet Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore.

Organizimi

Departamentet

- Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore
- Departamenti i Gazetarisë dhe i Komunikimit
- Departamenti i Gjeografisë
- Departamenti i Gjuhësisë
- Departamenti i Historisë
- Departamenti i Letërsisë

Fakulteti është organizuar në një strukturë hierarkike, e ndarë në tre nivele kryesore: Dekani, zv. Dekanët dhe Drejtuesit e Departamenteve. Fakulteti ofron programet Bachelor, Master profesional¹⁸ dhe shkencor si dhe Doktoraturë¹⁹.

Master Profesional

- në Mësuesi në Gjeografi për AML, profili Mësues Gjeografie për arsimin e mesëm të lartë;
- në Mësuesi në Gjuhë-Letërsi për AML, profili Mësues i Gjuhë-Letërsisë për arsimin e mesëm të lartë;
- në Mësuesi në Histori për AML, profili Mësues Historie për arsimin e mesëm të lartë;
- në Redaktori;
- në Arkivistikë;
- në Guidë turistike.

Master Shkencor

- në Gazetari dhe Komunikim, profili Marrëdhënie publike;
- në Gazetari dhe Komunikim, profili Marrëdhënie europiane dhe ndërkombëtare;
- në Gazetari dhe Komunikim, profili Komunikim ndërkulturor;
- në Gazetari dhe Komunikim, profili Marketing mediatik;
- në Gazetari dhe Komunikim, profili Drejtim dhe menaxhim i mediave;
- në Histori;
- në Arkeologji;
- në Trashëgimi kulturore;

¹⁸ Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".

¹⁹ Ligjit 80/2015 "Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH", i përfundojnë ato sipas kriterëve dhe modaliteteve të legjislacionit të kohës që janë pranuar.

- në Marrëdhënie ndërkombëtare;
- në Studime letrare, profili Teori letërsie dhe kritikë letrare;
- në Studime letrare, profili Letërsi e përgjithshme dhe e krahasuar;
- në Studime letrare, profili Studime letrare shqiptare dhe antropologji kulturore;
- në Gjuhësi, profili Gjuhësi e sotme;
- në Gjuhësi, profili Gjuhësi historike;
- në Gjeografi.

Programet që ofrojmë në Doktoraturë:

- Doktoratë në Gjeografi;
- Doktoratë në Studime Letrare;
- Doktoratë në Gjuhë;
- Doktoratë në Shkenca Komunikimi
- Doktoratë në Marrëdhënie Ndërkombëtare;
- Doktoratë në Histori;
- Doktoratë në Arkeologji;
- Doktoratë në Trashëgimi Kulturore.

5.4.1 Shpërndarja e studentëve

Përqindjen më të lartë të të intervistuarve e përbëjnë studentët me origjinë nga Kukësi dhe Korça. Qarqet e tjera kanë një përqindje më të ulët të të intervistuarve. Gjithsesi mbas përfundimit të studimeve vetëm një përqindje e vogël kthehet në qarkun origjinë. Një përqindje e konsiderueshme vazhdojnë qëndrimin në Tiranë.

Figura 5.4.1.1. Qarku i lindjes




Tabela 5.4.1.1. Qarku ku jetojnë

Vendbanimi	Përqindja
	2.2
Berat	2.2
Dibër	2.9
Durrës	2.2
Elbasan	2.9
Fier	3.6
Gjirokastrë	.7
Jashtë Vendi	.7
Korçë	2.9
Kukës	1.4
Lezhë	4.3
Shkodër	.7
Tiranë	65.9
Vlorë	7.2

Nga të dhënat e studentëve të intervistuar, ata që kanë përfunduar studimet 4 vitet e fundit, rreth 66% e studentëve që kanë përfunduar studimet në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, qëndrojnë në Tiranë. Kjo për faktin e mundësive që krijon Tirana për punësim.

Rreth 1% e studentëve janë larguar jashtë vendit. Një pjesë e tyre janë kthyer në qarkun nga kanë ardhur, për shembull në Vlorë (7.2%), në Lezhë 4.3%, në Fier 3.6% apo në Elbasan dhe Korçë (2.9%). Qarqet me një përqindje pak më të vogël janë Gjirokastra (1%) dhe Shkodra (1%).

Tabela 5.4.1.2. Shpërndarja gjeografike e studentëve sipas qarkut origjinë

	Të qëndruarve në Tiranë (ndaj popullsisë së rrethit)	Të larguarit jashtë vendit
Berat	70	0
Dibër	69	0
Durrës	0	0
Elbasan	55	0.09
Fier	69	0
Gjirokastrë	85	0
Korçë	50	0
Lezhë	33	0
Shkodër	0	0
Tiranë	100	0
Vlorë	50	0

Studentët e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë kanë më shumë mundësi punësimi duke qëndruar në Tiranë.

Tabela 5.4.1.3. Studentët sipas fushës së studimit

Programi i studimit	Përqindja e të intervistuarëve
Arkeologji	2.9
Arkivistikë	2.2
Etika në institucione dhe lidërsip	.7
Gazetari dhe komunikim me profile: a. Marrëdhënie publike; b. Marrëdhënie evropiane dhe ndërkombëtare; c. Komunikimi ndërkulturore; ç. Marketing mediatic; d. Drejtimi dhe menaxhimi i	2.2
Gjeografi	17.4
Gjuhësi ,me profil Gjuhësi e sotme	.7
Gjuhësi,me profil Gjuhësi Historike	.7
Histori	2.2
Marketing	.7
Marrëdhënie Ndërkombëtare	2.2
Mësuesi e Gjuhës Angleze për arsimin e mesëm të lartë	.7
Mësuesi në Gjeografi për arsimin e mesëm	2.2

Mësuesi në Gjuhë-Letërsi për arsimin e mesëm	58.0
Mësuesi në Histori për arsimin e mesëm	3.6
Mësuesi në Shkenca Sociale për arsimin e mesëm të lartë	.7
Studime Letrare	1.4
Trashëgimi Kulturore	.7

Përqindja më e lartë e të intervistuarve është në profilin Mësuesi në Gjuhë-Letërsi për arsimin e mesëm 58%, e cila ndiqet nga Gjeografi 17.4%.

5.4.2 Punësimi i studentëve

Studentët në Fakultetin e Historisë që janë bërë pjesë e këtij studimi rezultojnë 76% të punësuar dhe 22% të papunësuar. Për të parë se kur janë përfshirë në marrëdhënie pune referohuni grafikut të mëposhtëm:

Figura 5.4.2.1. Koha e punësimit të studentëve




Tabela 5.4.2.1. Punësimi

	A keni punuar ndonjëherë?	A jeni punësuar aktualisht?
NA	2.2	.7

Jo	21.7	57.2
Po	76.1	42.0

Tabela 5.4.2.2. Punësimi sipas viteve

Viti i diplomimit	A keni punuar ndonjëherë?			A jeni punësuar aktualisht?		
	Po	Jo	NA	Po	Jo	NA
2018	6.5	1.4	0	5.8	2.2	0
2019	5.1	0.7	0	2.2	3.6	0
2020	20.3	3.6	0.7	12.3	12.3	0
2021	44.2	15.9	1.4	21.7	39.1	0.7

Përqindja e të punësuarve luhetet ndër vite. Përqindja e të punësuarve rezulton më e lartë në vitin 2021 ku 44% e studentëve kanë pasur një punë dhe vijon që 22% e tyre të jenë ende në punë. Vlerat tregojnë që aktualisht studentët nuk janë përshtatur mirë në tregun e punës. Por janë një sërë arsyesh që i shtojnë studentët të gjejnë një punë por gjithsesi ka dhe një sërë arsyesh që studentët mos përfshihen në tregun e punës lidhur kjo me gjetjen e një pune të përshtatshme, gjetjen e orarit të përshtatshëm etj.

Tabela 5.4.2.3. Arsyet e mos përfshirjes në tregun e punës

ARSYET E MOS PËRFSHIRJES NË TREGUN E PUNËS:
Ja kam kushtuar kohën shkollës.
Nuk ka vende pune për degën që kam mbaruar.
Nuk me është ofruar pune në fushën që kam studiuar
Partia
Sepse me Master i Shkencave ka mundësi punësimi të pakta, nuk të lejojnë të punosh në mësuesi sepse je më i kualifikuar se çduhet. Nga mungesa e punësimit jam detyruar të vazhdoj master profesional në mësuesi.
Sepse nuk kam dhënë akoma Portalin Mesues për Shqipërinë
Sepse nuk kam gjetur mundësi punësimi.
Sepse tregu i punës nuk të ofron një mundësi punësimi
Shkollë koti
Skam gjetur punë
S'më është krijuar mundësia për punë sepse skemi eksperiencë

5.4.3 Sektori i punësimit

Në sektorin privat punësohet pjesa dërrmuese e studentëve që përfundojnë studimet në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë dhe kjo përqindje është ndjeshëm më e lartë krahasuar me sektorët e tjerë.




Figura 5.4.3.1. Sektori punësimit

Punësimi në sektorin privat duket se ofron mundësitë më të mëdha të punësimit pasi pjesa më e madhe (58%) rezulton e punësuar në këtë sektor. Ndërsa punësimi në shtet është në shifra të konsiderueshme rreth 16%.




Figura 5.4.3.2. Të punësuar sipas sektorëve dhe vitit të diplomimit

Vihet re një rritje e të punësuarve nga viti në vit në sektorin privat, ndërkohë që sektori shtetëror nuk ruan një trend linear.




Figura 5.4.3.3. Statusi i punësimit për studentët e diplomuar në FHF

Nga grafiku i mësipërm vihet re një përqindje e konsiderueshme e punësuar me kohë të plotë 49%, por duhet kuptuar edhe ka kërkon një vëmendje të vecantë edhe përqindja e konsiderueshme 25% e tyre e punësuar me kohë të pjesshme.

Pavarësisht prirjeve për tu përgjigjur nëse e kanë patur të vështirë gjetjen e punës apo jo, pjesa e atyre që mendojnë se studimet kanë ndihmuar në gjetjen e punës është pothuajse konstante, pavarësisht faktit të vështirësisë së gjetjes së punës.




Figura 5.4.3.4. Statusi punësimit për studentët e diplomuar në FHF

Në angazhimet e mëparshme studentët nuk kanë qënë direkt të përfshirë në fushën e tyre të studimit. Kjo duke qënë se një pjesë e tyre mund të kenë filluar punësimin paralelisht me shkollimin. Për këtë arsye edhe përqindja e studentëve që kanë qënë të përfshirë në punësime që kërkojnë aftësi (komunikuese, gjuhë të huaj, etj) ka qënë më e lartë (Tabela 7).

Tabela 5.4.3.1. Profesionet në punë të angazhuara më pare

Profesionet	Përqindja
Pedagog e jashtëm	2.90
Operator	7.25
Marketing	5.80
Përgjegjës	2.90
Kamarier/Banakier	4.35
Call center	2.90
Other	21.74
NA/not at work	52.17

Studentët kanë qënë kryesisht të angazhuar më së shumti në bizneset familjare dhe më pas përqindja e të punësuarve në shtet apo privat është rritur ndjeshëm (Figura 6 dhe figura 3).




Figura 5.4.3.5. Lloji i punësimit në punësimin aktual dhe atë të mëparshëm

Në punët e mëparshme 49% e studentëve kanë pasur një punë me kohë të plotë dhe 25% me kohë të pjesshme. Aktualisht përqindja e të punësuarve me kohë ta plotë është rritur 49% dhe punësimi i pjesshmëm ka qenë 30%.

5.4.4. Përshtatja e aftësive me kërkesat e tregut

Të diplomuarit në Fakultetin e Historisë kryesisht punësohen si mësues, pedagogë, gazetarë por shpeshherë ata për shkak të mungesës së mundësive të punësimit që vendi ofron detyrohen të punojnë në profesione të cilat nuk kanë lidhje me diplomat e tyre si në call center etj. Kjo tregon që studentët janë të përfshirë pjesërisht në tregun e punës në fushën për të cilën janë diplomuar.

Tabela 5.4.4.1. Punësimi sipas profesioneve

Profesionet	Përqindja
Call center	5.8
Mësues	15.9
Marketing	4.3
Shites	4.3
Tjeter	26.1
Jo ne pune	43.5
Gjithsej	100.0

Duke marrë në konsideratë diplomat që përfundojnë të diplomuarit në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, vëmë re që përgjithësisht edhe profesionet e gjetura përshtaten me diplomat e tyre si mësues. Por të intervistuarit bëjnë dhe punë të tilla që nuk kanë lidhje me diplomat si operatorë në call center, marketing dhe shitës.

Duke marrë parasysh të njëjtin klasifikim në nivelin nga 1 në 10 mbi formimin e marrë në universitet në performancën e punës, studentët gjithashtu shprehen me një nivel mesatar mbi 6 të të gjithë studentëve të diplomuar në vite. Po ashtu si dhe për ndihmesën që jep diploma në gjetjen e një pune, viti 2021 është vlerësuar më shumë se vitet e tjera për performancën e punës.




Figura 5.4.4.1. Diploma për gjetjen e një pune dhe performances

Mendohet që nota mesatare, dega apo njohjet influencojnë në gjetjen e një pune dhe ecurinë dhe përshtatjen e mëtejshme në tregun e punës.

5.4.5 Promotorët për tregun e punës

Mënyrat dhe format e gjetjes së një pune janë të ndryshme. Ndodh që ashtu sikurse janë shprehur një sërë studentësh, aplikimet në internet, kërkimet që kanë bërë individualisht në internet janë bërë shkak për gjetjen e një pune. Gjithsesi janë edhe burime të tjera që zënë ndoshta një peshë më të madhe për momentin për përfshirjen në tregun e punës.

Shokët, miqtë apo të njohurit vijnë të zënë peshën kryesore në gjetjen e një pune (33%), është rritur ndjeshëm përqindja e gjetjes së punës nga Zyra e karrierës, 28% e pasuar me 15% e ndihmuar nga familjarët.




Figura 5.4.5.1. Influentesit në gjetjen e punës

Disa nga studentët fillojnë edhe integrohen në tregun e punës mbas përfundimit të ciklit të parë Bachelor por ndodh që studenti kalon një periudhë tranzicioni në përshtatjen e aftësive të tij dhe kërkesave të tregut të punës. Duke analizuar pyetjen subjektive mbi vështirësinë apo lehtësimin e këtij kalimi duhen marrë parasysh një sërë reformash.

Ndër komentet e tyre vihen re sugjerimi për të ndryshuar kurrikulat, për ta bërë më praktike. Gjithashtu ata shprehen që do ishte me vlerë afrimi me firmat private për t'u krijuar më shumë mundësira për punësim.

Një ndër problemet e studentëve në përshtatjen me tregun e punës është edhe aplikimi praktik i teorisë, njohurive dhe vlerave të fituara në universitet. Gjithsesi përveçse përfshirjes së praktikës mësimore janë një sërë hapash që vetë studentët sugjerojnë që fakulteti duhet të ndërmarrë. Rreth 40% e studentëve kanë dhënë sugjerimet rreth përmirësimeve të mundshme që duhet të bëjë universiteti dhe specifikisht fakulteti. Nisur nga kjo, një përqindje e konsiderueshme e studentëve

shprehen se do ishte më me vlerë trajtimi më praktik i temave teorike, angazhimi në një kohë më të zgjatur të praktikës dhe aplikimi në fakultet më shumë njohuri të softwareve statistikore.

5.4.6. Zhvillimi aftësive në përshtatje me specializimin në tregun e punës

Sikurse vihet re edhe më lart studentët që kanë përfunduar studimet më herët janë disi më të stabilizuar në tregun e punës duke punuar me kohë të plotë dhe duke pasur një përqindje më të lartë të punësimit të tyre.

Përveçse aftësive të fituara në shkollë, një pjesë e aftësive perfeksionohen nëpërmjet praktikave paraprake apo dhe trajnime të ndryshme që kryhen në tregun e punës.




Figura 5.4.6.1. Kryerja e trajnimeve në funksion të pozicionit të punës

Vendi i punës ofron trajnime dhe kualifikime për stafin. Një pjesë e konsiderueshme e të intervistuarve (43%) kanë kryer trajnime në vendin e punës.




Figura 5.4.6.2. Kryerja e praktikës mësimore

Rreth 42% e studentëve nuk kanë kryer praktikë mësimore. Gjithsesi një përqindje e lartë 53% e kanë kryer praktikën dhe e shohin si shumë të vlefshme.

Kryerja e praktikës mësimore është një proces që i njeh studentët me tregun e punës dhe i përgatit ata mbi mundësitë dhe aftësitë e punësimit.

5.5 Fakulteti i Shkencave të Natyrës

Historiku

Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) është njësi kryesore e Universitetit të Tiranës që në krijimin e tij në vitin 1957. Ai u krijua mbi trashëgiminë e Institutit të Lartë Pedagogjik të Tiranës, 4 vjeçar (1951-1957), i cili ishte institucioni i parë në Shqipëri për përgatitjen e mësuesve me arsim të lartë, si edhe mbi organizimin e disa katedrave e sektorëve të Institutit të Shkencave dhe atij Politeknik.

FSHN që në krijimin e vet dhe deri tani është qendra kryesore në Shqipëri për përgatitjen e specialistëve të lartë në matematikë, fizikë, kimi, kimi industriale, biologji, bioteknologji e informatikë si edhe një nga institucionet më të rëndësishme të vendit për përgatitjen e mësuesve për shkollat e mesme.

FSHN filloi aktivitetin e vet me 6 katedra, ajo e matematikës, fizikës, biologjisë, kimisë së përgjithshme, të cilat drejtonin studimet për 4 diploma, matematikë, fizikë, biologji -kimi dhe kimi industriale.

Në vitet 1960 u shtuan edhe 2 profile të reja: matematikë speciale dhe fizikë speciale, kurse 5-vjeçare që së bashku me profilin biologji speciale në 1984 u bënë shkolla ku u përgatitën figurat më të spikatura të shkencës dhe arsimit në fushën e shkencave të natyrës.

FSHN gjatë gjithë kohës ka qënë në ndryshim si strukturor ashtu dhe në përmbajtje të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor duke ju përgjigjur nevojave të zhvillimit të vendit.

Të gjitha katedrat zgjeruan kërkimin shkencor dhe u rritën profesionalisht në kontakt edhe me zhvillimin e shkencës në botë. Mjaft pedagogë të këtij Fakulteti janë specializuar jashtë shtetit në Universitete të njohura, kanë kryer doktoraturat në ato universitete si në vendet e Europës lindore ashtu dhe në ato të Europës perendimore. Ecja me hapin e kohës ka bërë që në vitet në vazhdim FSHN të ofrojë programe të ndryshme studimi duke diplomuar specialist sipas nevojave të vendit. Në këtë Fakultet janë hapur për herë të parë edhe degë si Farmacia dhe Mercellogjia që sot janë pranë Fakultetit të Mjeksisë dhe atij Ekonomik përkatësisht. Gjithashtu në vitet '80 hapet edhe dega e Informatikës.

Me rritjen e FSHN kemi dhe ngritjen e strukturave të reja pranë tij si Qendra e Matematikës Llogaritëse 1971, Instituti i Fizikës Bërthamore 1970, Kopështi Botanik 1971, Muzeu i Shkencave të Natyrës si edhe 3 Qendra të Kualifikimit të Mësuesve, të matematikës, fizikës dhe biologji-kimisë.

Gjthashtu zgjerimi i fushave të kërkimit shkencor çoi në ndarjen e katedrave mëmë në katedra të reja me fusha studimi të reja. Në vitin 1984 në FSHN funksiononin 12 katedra. Pranë tyre funksiononin disa sektorë shkencorë dhe mjaft laboratore. Afatet e studimit janë 4 dhe 5 vjet. Deri në 1984 kanë kryer studimet në FSHN mbi 5000 specialistë. Në vitet '90 FSHN organizohet në 7 Departamente: Departamenti i Matematikës, Biologjisë, Farmacisë, Fizikës, Informatikës, Kimisë së Përgjithshme, Kimisë Industriale dhe Inxhinierike, 8 njësi mësimore shkencore dhe 18 seksione. Në 2007 krijohet edhe Departamenti i Bioteknologjisë, dhe në vitin 2014 u krijua Departamenti i Matematikës së Aplikuar.

FSHN jepte 10 diploma universitare: 2 në Matematikë (Mësues i Matematikës për shkollën e mesme dhe Matematikan), 2 në Fizikë (Mësues i Fizikës për shkollën e mesme dhe Fizikant), 2 në Biologji (Mësues i Biologjisë për shkollën e mesme dhe Biolog, 3 në Kimi (Kimist industrial, Kimist Ushqimor, Kimist i përgjithshëm) dhe 1 në Informatikë. FSHN organizonte dhe drejtonte edhe studimet pas universitare si për diplomat Master në fushat përkatëse ashtu dhe për gradat Kandidat i Shkencave fillimisht dhe më pas Doktor i Shkencave.

Me nënshkrimin e Deklaratës së Bolonjës nga Shqipëria edhe në FSHN filloi puna për riorganizimin e studimeve në përputhje me procesin e Bolonjës.

Filloi organizimi i studimeve në cikle dhe filluan të jepeshin diplomat e para për ciklin e parë të studimeve (3 vjeçare).

Pas miratimit të Ligjit të ri të Arsimit të Lartë, 2007 FSHN riorganizoi programet e studimeve të ciklit të parë dhe hapi programe studimi të ciklit të dytë dhe të tretë. Gjithashtu ai u ristrukturua dhe institucionalisht me ardhjen në FSHN të Instituteve të Akademisë së Shkencave.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore në fushën e shkencave të natyrës (Biologji, Fizikë, Informatikë, Kimi, Matematikë) duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare të Fakultetit

FSHN në përputhje me objektivat e Universitetit të Tiranës, synon arsimimin e lartë të studentëve vendas e më gjerë, studimet dhe specializimet e mëtejshme, kërkimet shkencore dhe veprimtaritë mbështetëse në fushat e shkencave të natyrës.

Misioni i FSHN është përgatitja e individëve të kualifikuar në fushat e shkencave natyrore dhe mësimdhënies së tyre duke krijuar, zhvilluar dhe transmetuar njohuritë nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke kultivuar lirinë dhe diversitetin e ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike.

Përçimi tek studentët i njohurive të nivelit bashkëkohor universitar, të përditësuara këto në fushat e shkencave të natyrës, i pajisin ata me njohuri të cilat u japin mundësinë për të vazhduar studimet e thelluara në disiplinat e shkencave të natyrës, brenda ose jashtë vendit ose të dalin në tregun e punës si specialistë të kualifikuar.

Organizimi

Departamentet

- Departamenti i Biologjisë
- Departamenti i Bioteknologjisë
- Departamenti i Informatikës
- Departamenti i Kimisë
- Departamenti i Kimisë Industriale
- Departamenti i Matematikës
- Departamenti i Matematikës së Aplikuar
- Departamenti i Fizikës
- Qendra Kërkimore e Florës dhe Faunës

Fakulteti është organizuar në një strukturë hierarkike, e ndarë në tre nivele kryesore: Dekani, zv. Dekanët dhe Drejtuesit e Departamenteve.

Fakulteti ofron programet Bachelor, Master shkencor dhe profesional²⁰ si dhe Doktoraturë²¹.

Programet e studimit të ciklit të parë

²⁰ Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".

²¹ Ligjit 80/2015 "Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH", i përfundojnë ato sipas kriterëve dhe modaliteteve të legjislacionit të kohës që janë pranuar.

- Bachelor në "Inxhinieri Matematike dhe Informatike"
- Bachelor në "Biologji"
- Bachelor në "Bioteknologji"
- Bachelor në "Fizikë"
- Bachelor në "Informatikë"
- Bachelor në "Kimi dhe Teknologji Ushqimore"
- Bachelor në "Kimi Industriale e Mjedisore"
- Bachelor në "Kimi"
- Bachelor në "Matematikë"
- Bachelor në "Teknologji Informacioni dhe komunikimi"

Programet e studimit të ciklit të dytë

- Master i Shkencave në "Biologji Mjedisore"
- Master i Shkencave në "Biologji Molekulare"
- Master i Shkencave në "Biologji", me profil "Mësues biologjie për arsimin e mesëm dhe të lartë"
- Master i Shkencave në "Bioteknologji Molekulare dhe Industriale"
- Master i Shkencave në "Fizikë"
- Master i Shkencave në "Fizikë", me profil "Mësues Fizike për arsimin e mesëm dhe të lartë"
- Master i Shkencave në "Informatikë"
- Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni"
- Master i Shkencave në "Inxhinieri Matematike dhe Informatike"
- Master i Shkencave në "Inxhinieria e Proceseve Kimike"
- Master i Shkencave në "Kimi Industriale dhe Mjedisore"
- Master i Shkencave në "Kimi"
- Master i Shkencave në "Kimi", me profil "Mësues Kimie për arsimin e mesëm dhe të lartë"
- Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"
- Master i Shkencave në "Informatikë", me profil "Mësues Informatike për arsimin e mesëm dhe të lartë"
- Master Profesional në "Bioteknologji Mjedisore"
- Master Profesional në "Informatikë Biznesi"
- Master Profesional në "Teknologji Informacioni"
- Master Profesional në "Inxhinieri Matematike dhe Informatike"

Programet e studimit të ciklit të tretë

- Doktoraturë në Biologji molekulare
- Doktoraturë në Biologjia e ruajtjes
- Doktoraturë në Bioteknologji bimore

- Doktoraturë në Fizikë
- Doktoraturë në Informatikë
- Doktoraturë në Analizë kimike e lëndës dhe mjedisit
- Doktoraturë në Elektrokimi e zbatuar dhe dukuritë sipërfaqesore
- Doktoraturë në Proceset e trajtimit kimik të këndëve të para natyrore dhe të mbeturinave urbane
- Doktoraturë në Teknologjia dhe mikrobiologjia e ushqimeve dhe vlerësimi i sigurisë dhe cilësisë
- Doktoraturë në Analizë dhe algjebër
- Doktoraturë në Metodat probabilitare, statistikore dhe metodat e analizës numerike

5.5.1 Shpërndarja e studentëve

Përqindjen më të lartë të të intervistuarve e përbëjnë studentët me origjinë nga Tirana, Fieri dhe Durrësi. Qarqet e tjera kanë një përqindje më të ulët të të intervistuarve. Gjithsesi mbas përfundimit të studimeve një përqindje domethënëse kthehet në qarkun origjinë, kjo pozicionuar në diagonalen kryesore të ndërthurjes së qarkut të lindjes dhe qarkut që janë aktualisht duke jetuar. Një përqindje e konsiderueshme vazhdojnë qëndrimin në Tiranë.




Figura 5.5.1.1. Qarku lindjes_FSHN

Ashtu siç është cituar edhe në shpjegimet e më sipër, vëmë re se edhe për studentët e diplomuar në FSHN është evident i njëjti projeksin, sipas të cilit ka një trend që studentët e diplomuar të qëndrojnë në Tiranë, pavarësisht vendit të origjinës.

Tabela 5.5.1.1 Qarku ku jetojnë_FSHN

Qarku	Përqindja
NA	1.6
Dibër	.8
Durrës	3.3
Elbasan	2.5
Fier	7.4
Gjirokastrë	.8
Jashtë Vendi	2.5
Lezhë	1.6
Tiranë	78.7
Vlorë	.8

Nga të dhënat e studentëve të intervistuar, ata që kanë përfunduar studimet 4 vitet e fundit, rreth 79% e studentëve që kanë përfunduar studimet në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, qëndrojnë në Tiranë meqenëse ofron më shumë mundësi për punësim.

Vihet re se pothuajse të gjithë studentët qëndrojnë në Tiranë pas diplomimit, por në këtë periudhë studimi vihet re një rritje e përqindjes së studentëve të cilët largohen nga vendi.

Tabela 5.5.1.2. Shpërndarja gjeografike e studentëve sipas qarkut origjinë_FSHN

Qarku origjinë	% e të qëndruarëve në Tiranë	Te larguarit jashtë vendit	Te qëndruarit në Tiranë sipas qarqeve
Dibër	73	0.07	0.11
Durrës	0.6	0	0.03
Elbasan	57	0	4.2
Fier	59	0	61
Gjirokastrë	69	7.7	9.3

Jashtë Vendi	75	25	3.1
Lezhë	67	0	2.08
Tiranë	96	0	25
Vlorë	87.5	0	0.07

Studentët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës gjejnë mundësi punësimi më shumë duke qëndruar në Tiranë.

Një pjesë e studentëve punësohen gjatë studimeve (24%), një përqindje e tyre kanë qënë të punësuar gjatë studimeve dhe vazhdojnë të jenë akoma (30%). Rreth (27%) e studentëve punësohen mbasi mbarojnë studimet.

Tabela 5.5.1.3. Studentët sipas fushës së studimit_FSHN

Programi studimit	% e studentëve të intervistuar	Numri studentëve të diplomuar
CIKLI I DYTE I STUDIMEVE		
Msc Biologji Mjedisore	5.4	55
Msc Biologji Molekulare	8.8	61
Msc Bioteknologji Molekulare dhe Industriale	2.0	129
Msc Fizikë	3.4	37
Msc Informatikë	9.5	200
MP Informatikë Biznesi	3.4	307
Msc Inxhinieria e Proceseve Kimike	4.1	109
Msc Kimi Industriale e Mjedisore	4.7	133
Msc Kimi me profil: Analiza Kimike dhe Vetitë e Lëndës	2.0	83
Msc Matematikë	8.8	44
Msc Mësues Biologjie për Arsimin e Mesëm të Lartë	8.8	255
Msc Mësues Fizike për Arsimin e Mesëm të Lartë	1.4	96
Msc Mësues informatike për arsimin e mesëm të lartë	.7	0
Msc Mësues Kimie për Arsimin e Mesëm të Lartë	1.4	139
Msc Mësues Matematike për Arsimin e Mesëm të Lartë	4.1	250
MP Inxhinieri Matematike dhe Informatike	2.7	73
MP Teknologji Informacioni	2.7	164
Msc Inxhinieri Matematike dhe Informatike	12.2	85
Msc Teknologji Informacioni	6.1	93
Msc Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore	5.4	167
CIKLI I TRETE I STUDIMEVE		
Biologji Molekulare	.7	
Bioteknologji Bimore	.7	

Informatikë	1.4
Gjithsej	100.0

Përqindja më e lartë e të intervistuarve është në Ciklin e Dytë të studimeve, ndërsa në Ciklin e Tretë të studimeve përfaqësimi është më i moderuar, e cila vjen për arsye të ndryshme, ndër të cilat pezullimi i regjistrimeve në Doktoratura etj.

Siç shihet edhe nga rezultatet e përftuara nga pyetësi përqindja më e lartë e të intervistuarve është në programet e mëposhtme:

- Msc Inxhinieri Matematike dhe Informatike 12.2%
- Msc Informatikë 9.5%
- Msc Biologji Molekulare 8.8%
- Msc Mësues Biologjie për Arsimin e Mesëm të Lartë 8.8%
- Msc Matematikë 8.8%

Përqindjet e mësipërme nuk janë në përpjesëtim të drejtë me numrin e të diplomuarve për secilin nga programet e studimit. Përqindja e lartë 12.2% e Msc IMI justifikohet nga puna e filluar në 2016 nga departamenti që e ofron në kuadër të projektit AKMA 2016.

5.5.2 Punësimi studentëve

Aftësitë që përfitojnë studentët në Fakultetin e Shkencave të Natyrës ju jep mundësinë që një një pjesë e tyre të fillojnë studimet që gjatë periudhës që janë akoma studentë (27%), një përqindje e konsiderueshme (20%) kanë filluar punë vetëm pas studimeve.




Figura 5.5.2.1. Koha e punësimit të studentëve_FSHN

Një përqindje e konsiderueshme janë aktualisht të punësuar dhe rreth 71% rezultojnë të jenë të punësuar.

Tabela 5.5.2.1. Punësimi_FSHN

	A jeni i punësuar?	A keni punuar ndonjëherë?
Jo	70.5	86.9
Po	29.5	13.1

Përqindja e të punësuarve është më e lartë në vitin e fundit, ka një ekstremum minimal në vitin 2020, i cili ka një justifikim sapo ka qenë një vit i mbyllur për shkak të pandemisë globale. ata që e kanë përfunduar shkollën në vitet e mëparshme dhe bie disi ndër vite. Kjo tregon që aktualisht të diplomuarit janë përshtatur mirë në tregun e punës dhe ekperiencia është një prej kërkesave kryesore

të punëdhënësve. Tendencat e tregut tregojnë që ata që përfundojnë Fakultetin e Shkencave të Natyrës kanë treg të konsiderueshëm pune mbi 50%.

Tabela 5.5.2.2. Punësimi sipas viteve_FSHN

Viti i diplomimit	A jeni i punësuar?		A keni punuar ndonjëherë?	
	Po	Jo	Po	Jo
2018	18.00	1.6	18.9	0.08
2019	12.3	0.8	10.7	2.5
2020	4.9	4.1	8.2	0.08
2021	35.2	23.0	49.2	9.0

Rezultatet e cituara më poshtë vijnë nga një pyetje e hapur që u është lënë të anketuarve, mbi arsyet e mos përfshirjes në tregun e punës. Njohja e këtyre arsyeve duhet të orientojë strategjitë e bashkëpunimit midis fakultetit dhe punëdhënësve në lidhje me kërkesës priorotare të eksperiencës dhe përshtatjes së oraveve nga të dy palët.

Tabela 5.5.2.3. Arsyet e mos përfshirjes në tregun e punës

Arsyet e mos gjetjes së punës

- I jam përkushtuar shkollës
- Jo e kënaqur me ofertat
- Ngarkesa e studimeve për të marrë rezultate të larta
- Nuk i kane pranuar aplikimet e bera
- S'kam gjetur pune ne profesion/jo në profesion/ punen e përshtatshme
- Nuk kam pasur mundësi për shkak të ndjekjes së studimeve dhe në cdo vend ku aplikoj kërkesa e vetme ishte eksperiencia e punës dhe/ose fakti që isha në shkollë dhe nuk e kisha përfunduar atë.
- Orare jo të përshtatshme/jo kohë për studimet/studimet me kohë të plotë
- Per t'u angazhuar maksimalisht në shkollë
- Përkushtim i plotë i programit studimor ,prioritet

5.5.3 Sektori punësimi

Sektori privat mbetet më tërheqës (54%) për të studentët që përfundojnë Fakultetin e Shkencave të Natyrës, por një përqindje të ndjeshme ka edhe sektori shtetëror 20%. Kjo përqindje qëndron e lartë në të gjithë vitet e diplomomit.




Figura5.5.3.1. Sektori punësimit_FSHN

Sektorët e punësimit ndër vite ndryshojnë ndjeshëm. Në vitin 2018 mbizotëron sektori shtetëror, i cili në vitet në vazhdim humbet ndikueshmërinë e madhe që kishte në 2018 duke u rritur sektori privat me 35% në vitin 2021 si edhe ai i të vetëpunësuar.





Figura 5.5.3.2. Sektorët e punësimit sipas vitit

Nga grafiku i mëposhtëm vihet re që përqindja e të punësuarve me kohë të plotë është rreth 60%, krahasuar me atë me kohë të pjesshme 30%.

Figura 4. Statusi punësimit për studentët e diplomuar në FSHN



Studentët në punësimet e tyre të mëparshme ose gjatë studimeve nuk kanë qenë direkt të përfshirë në profesione që lidhen me fushën e tyre të studimit. Për këtë arsye edhe përqindja e studentëve që kanë qenë të përfshirë në punësime që kërkojnë aftësi (komunikuese, gjuhë të huaj, etj) ka qenë më e lartë (Tabela 8). Dy fushat që kanë tregues më të lartë punësimi janë IT/Programues me 10.14% dhe Call center me 8.11%.

Tabela 5.5.3.1. Profesioni në punë të angazhuara më parë_FSHN

Profesioni mëparshëm	Përqindja
Mësues	6.76
Menaxher	3.38
Pedagog	2.70
IT/Programues	10.14
Shitës	2.70
Analist të dhënash	4.05
Call center	8.11

No work	47.30
Other	14.86
Gjithsej	100.0

Krahasuar më situatën në punësimin aktual, në punësimet e mëparshme ruhet e njëjta prirje e punësimit në shtet në raport me atë privat.




Figura 5 5.5.3.4. Sektori punësimit në punë të mëparshme_FSHN

Në punët e mëparshme studentët kanë pasur një punë më së shumti me kohë të pjesshme. Aktualisht përqindja e të punësuarve me kohë të plotë ka pësuar rritje të ndjeshme.




Figura . Koha e punësimit_FSHN

5.5.4 Përshtatja e aftësive me kërkesat e tregut

Të diplomuarit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës kryesisht punësohen si IT, Mësues, Pedagogë apo specialistë në fusha të ndryshme. Kjo tregon që studentët përfshihen në tregun e punës, me përputhje me fushën e studimit për të cilën janë diplomuar.

Megjithatë duhet theksuar që rreth 50% e të anketuarve janë pa punë dhe kjo është një shifër shqetësuese. FSHN ofron pesë programe studimi që diplomohen “Mësues” Biologjie, Kimie, Matematike, Fizike dhe Informatikë për Arsimin e Mesëm të Lartë, që është një prej profesioneve të rregulluara, por pavarësisht kësaj nga pyetjet e hapura në të cilat të diplomuarit kanë shprehur mendimet e tyre nuk shprehen pozitiv ndaj skemës së punësimit, madje e gjejnë gjithnjë e më të vështirë. Mos vallë kemi ngopje të tregut në këto profile?

Tabela 5.5.4.1. Punësimi sipas profesioneve_FSHN

Profesion	Përqindja
IT	14.19
Lektor/Pedagog	14.86
Biolog	4.05
Menaxher	2.70

Mësues	7.43
Specialist	2.03
Call center/operator	6.76
Shitës	3.38
Jo të punësuar	31.76
Të tjera	12.84
Gjithsej	100.00

Duke marrë një shkallë nga 1 në 10, vlerësuar sipas vlerësimit me nota, ku 1- nuk u ka ndihmuar dhe 10- ju ka ndihmuar shumë, studentët janë shprehur që diploma ju ka vlejtur për gjetjen e një pune. Kjo vihet re nga një vlerësim në vite rreth shkallës 6. Duke marrë parasysh të njëjtin klasifikim në nivelin nga 1 në 10 mbi formimin e marrë në universitet në performancën e punës, studentët gjithashtu shprehen me një nivel mesatar mbi 6 të të gjithë studentëve të diplomuar në vite. Ky nivel qëndron nën nivelin e gjetjes së punës për studentët e diplomuar ndër vite përveç vitit 2020.




Figura 5.5.4.1. Diploma për gjetjen e një pune dhe performancës_FSHN

Mendohet që nota mesatare, dega apo njohjet influencojnë në gjetjen e një pune dhe ecurinë dhe përshtatjen e mëtijshme në tregun e punës.

Përveçse shkallës mesatare, po të shohim klasifikimin në nivele, vihet re një rritje e përqindjeve drejt niveleve të larta të vlerësimit për faktin se si formimi dhe njohuritë universitare ndikojnë në performancën e punës.




Figura 6. Ndikimi i formimit në universitet në performancën në punë_FSHN

5.5.5 Promotorët për tregun e punës

Mënyrat dhe format e gjetjes së një pune janë të ndryshme. Ndodh që ashtu sikurse janë shprehur një sërë studentësh, aplikimet në internet, kërkimet që kanë bërë individualisht në internet janë bërë shkak për gjetjen e një pune. Gjithsesi janë edhe burime të tjera që zënë ndoshta një peshë më të madhe për momentin për përfshirjen në tregun e punës.

Shokët, miqtë apo të njohurit zënë peshën kryesore në gjetjen e një pune (**35%**). Disa shprehen që kanë qenë familjarët (**19%**) dhe shumë pak janë nga pedagogë/pushtetarët, zyra e karrierës apo dhe aplikimet në zyrën e punës.




Figura 7. Influencuesit në gjetjen e punës_FSHN

5.5.6 Zhvillimi aftësive në përshtatje me specializimin në tregun e punës

Sikurse vihet re edhe më lart studentët që kanë përfunduar studimet në vitin 2014 janë disi më të stabilizuar në tregun e punës duke punuar me kohë të plotë dhe duke pasur një përqindje më të lartë të punësimit të tyre.

Përveçse aftësive të fituara në shkollë, një pjesë e aftësive perfeksionohen nëpërmjet praktikave paraprake apo dhe trajnime të ndryshme që kryhen në tregun e punës.

*A keni kryer praktikë profesionale në programin e studimit që keni ndjekur? Vlerëso me një notë nga 1 - 10 **

*Gjatë periudhës së punësimit, a keni kryer trajnime në funksion të pozicionit të punës që keni patur? **

Nga një studim i vitit 2015 i bërë nga BE rezulton se punëdhënësit shpesh zbulojnë se aftësitë që u janë dhënë të diplomuarve nga IAL-te janë të pamjaftueshme dhe nevojitet trajnim i mëtejshëm. Ndaj shpesh, sidomos punëdhënësit në industritë HiTech dhe punëdhënësit e huaj ofrojnë trajnime shtesë për të diplomuarit e rinj të rekrutuar. Punëdhënësit i vlerësojnë si relativisht të dobëta dhe/ose

me boshllëqe aftësitë ndërvepruese të të diplomuarve të rinj, siç janë aftësitë e vendimmarrjes, aftësitë analitike, aftësitë e punës në ekip dhe aftësitë planifikuese dhe organizative. Ky opinion mbështetet edhe nga rezultatet e përfitura nga pyetësi, sipas të cilit rreth 40% e të anketuarve kanë kryer trajnime profesionale.




Figura 8. Kryerja e trajnimeve në funksion të pozicionit të punës_FSHN

Vendi i punës ofron trajnime dhe kualifikime për stafin. Ndër të intervistuarit, më shumë nuk kanë kryer trajnime në vendin e punës(43%) dhe (38%) i shprehen pozitivisht pyetjes. Kjo tregon që ato janë përshtatur pozicionit të punës.

Rreth 54% e studentëve nuk kanë kryer praktikë mësimore. Gjithsesi një përqindje e konsiderueshme (rreth 20%) e kanë kryer praktikën dhe e vlerësojnë me një note 7 ose më shumë duke e konsideruar si shumë të vlefshme.

Kryerja e praktikës mësimore është një proces që i njeh studentët me tregun e punës dhe i përgatit ata mbi mundësitë dhe aftësitë e punësimit. Në pyetje e hapura rreth 70% e të anketuarve janë përgjigjur që gjatë programit të studimit duhet të kenë edhe “Praktikë profesionale”, e cila përveç përfitimit metodologjik, i njeh ato me tregun e punës.




Figura 9. Kryerja e praktikës mësimore_FSHN

Një ndër sugjerimet e dhëna nga një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve është ndryshimi i raportit midis teorisë dhe praktikës, sidomos në disiplonat e programimit në fushën e IT, nevoja për kryerjen e laboratoreve, nënshkrimi i marrëveshjeve me institucione shtetërore ose kompani private për të kryer Intership-e si dhe përdorimi i literaturave më bashkohore.

Target grupi i anketuar “të diplomuarit” është interesant të studiohet dhe prej tyre të hartohen strategji për përmirësimin e mëtejshëm të procesit mësimor në universitet, për arsyet e mëposhtme:

- Janë në moshë madhore dhe arsyetimi i tyre është më i pjekur se i studentëve që aktualisht ndjekin studimet universitare.
- Kanë përballuar sfidat e para që ofron sektori i punësimit dhe për pasojë ndiejnë se cilat janë deficitet e përftura nga formimi i tyre universitar.

5.6 Fakulteti i Shkencave Sociale

Historiku

Fakulteti i Shkencave Sociale, pjesë e Universitetit të Tiranës, daton në vitin 1992.²² Ai ishte rezultat i zhvillimeve që pasuan ndryshimet demokratike të shoqërisë shqiptare në fillimin e viteve '90-të, kur doli si një imperativ i kohës përgatitja e profesionistëve në fushën e politikave dhe shërbimeve sociale, sociologjisë dhe psikologjisë, specialitete këto të munguara deri atëherë. Hapi i parë në këtë drejtim ishte hapja në vitin 1992 e Fakultetit të Shkencave Sociale, falë një bashkëpunimi me Universitetin Grand Valley State i Miçiganit, SHBA, me degën "Punë Sociale".²³

Fakulteti një vit më vonë u shtua me degën e Filozofi-Sociologjisë e më pas me degët e tjera të shkencave sociale. Me kalimin e viteve, Fakulteti i Shkencave Sociale u rrit, si në cilësinë e stafit, ashtu edhe në larminë e specialistëve që ai diplomon. Kështu, në vitin 1996 u hap dega e Psikologjisë dhe në vitin 2000 u hap dega e Shkencave Politike. Në vitin 2009 u krijuan departamentet e veçanta të Sociologjisë, Filozofisë dhe Shkencave Politike. Fakulteti ka 5 departamente, si dhe 3,290 studentë në të gjitha ciklet e studimit gjatë vitit akademik 2017-2018.

Fakulteti i Shkencave Sociale gjatë veprimtarisë së tij ka mision parësor përmbushjen e tre detyrimeve themelore që janë:

- Realizimi i procesit të mësimdhënies në auditor sipas standardeve bashkëkohore të zonës evropiane të arsimit të lartë.
- Nxitjen dhe realizimin e kërkimit shkencor në ndihmë të zhvillimeve të politikave sociale dhe humane të shoqërisë shqiptare.
- Nxitjen e mendimit kritik dhe krijues me qëllim zhvillimin e frymës së qytetarisë demokratike

²² Fillesa më të hershme të shkencave sociale në Universitetin e Tiranës shkojnë mbrapa në kohë që në vitin 1965, ku Fakulteti i Drejtësisë, u riorganizua dhe u quajt "Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike", ku u përfshinë dega e Shkencave Politike dhe ajo e Drejtësisë.

²³ VKM Nr. 348 dt. 10.08.1992.

Përmbushja e këtij misioni realizohet nëpërmjet arritjes së qëllimit kryesor të veprimtarisë së Fakultetit të Shkencave Sociale, që është përgatitja e specialistëve të rinj të fushave sociale me standard profesional, të aftë për t'u integruar në tregun evropian të shërbimeve sociale dhe humane. Arritja e këtij qëllimi realizohet në Fakultetin e Shkencave Sociale nëpërmjet përmbushjes së objektivave të tij parësore, që janë:

- Standarde të larta në procesin e mësimdhënies
- Adoptimin e kërkimit shkencor si pjesë e punës së stafit akademik
- Realizimin e studimeve me rëndësi kombëtare në disiplinat sociale dhe humane
- Pjesëmarrjen në studime rajonale mbi hartimin e politikave sociale integruese me rajonin
- Kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik nëpërmjet hapjes së programeve të reja të studimit në të gjitha ciklet e shkollimit universitar
- Ofrimin e mundësive për një arsim të specialistëve në fushat sociale për gjatë gjithë jetës
- Nxitjen e studimeve krahasuese dhe aplikative me ndikim mbi nxitjen e zhvillimeve ekonomike të vendit
- Dhënien e kontributeve për rritjen e standardeve demokratike të shoqërisë shqiptare
- Trajnimin me standarde bashkëkohore të studentëve në fushën e shkencave sociale dhe humane
- Rritjen e pjesëmarrjes së studentëve të fushave sociale në programe kërkimi kombëtare dhe rajonale
- Ndërmarrjen e punimeve shkencore teorike dhe aplikative me një numër të madh studentësh
- Rritjen e peshës së kualifikimit shkencor pasuniversitar
- Krijimin e një hapësire publike universitare që karakterizohet nga debati i lirë, serioz dhe me përkushtim ndaj të mirës publike.

Për realizimin e këtyre objektivave, Fakulteti i Shkencave Sociale ka një strategji afatgjatë të zhvillimit. Strategjia afatgjatë e Fakultetit të Shkencave Sociale, 2014-2020, fokusohet tek thellimi i mendimit kritik dhe konsolidimi dhe ekuivalentimi i programeve të studimit sipas kërkesave dhe standardeve evropiane. Kjo arrihet nëpërmjet:

- Hapjes së një numri programesh të reja studimi në të gjitha ciklet e shkollimit në arsimin e lartë shqiptar;
- Kualifikimit të vazhdueshëm të specialistëve në fushën sociale;

- Konsolidimit të profesioneve të reja në fushën e shkencave sociale;
- Zhvillimit të lëndëve që kultivojnë përdorimin kritik të intelektit.

Fakulteti, bazuar në sistemin e Bolonjës, ofron programe studimi në të tre ciklet: Bachelor, Master dhe Doktoraturë. Ai ka një staf të kualifikuar në disa prej universiteteve më të mira në SHBA dhe Evropë. Fakulteti i Shkencave Sociale ka 5 departamente të cilat janë:

- Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale
- Departamenti i Sociologjisë
- Departamenti i Filozofisë
- Departamenti i Psikologji-Pedagogjisë
- Departamenti i Shkencave Politike

Fakulteti ka partneritet me një sërë institucionesh për kryerjen e praktikave mësimore të studentëve apo për punësimin e tyre. Gjithashtu qendra e karrierës e vendosur në tri vitet e fundit synon të orientojë dhe lehtësojë kalinim e studentëve drejt tregut të punës. Fakulteti ofron edhe bibliotekën dhe mjediset e saj për studentët e programeve të tij.

Fakulteti i Shkencave Sociale ofron larmi të fushave studimore në nivel bachelor, në mastera shkencorë dhe profesionalë, si dhe nivel studimesh doktorale për thellime njohurish në punë kërkimore shkencore në fushat bazë studimore. Tabela e mëposhtme përmbledh programet e studimit të ofruara në Fakultetin e Shkencave Sociale në të tri këto nivele:

Tabela 6.1. Programet e studimeve sipas fushave dhe niveleve Bachelor, Master, Doktoratë

Emërtimi i njësisë	Niveli i studimeve	Emërtimi i programit
Departamenti i Filozofisë	Studime të Ciklit të I-rë	Bachelor në “Filozofi”
	Studime të Ciklit të II-të	Programet e studimit Master Shkencor • Master i Shkencave në “Filozofi Sociale”; • Master i Shkencave në “Etika në institucione dhe lidhshmëri”. Programet e studimit Master Profesional • Masteri Profesional në “Filozofi praktike dhe humane”
	Studime të Ciklit të III-të	Studime Doktorale në Filozofi

Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë	Studime të Ciklit të I-rë	Bachelor në “Psikologji”
	Studime të Ciklit të II-të	Programet e studimit Master Shkencor • Master i shkencave në “Psikolog klinik” • Master i shkencave në “Psikologji shkollore” • Master i shkencave në “Psikologji organizacionale” • Master i shkencave në “Politika dhe drejtim arsimit” • Master i shkencave në “Mësues i shkencave sociale” Programet e studimit Master Profesional • Master profesional “Këshillim psikologjik” • Master profesional “Orientim profesional” • Master profesional “Pedagogji e specializuar sociale”
	Studime të Ciklit të III-të	• Doktoraturë në Psikologji • Doktoraturë në Pedagogji
Departamenti i Punës dhe Politikë Sociale	Studime të Ciklit të I-rë	• Bachelor në “Punë sociale” • Bachelor në “Administrim dhe politikë sociale”
	Studime të Ciklit të II-të	Programet e studimit Master Shkencor • Master i shkencave në “Përkatësi gjinore dhe zhvillim” • Master i shkencave “Punë sociale” me drejtime: klinik, politikë sociale dhe organizim komunitar • Master i shkencave në “Shërbimet sociale në drejtësinë penale” • Master i shkencave në “Çështje të fëmijës dhe familjes” • Master i shkencave “Administrim i shërbimeve sociale” • Master i shkencave në “Komunikim për ndryshimin social dhe të sjelljes” Programet e studimit Master Profesional • Master profesional “Analist i politikës sociale” • Master profesional në « Punë sociale të avancuar »
	Studime të Ciklit të III-të	Studime doktorale në Punë Sociale
Departamenti i Sociologjisë	Studime të Ciklit të I-rë	Bachelor në sociologji
	Studime të Ciklit të II-të	Programet e studimit Master Shkencor • Master shkencor “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” • Master shkencor “Mësuesi në shkencat sociale për arsimin e mesëm të lartë”²⁴. Programet e studimit Master Profesional

²⁴ Në bashkëpunim me departamentin e Pedagogjisë dhe Psikologjisë, Departamentin e Filozofisë dhe Departamentin e Menaxhimit.

		Master profesional “Administrim i institucioneve sociale në sistemin e drejtësisë”²⁵
	Studime të Ciklit të III-të	Studime doktorale në Sociologji
Departamenti i Shkencave Politike	Studime të Ciklit të I-rë	Bachelor në “Shkenca Politike”
	Studime të Ciklit të II-të	Programet e studimit Master Shkencor - Master i Shkencave në “Teori Politike”; - Master i Shkencave në “Studime Rajonale Politike”.
		Programet e studimit Master Profesional Masteri Profesional në “Qeverisje dhe politikat publike”
	Studime të Ciklit të III-të	Studime Doktorale në “Shkenca Politike”

Për realizimin e këtij pyetësoi dhe kontaktimin e popullatës së synuar, u shtytëzua baza e të dhënave të sekretarisë së fakultetit, e cila përmban të dhëna mbi numrin e aplikimeve, pranimeve, notës mesatare të shkollës së mesme, etj ashtu si edhe listën e kontakteve të studentëve të diplomuar. Bazuar në adresat e e-maileve të lena nga studentet e rregjistruar pranë sekretarisë. Pyetësoi u shpërnda në 1,536 adresa, nga të cilat u përgjigjën 189 prej tyre, duke shënuar një shkallë përgjigjedhënie prej 12.3%. Kjo shkallë përgjigjedhënie është në limitet tipike prej 10-15% në studimet që targetojnë një audiencë të jashtme (siç janë tashmë ish-studentët në raport me universitetin/fakultetin ku kanë studiuar).

5.6.1 Shpërndarja e studentëve

Për Fakultetin e Shkencave Sociale, përqindjen më të lartë të përgjigjedhënësve në këtë studim e përbëjnë studentët me origjinë nga Tirana, me rreth 20 përqind, të pasuar në nivele të ngjashme nga ata nga Kukësi dhe Fieri të cilët janë dominues edhe në rregjistrimet e dy viteve të fundit akademike, 2016-2017, 2017-2018. Dominimi i qarkut të Tiranës theksohet edhe më tepër nëse vërejmë vendbanimin aktual të të anketuarve të diplomuar nga Fakulteti i Shkencave Sociale, ku rreth 80 përqind vijojnë të qëndrojnë në Tiranë edhe pas përfundimit të studimeve.

²⁵ Në bashkëpunim me Departamentin e së Drejtës Penale në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.




Figura 2 Shpërndarja sipas qarkut të lindjes

Tabela 5.6.1.1. Shpërndarja e përgjegjdhënësve sipas vendbanimit aktual

Qarku i Vendbanimit	% e te qendruareve ne Tirane (ne raport me popullsine e qarkut)	Te larguarit jashte vendit	Te qendruarit ne Tirane sipas rretheve
Dibër	0	0	0
Elbasan	0	0	0
Fier	100	0	25
Gjirokastrë	100	0	8.3
Korçë	75	0	25
Kukës	100	0	16.7
Lezhë	100	0	8.3
Tiranë	100	0	16.7

Një panoramë më e plotë e raporteve të kthimit në vendin e origjinës dhe vijimit të qëndrimit në Tiranë, paraqitet në tabelën e mëposhtme. Nga të dhënat e studentëve që kanë marrë pjesë në këtë studim, ata që kanë përfunduar studimet 4 vitet e fundit, kanë preferuar, në pjesën më të madhe të rasteve, të qëndrojnë në Tiranë kundrejt kthimit në vendin e origjinës. Shkallën më të lartë të kthimit e shënon qarku i Lezhës, ndërkohë që thuajse të gjithë përgjegjdhënësit me origjinë nga Gjirokastra

apo Dibra kanë zgjedhur të qëndrojnë në Tiranë. Jashtë vendi shfaqen të jenë larguar një pjesë e vogël e studentëve me origjinë nga Berati, Elbasani dhe Tirana. Me sa duket Tirana (apo edhe afërsia me të) vazhdon të jetë më atraktive për punësim dhe jetesë.

Tabela 5.6.1.2: Shpërndarja gjeografike e studentëve sipas qarkut origjinë

Qarku Origjinë	% e të qëndruarve në Tiranë (ndaj popullsisë së rrethit)	Të larguarit jashtë vendit	Të qëndruarit në Tiranë sipas qarqeve
Berat	50.0%	33.3%	2.5%
Dibër	94.4%	0.0%	10.8%
Durrës	71.4%	0.0%	3.2%
Elbasan	78.6%	33.3%	7.0%
Fier	68.4%	0.0%	8.3%
Gjirokastrë	100.0%	0.0%	7.0%
Korçë	83.3%	0.0%	9.6%
Kukës	88.0%	0.0%	14.0%
Lezhë	58.3%	0.0%	4.5%
Shkodër	90.0%	0.0%	5.7%
Tiranë	94.4%	33.3%	21.7%
Vlorë	75.0%	0.0%	3.8%
Jashtë vendit	100.0%	0.0%	1.9%
Gjithsej	83.1%	100.0%	100.0%

Në interpretimin e këtyre gjetjeve duhet të mbajmë në konsideratë se pjesa më e madhe e përgjigjedhënësve janë studentë/të diplomuar në programe të nivelit të dytë të studimeve (83.3%) dhe një pjesë e konsiderueshme në nivelin doktoral (16.4%).

Tabela 5.6.1.3. Shpërndarja e studentëve të anketuar sipas fushës/programit të studimit

Programi studimit	Perqindja e te anketuareve
Administrim i Shërbimeve Sociale	25.0
Administrimi institucioneve sociale në sistemin e drejtësi	6.3
Analizë e Politikës Sociale	6.3
Filozofi sociale	6.3
Këshillim Psikologjik	12.5
Psikologji, me profil: Psikologji Organizacionale	6.3

Psikologji, me profil: Psikologji Shkollore	6.3
Punë Sociale e Avancuar (2 drejtime)	18.8
Shkenca politike, me profilin "Teoritë politike"	6.3
Studime Rajonale Politike	6.3

5.6.2 Punësimi i studentëve

Njohuritë, aftësitë dhe shprehjet me të cilat i pajisin programet studimore të Fakultetit të Shkencave Sociale duket se i mundësojnë studentëve të diplomuar në këtë fakultet, që në një masë të konsiderueshme prej 44%, të mund të punojnë edhe gjatë periudhës së studimeve. Një pjesë tjetër thuajse e barabartë (13%) me të parën, jo vetëm që fillojnë punën gjatë studimeve, por edhe vazhdojnë ta mbajnë atë edhe pas kryerjes së tyre. Rreth 31% raportojnë të jenë punësuar vetëm pas kryerjes së studimeve. Nga ana tjetër, më pak se 1 në 5 studentë raportojnë të mos kenë arritur ende të punësohen.




Figure 5.6.2.1. Koha e fillimit të punësimit në raport me periudhën e studimeve

Më shumë se gjysma e studentëve që kanë marrë pjesë në këtë vlerësim raportojnë të jenë të punësuar aktualisht dhe mbi 80% e tyre e kanë pasur të paktën një punë deri në momentin e anketimit.

Tabela 5.6.2.1. Situata e punësimit raportuar nga studentët pjesëmarrës në anketim

	A keni punuar ndonjëherë?	A jeni i punësuar aktualisht?
Po	87.5	56.3
Jo	12.5	43.8

Në zbërthimin e situatës së punësimit sipas viteve të diplomimit të përgjigjedhënësve, vihet re se ka një trend të stabilizuar me më shumë se gjysmën e pjesëmarrësve në vlerësim të punësuar aktualisht dhe me më shumë se 80% të tyre të punësuar të paktën një herë (me përjashtim të vitit 2014, ku rezultatet shfaqen ndjeshëm më të ulëta).

Tabela 5.6.2.2. Situata e punësimit sipas viteve të diplomimit të të anketuarve

	A keni punuar ndonjëherë?		A jeni i punësuar aktualisht?	
	Po	Jo	Po	Jo
2018	31.3	0	18.8	12.5
2019	18.8	6.3	12.5	12.5
2020	12.5	0	6.3	6.3
2021	25	6.3	18.8	12.5

Duke mbajtur në konsideratë numrin e lartë të programeve dhe studentëve që studiojnë dhe diplomohen në Fakultetin e Shkencave Sociale, duket se situata e punësimit është mjaft optimiste. Megjithatë, të interesuar për arsyet që mbajnë jashtë tregut të punës një pjesë prej tyre, mësojmë se ato lidhen me faktorë që fillojnë nga dedikimin maksimal në akademi/studime deri tek pretendimi se për gjetjen e një pune duhet të përdorësh lidhjet apo paratë. Tabela e mëposhtme i liston arsyet që kanë përmendur të anketuarit (renditja është rastësore dhe nuk ka ndonjë kuptim në raport me peshën që zënë secila prej arsyeve të dhëna).

Tabela 5.6.2.3. Arsye/pengesa për mospjesëmarrje në tregun e punës.

1.	Duhet paguar ose gjetur mik.
----	------------------------------

2.	Duhet të marr licencën e mesuesit për t'u futur në portal
3.	Fakulteti nuk u interesua për mua dhe unë nuk di ku të drejtohem
4.	Fokusim maksimal në jetën akademike/ Jam përkushtuar në studimet e mia.
5.	Nuk e njohin fare si profesion, përvec OJQ-ve.
6.	Mungesa e eksperiencës në punë
7.	Nuk kam pasur mundësi të gjej një punë që t'i bëj të dyja dhe t'i përshtatet orarit të shkollës.
8.	Nuk kam gjetur punë në profilin tim.
9.	Nuk ofrohet punë për Psikolog Organizacional ose kërkohen punonjës me eksperiencë
10.	Sepse kërkojnë të pamundurën, që një student nuk e ka – eksperiencën.
11.	Si vullnetare po, por me një rrogë, sepse të kërkojnë eksperiencë.
12.	Tregu i punës nuk më jep mundësi të punësohem në profesionin tim të Punes Sociale.

5.6.3 Sektori i punësimit

Dominon një pasiguri apo paqartësi në raportimin e sektorit të punësimit pasi rreth 45% nuk e specifikojnë sektorin në të cilin janë të punësuar. Megjithatë, ndër ata që e cilësojnë sektorin e tyre të punësimit dominon punësimi në sektorin privat (34%) ndërkohë që punësimi në sektorin shtetëror dhe në atë të OJF-ve raportohet në përmasa të ngjashme (11 dhe 9 përqind, respektivisht). Vetëpunësimi është thuajse inekzistent në radhët e profesionistëve të shkencave sociale.




Figura 5.6.3.1. Shpërndarja sipas sektorit të punësimit

Gjithashtu, nga shpërndarja në vite e punësimit sipas sektorëve, vihet re një tendencë në rritje të punësimit në sektorin privat dhe një tkurrje të punësimit në sektorin publik. Punësimi në sektorin e

OJF-ve ka luhatjet më të ndjeshme dhe do duhet të monitorohet në vijimësi për të kuptuar më shumë mbi zhvillimet në të.




Figura 5.6.3.2. Punësimi sipas sektorëve dhe vitit të diplomimit

Punësimi me kohë të plotë mbizotëron ndër ata të cilët janë përgjigjur për këtë pyetje. Vetëm 14% e atyre që raportojnë lidhur me punësimin e tyre, thonë se punojnë me kohë të pjesshme. Stabilizimi i një pune me kohë të plotë duhet të kalojë përmes një procesi stabilizimi në vendin e punës në veçanti apo tregun e punës në përgjithësi. Siç tregohet në shpërndarjen e formës së punësimit, nga punësimi aktual deri tek disa punësime të mëhershme, ka një tendencë të qartë të rritjes së punësimit me kohë të plotë nga punësimi i parë deri tek ai aktual.




Figura 5.6.3.3. Punësimi me kohë të plotë kundrejt atij me kohë të pjesëshme nga punët e mëhershme deri në atë aktuale

Pavarësisht vështirësive për të hyrë dhe qëndruar në tregun e punës, për pjesën më të madhe të përgjigjedhënësve nuk ka dyshim se shkollimi në profesionin që kanë i ka ndihmuar për gjetjen e punës. Diferenca midis atyre që kanë pasur vështirësi dhe atyre që e kanë pasur të lehtë gjetjen e punës, në raport me vlerësimin që kanë për ndikimin pozitiv të studimeve të tyre është me vetëm 3 pikë përqindje.

Tabela 5.6.3.1. Profesion/pozicioni në punë të angazhuara më parë

Nr.	Profesion/pozicioni i mëparshëm i punës	%	Numri
1.	Asistente	4.23	8
2.	Call center/operator	10.05	19
3.	Gazetar	2.12	4
4.	Edukator	1.59	3
5.	Kasier	2.12	4
6.	Menaxher	5.82	11
7.	Mësues	1.59	3
8.	Punonjës social/Psikolog	4.23	8
9.	Shitës	6.35	12
10.	Specialist	3.17	6
11.	Tjetër	18.52	35
12.	NA/pa punë	40.21	76

5.6.4 Përshtatja e aftësive me kërkesat e tregut

Përcaktimet e qarta të përputhshmërisë apo raportit midis profileve të ndryshme të studimit dhe vendeve të punës është një mision sfidues në vendin tonë, në kushtet e mungesës së të dhënave eksplicite që ndjekin raportet kërkesë-ofertë të tregut të punës për secilin profil edukimi në Republikën e Shqipërisë. Megjithatë, duke pasur mundësinë të krahasojmë të dhënat e përfuara nga ky vlerësim midis punësimit të mëparshëm dhe atij aktual verëhet një zhvendosje e lehtë nga pozicionet e punës që nuk lidhen direkt me profilin e edukimit drejt atyre që janë në përputhje me të. Kështu, një rënie në kategorinë e operatorëve të call centers apo shitësve është shoqëruar me një rritje në numrin e të punësuarve si psikologë, punonjës socialë apo mësues. Në një këndvështrim më të gjerë, edhe profesionet/pozicionet e tjera që janë raportuar nga pjesëmarrësit në studim përputhen mjaft mirë me njohuritë, shprehjet dhe aftësitë që oftohen përmes programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave Sociale. Gjithashtu, studimet në këto programe kanë mbështetur edhe karrierat e disave në akademi (p.sh si pedagogë) apo në poste menaxheriale apo drejtuese.

Tabela 5.6.4.1. Punësimi aktual sipas profesioneve

Nr.	Punësimi aktual	%	n
1.	Psikolog	6.35	12
2.	Punonjës Social	1.59	3
3.	Call center/Operator	7.41	14
4.	Shitës	2.65	5
5.	Specialist	5.29	10
6.	Pedagog	1.06	2
7.	Receptionist	2.12	4
8.	Menaxher	4.23	8
9.	Mësues	2.12	4
10.	Shërbim klienti	1.59	3
11.	Drejtor	1.59	3
12.	Tjetër	19.05	36
13.	NA/Pa punë	44.97	85

Do të duhej një ndjekje e trendit në një kohë më të gjatë që të na mundësonte një kuptueshmëri më të plotë të ecursisë së punësimit në profesion të të diplomuarve të shkencave sociale. Megjithatë, kjo situatë i referohet vetëm studentëve përgjegjedhënës që vlerësojnë me një shkallë nga 1 në 10, sipas vlerësimit me nota, ku 1- nuk ka ndihmuar dhe 10- ka ndihmuar shumë, se sa mendojnë se ju ka

vlejtur diploma për gjetjen e një pune. Vlerësime pozitive (pra më një notë kaluese), ndonëse të ulëta, kanë tre nga 4 vitet e përfaqësuara. Pavarësisht kësaj, situata vlerësohet ndjeshëm më pozitive kur studentëve u kërkohet të vlerësojnë impaktin e diplomës së tyre në performancën që kanë në vendin e punës. Këtu, nota është më e lartë se 6 në të gjitha vitet e targetuara nga ky studim. Veçanërisht, përgjigjedhënesit e diplomuar në vitin 2014 (më të hershëm në studim), kanë një vlerësim me notën 8 ose më të lartë. Eksperienca më e gjatë në punë dhe distancimi për gjykimin e vlerës së diplomës në raport me vendin e punës mund të jenë disa nga faktorët që mund të kenë përcaktuar këtë vlerësim më pozitiv prej tyre.




Figura 5.6.4.1.. Vlerësimi i diplomës në raport me gjetjen e punës dhe performancën në të

Vlerësimi mbi ndikimin e formimit universitar dhe pasuniversitar në performancën në punë u zbërthye më tej si në grafikun e mëposhtëm. Më shumë se 90% e të diplomuarve të pyetur e vlerësojnë pozitivisht ndikimin e formimit të tyre në performancën e punës që bëjnë. Përqindjet e atyre që e vlerësojnë me notat me të larta këë ndikim arrijnë pikun pikërisht me ata që e vlerësojnë maksimalisht, të cilët janë më shumë se dyfishi (15.9%) i atyre që mendojnë se diploma nuk u shërben në punën që bëjnë (7.9%).




Figura 5.6.4.2. Vlerësimi i ndikimit të studimeve në performancën në punë

5.6.5 Promotorët për tregun e punës

Mënyrat dhe format e gjetjes së një pune janë diversifikuar ndjeshëm në dekadat e fundit. Pavarësisht kësaj, duket se format më tradicionale dhe informale dominojnë kanalet përmes të cilave të diplomuarit arrijnë të futen në tregun e punës. Më shumë se gjysma e tyre raportojnë që punësimi u është mundësuar përmes ndihmës së miqve/shokëve (36%) apo familjarëve (22%). Qendrat e karrierës apo zyrat e punës konkurrohen fort nga pushtetarët si mënyra e tretë më popullore për gjetjen e një vendi pune me 11% përkundrejt një totali prej 3% që mbledhin qendrat e karrierës dhe zyrat e punë së bashku.




Figura 5.6.5.1. Mundësuesit e gjetjes së punës

5.6.6 Zhvillimi i aftësive në përshtatje me specializimin në tregun e punës

Nga analiza e pësipërme mbi hyrjen dhe qëndrimin në tregun e punës, duket se kalimi i viteve dhe shtimi i eksperiencës në punë i mundëson dhe lehtëson më shumë ato, qofshin kur janë të lidhura drejtpërdrejt me profesionin ose jo. Kjo shkon paralelisht edhe me mundësitë që ofron të qenit i punësuar edhe për kualifikime dhe trajnime në vazhdim/në vendin e punës. Megjithatë, trajnimet në vendin e punës nuk janë ende prezente për shumicën e të pyeturve. Pyetjes, nëse gjatë periudhës së punësimit kanë kryer trajnim në funksion të punës që kanë pasur, i përgjigjen pozitivisht vetëm 37% e përgjigjedhënësve kundrejt 44% që raportojnë të mos jenë trajnuar ndonjëherë në vendin e punës.




Figura 5.6.6.1. Trajnime në funksion të punës

Një pjese të studentëve u lehtësohet vendosja e një lidhje me tregun e punës dhe kualifikimit të mëtijshëm përmes praktikës profesionale, e cila mbetet thelbësore për nga rëndësia, veçanërisht për ata që vendi i punës nuk ua mundëson trajnimin/praktikën në funksion të pozicionit të punës. Nga studentët e Fakultetit të Shkencave sociale rreth 17% raportojnë të mos kenë bërë praktikë mësimore. Ndërkohë, ndër ata që e kanë pasur këtë eksperiencë, më shumë se gjysma kanë një vlerësim më notë 5 ose më lart, dhe pak më shumë se 23% e vlerësojnë maksimalisht praktikën mësimore në raport me formimin e tyre për tregun e punës/vendin e punës.




Figura 5.6.6.2. Vlerësimi me notë për praktikën mësimore

6. Përfundime

1. Në realizimin e punimit, Grupi të punës i është dashur të kapërcejë vështirësi të mëdha që lidhen me mungesën e statistikave që trajtojnë objektin e punimit, me mungesën e studimeve që kanë në fokus këtë objekt, me mungesën e konsolidimit të hallkave brenda strukturës së Universitetit që do të duhet të merreshin me një studim të tillë, me mungesën e përvojës nga ana e anëtarëve të Grupit në realizimin e punimeve të tilla, etj.
2. Universiteti i Tiranës është më i kërkuari nga aplikantët që kërkojnë të vazhdojnë studimet në të gjitha ciklet. Kjo shprehet në numrin e lartë të aplikimeve, e pakrahasueshme me ndonjë Universitet tjetër.
3. Aplikantët që pranohen si studentë në Universitetin e Tiranës, kanë notë më të lartë mesatare sesa studentët e pranuar në Universitete të tjera publike dhe jo-publike. Ky tregues shpreh më së miri nivelin e lartë cilësor të studimeve në Universitetin e Tiranës.
4. Të gjithë studentët që mbarojnë Ciklin e parë vazhdojnë Ciklin e dytë të studimeve. Numri i aplikantëve në programet Master të Universitetit të Tiranës është, gjithashtu, i lartë. Pjesa dërmuese e të pranuarve në këto programe janë studentët që kanë mbaruar programin Bachelor në Universitetin e Tiranës, por ka dhe një pjesë të vogël të të pranuarve që vijnë nga Universitete të tjera publike dhe jo-publike. Kërkesa më e lartë është për programet e Masterit Shkencor. Kjo lidhet, ndër të tjera, edhe me kufizimet që ka vendosur administrata e shërbimit civil për marrjen në punë të specialistëve që kanë përfunduar studimet në programet e Masterit Profesional.
5. Studentët që mbarojnë Ciklin e parë (Bachelor) e kanë tepër të vështirë të gjejnë punë në profesion, sepse quhen, pa të drejtë, të paplotësuar profesionalisht nga ana e punëmarrësve. Kjo mendësi përbën një difekt të madh të sistemit bazuar në marrëveshjen e Bolonjës, difekt i hasur dhe në pjesën dërmuese të vendeve më të zhvilluara. Ndoshta rikthimi i sistemit 4-vjeçar të studimeve do ta shmangte këtë anomali, si dhe një sërë anomalish të tjera që janë shfaqur me kohë gjatë zbatimit të sistemit të mbështetur në Marrëveshjen e Bolonjës.
6. Me përjashtime të vogla, pjesa më e madhe (në disa raste dhe pjesa dërmuese) e studentëve të Universitetit të Tiranës punësohen në sektorin privat. Ky fakt na lejon të konstatojmë preferencën e lartë që sektori privat ka për studentët e Universitetit të Tiranës për shkak të nivelit të tyre të lartë cilësor. Përballimi me sukses i punës në sektorin privat tregon se njohuritë e marra gjatë studimeve

janë të vlefshme dhe përballojnë sfidat e zhvillimit me të cilat përballlet ky sektor. Nga ana tjetër, duke parë shifrat e punësimit në administratën publike, konstatojmë se gati gjysma e të rekrutuarve në Sherbimin Civil, për periudhën 2016-2018, janë të diplomuar në Universitetin e Tiranës. Në dukje është një shifër e lartë, por duke marrë parasysh peshën e Universitetit të Tiranës, cilësinë e studentëve që mbarojnë studimet këtu, shifra lë shumë për të dëshiruar. Sipas përgjigjeve të pyetorit të realizuar nga Grupi i punës, shkak për këtë është konkurenca e padrejtë në procedurat e rekrutimit, influenca politike dhe njohjet nepotike.

7. Studentët vlerësojnë se kurrikulat mësimore duhen pasuruar vazhdimisht, sidomos me aspektet praktike të profesionit, gjë që do të ndihmonte në përafrimin e njohurive të tyre me kërkesat e tregut të punës.

8. Vihet re një lidhje e fortë midis degëve më të kërkuar dhe preferencave të tregut të punës. Studentët që studjojnë në këto degë janë më të favorizuar në tregun e punës.

9. Një aspekt mjaft i rëndësishëm për përgatitjen e përballjes me tregun e punës, që shprehet nga, pothuajse, të gjithë ish-studentët pjesmarrës në pyetsor, është proçesi i organizimit dhe kryerja e praktikave mësimore e profesionale, i cili lë shumë për të dëshiruar. Studentët ankohen se nuk ju krijohen (ofrohen) mundësitë për kryerjen e një praktike me parametrat që kërkon zhvillimi i sotëm.

10. Studentët pjesmarrës në studim vlerësojnë se ndihma që ju jepet nga ana e institucionit ku kanë studjuar është e papërfillshme.

7. Rekomandime

1. Reformimi i arsimit të lartë kërkon rritjen e standardeve të cilësisë dhe lidhje të teorisë me jetën ekonomike e sociale në vend, për të siguruar zhvillim të qendrueshëm bazuar mbi njohuritë bashkëkohore dhe inovacionin. Përfundimet dhe rekomandimet i drejtohen të gjithë aktorëve socialë që, përmes planifikimit të integruar dhe bashkëpunimit, të mundësojnë punësimin e të rinjve të cilët kanë investuar për të arritur një shkallë të lartë kualifikimi në studimet universitare. Është e rëndësishme që politikbërësit, universitetet dhe bizneset të bashkërendojnë veprimtaritë se bashku me organizatat studentore për të garantuar përdorimin efektiv të investimeve të kapitalit njerëzor.
2. Deri tani, në treguesit e zakonshëm të rezultateve në arsim janë analizuar inputet e sistemit, sa studentë kanë hyrë, sa prej të diplomuarve në arsimin e mesëm ndjekin arsimin e lartë, si dhe outputet, sa studentë kanë përfunduar arsimin, sa prej të regjistruarve në IAL janë diplomuar sipas degëve respektive. Rekomandojmë që në indikatorët e matshëm të arsimit të paraqiten edhe rezultatet e punësimit të të diplomuarve. Dihet që arsimi i lartë ka efekte afatgjata në progresin e shoqërisë dhe vështirë të matet impakti i investimit në edukim me tregues sporadikë të punësimit apo të papunësisë së të diplomuarve në një treg kaotik sikurse është tregu shqiptar. Megjithatë ky është një indikator që orienton si përmirësimet në programet universitare ashtu dhe studentët në përzgjedhjen e degëve të studimit.
3. Për të realizuar në të ardhmen studime më të thelluara është e nevojshme konsolidimi i hallkave në strukturën e Universitetit që do të duhet të merren me studimin e tregut të punës (zyrat e karrierës). Përfshirja e specialistëve të statistikave, matematikës, informatikës, ekonomiks, sociologjisë është e domosdoshme për të siguruar një punim cilësor me përfundime e rekomandime të besueshme e të vlefshme.
4. Dinamika e lartë e ndryshimeve në tregun e punës kërkon studime më të shpeshta periodike të këtij tregu në funksion të përshtatjes në kohë të programeve të studimit, të përmirësimit të komunikimit e bashkëpunimit me studentët që kanë mbaruar studimet, të gjetjes së mundësive për të lehtësuar procesin e gjetjes së një pune nga studentët, të lobimit për të propozuar ndryshime në aktet ligjore e nënligjore që do ti ndihmonin përmirësimit të statistikave që duhet të ofrojnë institucionet e specializuara, si dhe rregullimit të tregut të punës, etj.

5. Ngritja dhe konsolidimi i rrjeteve “Alumni” përbën, gjithashtu, domosdoshmëri për të tërhequr në kohë e me cilësi mendimin e vlefshëm të ish studentëve jo vetëm për problematikën në përballjen me tregun e punës, por edhe më gjerë. Prandaj, Departamenteve dhe Zyrave të Karrierës do tju duhet organizojnë punën për të shpeshtuar kontaktet me ish-studentët. Hapi i parë do të ishte përditësimi në vazhdimësi i adresave të komunikimit me ta.

6. Për të siguruar informacion cilësor duhen realizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e specializuara të hartimit e përpunimit të të dhënave që kanë të bëjnë me tregun e punës. Nëpërmjet tyre do të përcaktohet më saktë vendi që ka Universiteti i Tiranës në tregun e punës në raport me IAL-të e tjera dhe do të përcaktoheshin më mirë hapat që do të ndërmerreshin për të zënë një vend sa më preferencial në këtë treg, në kushtet e konkurrencës (të drejtë apo të padrejtë) gjithmonë në rritje.

7. Për të ndihmuar studentët në procesin e gjetjes së një pune (me kohë të pjesshme apo me kohë të plotë), Universiteti, nëpërmjet hallkave përkatëse të tij, do të duhet të bëjë përpjekje për tju ofruar studentëve, në kohë reale, informacionin e nevojshëm për zhvillimet në tregun e punës. Në faqet elektronike të Departamenteve, Fakulteteve dhe Universitetit mund të afishohen adresat e faqeve elektronike të institucioneve publike e private që ofrojnë informacion në lidhje me vendet e lira të punës. Zyrat e karrierës mund të ofrojnë konsulence për të ndihmuar studentët në përballjen e tyre me procedurat e panjohura të kërkimit e gjetjes së një vendi pune.

8. Universitetit do të duhet hartoj dhe realizoj një strategji afatgjatë bashkëpunimi me punë-ofruesit (publikë apo privatë) për tërheqjen e mendimeve dhe sugjerimeve të tyre në përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulave për tju përshtatur më mirë kërkesave të punës. Një pjesë e punë-ofruesve shprehen të pakënaqur me aftësitë e të diplomuarve.

9. Një pjesë e të diplomuarve shprehen se përmirësimi i infrastrukturës mësimore, i metodave të mesimdhënjes, i kualifikimit të stafit kërkues e mësimdhënës, do të ndikonte në rritjen e cilësisë së studentëve duke përmirësuar perspektivat e tyre të punës.

10. Përvoja botërore e dy dekadave të fundit tregon se pjesa dermuese e Universiteteve i kanë kushtuar një rëndësi të madhe konceptimit dhe realizimit të diplomave të përbashkëta për profesione të përafërta ose komplementare, si në nivelin Bachelor ashtu dhe në atë Master. Kjo praktikë është më imediate në vendet e vogla dhe me tregje të vegjël. Diplomat e përbashkëta ndihmojnë të

diplomuarit të rrisin fleksibilitetin për tju përshtatur më mirë tregut të punës. Përvoja e Universitetit të Tiranës ofron shëmbuj optimist në këtë drejtim, prandaj Grupi i punës, mbështetur edhe në ngjetjet e studimit të kryer, rekomandon studimin e mundësive për zgjerimin e realizimit programeve të përbashkëta midis Departamenteve e Fakulteteve të ndryshme.

11. Në një pjesë të Fakulteteve (sidomos të mësuesisë) konstatohet një numër i lartë kërkesash për ndjekjen e një programi të dytë. Grupi i punës mendon se kjo, ndër të tjera, është dhe një shënjë e ngopjes së tregut. Problemi është mjaft i vështirë dhe nuk mund të zgjidhet vetëm nga Universiteti i Tiranës. Grupi i punës mendon se Universiteti i Tiranës duhet ti propozojë Ministrisë së Arsimit dhe sporteve kryerjen e një analize të mirëfilltë të nevojave të tregut për profesione të caktuar dhe hartimin e realizimin e një strategjie e cila mund të përfshijë dhe uljen e nivelit të pranimeve në ato Universitete ku cilesia e studentëve është më e ulët.

12. Një problem i madh mbetet tërheqja e nxënësve më të mirë në studimin e shkencave bazë. Përvoja e 15 viteve të fundit ka treguar përkeqësim të cilësisë së studentëve që aplikojnë dhe pranohen në këto shkenca. Praktikrat e favorizimeve me bursa studimore për të nxitur nxënësit e mirë të aplikojnë në këto degë pothuajse ka dështuar. Nevojitet një strategji më afatgjatë për të stimuluar tërheqjen e më të mirëve në këto degë. Një rrugë do të ishte diferencimi i dukshëm në pagesë i të diplomuarve në këto degë në raport me degët e tjera.

13. Një problem i rëndësishëm që nënvizohet nga të gjithë studentët e përfshirë në studim është organizimi i praktikave mësimore e profesionale. Niveli i organizimit dhe i kryerjes se tyre është larg synimit për të cilin ato janë futur në programet e studimeve. Duhet ndër marrë një operacion i thellë dhe i centralizuar për të gjetur rrugët e duhura të cilat do të bënin të mundur organizimin dhe realizimin e praktikave të vlefshme në funksion të synimeve për të cilat ato kryhen.

14. Reforma e kohëve të fundit në arsim e ka përcaktuar si një nga prioritetet që forcimin e lidhjeve të arsimit me zhvillimet në tregun e punës, duke futur ndër të tjera stimuj për përfshirjen e biznesit në menaxhimin e institucioneve të arsimit, si në nivelet e arsimit të mesëm profesional, ashtu dhe të arsimit të lartë. Kjo kërkon krijimin e mundësive që biznesi dhe aktorët e tjerë të interesuar të marrin pjesë përgjatë të gjithë procesit, që nga hartimi i kurrikulave, mësimdhënie e deri në praktikat profesionale të studentëve.

8. Anekse

Në këtë pjesë janë renditur disa box-e me sugjerime të studentëve të marra nga pyetsorët, të ndara sipas fakulteteve:

Sugjerime të ish-studentëve të FD

- Duhet më shumë trajnime dhe kualifikime. (*specilaist, shtet, Kukes*)
- Përmirësim i kulikulave programeve dhe silabuseve të lëndëve me qëllim që programet ,master të jenë sa më specifike (*Asisten Avokat, Tiranë*)
- Bashkeveprim me studentet, të këtë një komunikim me studentët edhe pas përfundimit të studimeve. (*As.Noter, Tepelene*)
- Kuotat e pranimeve të jenë të ulta . (*Pa punë, Tiranë*)
- Mundesi punesimi me miritokraci per studentet ekselente. (*Asistente,Privat, Tiranë*)
- Ndërlidhja midis fakultetit dhe asaj që kërkohet në tregun e punës. (*Specialist, shtet, Bulqizë*)
- Qendra e Karrieres në bashkëpunim me Departamentet e Fakulteteve të orientojnë dhe ndërmjetësojnë në procesin e ofrimit të intershipeve ose vendeve të punës .lushnjesktori privat (*Jurist,sektori privat, Lushnjë*)
- Universiteti i tiranes te kete me shum bashkepunim me institucionet e tjera qoftë shtetërore e private me qellim punësimin e studenteve dhe për trajnimin e tyre. (*Specialist, shtet, Elbasan*)
- Ëeb dhe LinkedIn (*Auditues, shtet, Tiranë*)
- Përmirësim i praktikave mësimore dhe shtimi i tyre(Specialiste, shtet, Sarande)

Sugjerime të ish-studentëve të FE

- Kurrikul më e orientuar nga praktika dhe më e përditësuar. Sigurimi bashkëpunimit me bizneset për ti marrë si shembull praktik, pasqyruar realitetin dhe duke siguruar edhe vizita të studentëve në kompani për të parë nga ana praktike teorinë (**Kordinatorë departamenti, Tiranë**).
- Sigurimi partneritetit midis universitetit dhe biznesit duke siguruar edhe informimin e studentëve mbi tregun e punës (**Researcher/Asistent Lektore, Tiranë**).
- Praktike profesionale efikase si bashkëpunimi mes fakulteteve dhe me bizneseve apo dhe institucionet tjera shtetërore për punësimin gjatë universitetit apo pasuniversitar të studenteve. Gjithashtu studim i tregut të punës dhe përshtatja e programeve universitare me rezultatet e këtij studimi. Nevojitet fuqizimi i rolit të zyrave të karrierës në fakultete (**Financier, Tiranë**).
- Bashkëpunimi intensiv me universitet e mirënjohura përëndimore dhe përafrim të mëtejshëm të programit me to (**Inspektore, Tiranë**).
- Universiteti duhet të zhvillojë më shumë seanca informuese për mundësitë e punësimit për studentët si dhe krijimi i një rrjeti bashkëpunimi me kompani që kërkojnë profesionistë në fushat për të cilat studentet kryejnë studimet duke bërë edhe praktikant në to duke zgjedhur edhe personat më të përshtatshëm (**Analist Biznesi, Tiranë**).
- Duhet të identifikohen studentët me rezultate të larta dhe performancë të mirë, të realizohet një lidhje mes kontakteve të institucionit dhe studentit që i përmbush këto cilësi, duke qenë vetë fakulteti referues (**Kordinator, Tiranë**).
- Do të sugjeroja që qendrat e karrierës të ngritura pranë fakulteteve të ishin më aktivisht të përfshira në këtë proces, si dhe që praktikant që ata kryejnë në përfundim të studimeve të jenë realisht të vlefshme për studentët dhe t'u shërbejnë atyre në punësimin e mëtejshëm (**Analist biznesi, Tiranë**).
- Ripërpunimi i teksteve, sjellja e shembujve konkretë të marrë nga praktika shqiptare dhe ajo e huaj, analiza të thelluara duke inkorporuar teorinë e librave me realitetin. Trajnimi i profesorëve, pasi jo të gjithë kanë aftësinë dhe kapacitetin e mësimdhënies

Sugjerime të ish-studentëve të FGJH

- Sugjeroj për profesorët ta bëjnë mësimin interesant dhe të mos e mbingarkojnë studentin me shumë informacion pasi nuk është efektiv. Më mire cilesi në mësimdhënie dhe jo sasi pasi ajo kurrë nuk ka rezultuar efektive. **(Mësuese, Tiranë)**
- Laborator gjuhe. Sa më shumë praktikë të gjuhës, dëgjimin dhe të folurën. Faleminderit **(Operatore, Call center, Pogradec)**
- Universiteti duhet të shikojë tregun e brendshëm të kërkesës për punë dhe të riorientojë prioritetet drejt përmbushjes së nevojave por gjithashtu duhet të kihet parasysh edhe tregu jashtë. **(Pa punë, Tiranë)**
- Fakulteti të mos pranojë studentë të rinj pa patur të paktën nivelin gjuhësor B1. **(Asistent, OJF, Tiranë)**
- Oraret e masterit të jenë më të përshtatshme për studentët të cilët janë në punë. **(Agjent turistik, Tiranë)**
- Mendoj që duhet të krijohet mundësia e punësimit që në periudhën e studimeve që paskësaj studentët të jenë më të hapur ndaj vendeve vakante të punësimit dhe rritjes në karrierë **(Operatore, Tiranë)**
- Procesi i mesimdhënjes të ndërthuret më shumë me praktikën, me përditshmërinë, me tregun e punës. **(Mësuese, Burrel)**
- Shkolla të lidhet me më tepër institucione për kryerjen e praktikave, stazheve, trajnimeve për t'i mundësuar studentit ta kuptojë më mirë mënyrën e punës, profesionin për të cilin ka kryer studimet. **(Libra shitës, Tiranë)**
- Një bashkëpunim më i mire ndërmjet Universitetit dhe kompanive Private ose shtetërore. **(Shërbimi ndaj klientit, SHBA)**

SUGJERIME TË ISH – STUDENTËVE TË FHF

- Mësimdhënie bashkëkohore me standard të larta nga ana e trupës pedagogjike.
- Biblioteka e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë duhet të jetë online dhe më e azhurnuar me literaturën e kohëve të fundit.
- Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë duhet të zhvillojë një program studimi në gjuhën angleze, për të mundësuar imobilitetet e studentëve, marrëveshje me institucionet e tjera për zhvillimin e praktikave mësimore.
- Domosdoshmëria e zyrës së karrierës në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë dhe zhvillimi i panairëve të karrierës në rang universiteti
- Bashkëpunim më intensiv i Fakultetit me sektorin public dhe atë privat, i cili mund të krijojë kushte më optimale në lidhje me punësimin e studentëve.
- Oraret e zhvillimit të mësimin në master të jenë sa më të përshtatshëm për sa i përket studentëve, të cilët janë në marrëdhënie pune.
- Krijimin e një sistemi të cilësisë, ku studentët të bëjnë vlerësimin e pedagogëve.

Sugjerime të ish-studentëve të FSHN

- Rishikim i programit të studimit dhe përditesimi me teknologjite më të fundit në këtë seksion. (*Specialist IT, OJF, Durrës*)
- Të ketë sa më shumë praktikë nga ana e universitetit dhe të ketë marrëveshje dypalëshe me biznesin privat pasi ai është ofruesi më i madh i punësimit në Shqipëri dhe në botë. (*Web Developer, Tiranë*)
- Duhet të ofrohen më shumë mundësi punësimi ose praktike me pagesë minimale për të paktën studentët më të mirë. (*Pa punë, Tiranë*)
- Dua të sugjeroj që programi i praktikave të punës në shtet të mos bëhet selektiv. Kam aplikuar dhe më është refuzuar praktika sepse kërkohet eksperiencë. (*Mësuese në qendra kursesh, Tiranë*)
- Funkcionim më i mirë i zyrës së karrierës. Nxjerrja e njofrimeve për punë. Lidhja e universitetit me struktura të tjera publike dhe jopublike që mundësojnë intershipe dhe punësim. (*Pa punë, Tiranë*)
- Duhet të ketë lidhje midis universitetit dhe bizneseve të cilët kërkojnë punonjës të kualifikuar. Praktika, kur është e mundur, duhet të bëhet tek vetë bizneset. Punëdhënësit s'kanë si marrin në punë dikë që nuk e ka idenë e punës në terren. Është e paarsyeshme dhe joproductive. Për ta është më i vlefshëm dikush me eksperiencë e me rezultate mesatare në shkollë, se sa një student i shkëlqyer por pa eksperiencë në punë. (*Mësues, Privat, Tiranë*)
- Të bëhet planifikimi për kuotat që në fillim. (*Pa punë, Vlorë*)
- Vënia në zbatim të urdhrit të biologut. Praktikant duhet të njihen nga punëdhënësi Shtimi i orëve laboratorike. (*Biologe, Privat, Tiranë*)
- Universiteti duhet të krijojë marrëdhënie sa më të ngushta me palët e treta në mënyrë që tju japë mundësi studenteve që të zhvillojnë aty praktikant mësimore. 2 - Sistemet e laboratoreve duhet të jenë të përditësuar me programet e duhura për të zhvilluar normalisht orët laboratorike. 3 - Pedagoget duhet të jenë me bashkëpunues dhe gjithëpërfshirës në zhvillimin e projekteve konkrete. (*Web Developer, Vetëpunësuar, Tiranë*)
- Zhvillimi i praktikave profesionale. Duhet të ketë më shumë laboratore. (*Pedagoge, Tiranë*)

Sugjerime të ish-studentëve të FSHS

- Shmangja në maksimum e mësimit teorik, përmendësh. (*Administrator OJF-je, Tiranë*)
- Për mendimin tim duhen bërë shumë ndryshime dhe shumë shtesa për të rritur integritetin e studenteve në tregun e punës; një ndër më kryesoret është bashkëpunimi i universitetit me sektorin publik dhe privat për të punësuar studentë menjëherë pas diplomimit (*Kamarier, Devoll*)
- Kuotat e rregjistrimeve duhen hapur aq kuota sa ka nevojë tregu. (*Pa punë, Tiranë*)
- Mendoj se Universiteti i Tiranës ka nevojë për reforma të thella që lidhen kryesisht me metodat e mësimdhënies...për një shkollë më praktike ... S'do të pa përmendur që politika e vendit tonë luan një rol depresiv dhe shkurajues. (*Mësuese, Mirditë*)
- Një praktikë më e zbatueshme dhe një marketing për zyrat e karrierës që të njihen nga të gjithë studentët për funksionin e tyre. (*Kamarier, Gjirokastrë*)
- Mbështetja dhe nxitja e vazhdueshme e studentëve duke lënë hapësirë dhe ndihmuar në zhvillimin e mendimit kritik; ese, detyra, konferenca ku të ftohen studentë së bashku me pedagogë që të ketë përplasje mendimesh dhe shtimin e mundësive për ta ndihmuar universitetin që të jetë vërtet hapësirë e pakushtezuar e dijes. Spikatja dhe motivimi i studentëve më të mirë prej stafit akademik dhe ndihmë e ofruar për t'u angazhuar më shumë në fakultet për studentët që diplomohen në Master me gradë Shkencore. (*Drejtuese Dep. Marrëdhënieve me Publikun, Tiranë*)
- Kurikula të pasurohet dhe përditesohet me kërkesat e tregut të punës, duke e bërë sa më praktike dhe funksionale. Mos ketë ripërsëritje të panevojshme të kurikulës nga cikli i studimeve Bachelor në Master. (*Animatore sociale, Korçë*)